



UBT NEWS

Gazetë e studentëve të UBT-së | dhjetor 2013

POLITICS • ECONOMY • BUSINESS • TECHNOLOGY • EDUCATION • SCIENCE • CULTURE

UBT NË VAZHDIMËSI PËRFITON PROJEKTE NGA TEMPUS-i

Faqe 8

ZËVENDËSAMBASADORI I NORVEGJISË DHE DELEGACIONI NGA UNIVERSITETI GJOVIK VIZITUAN UBT-në

Faqe 10

UBT STATS, QENDËR E VEÇANTË NË VEND

Faqe 13



UBT QENDËR E DEBATEVE DHE KOMUNIKIMIT

Faqe 15

Z. HAJRIZI CERTIFIKOHET SI ASSESORI I PARË PËR EFQM ILEP

Faqe 21

UBT BASHKËPUNON ME UNIVERSITETET GJERMANE

Faqe 21

"QUALITY KOSOVA" BËHET ANËTARE E RREGULLT DHE ME TË DREJTA TË PLOTA E ORGANIZATËS EVROPIANE PËR CILËSI

Faqe 23



GJITHÇKA PËR STUDIME SUPERIORE, GJITHÇKA PËR STUDENTIN

Faqe 24-25

STUDENTËT E UBT-së ORGANIZUAN VIZITË STUDIMORE NËPËR EVROPË

Mbi 60 studentë të Fakultetit të Arkitekturës në UBT, gjatë këtyre ditëve, organizuan vizitë tetëditore nëpër shtete të ndryshme të Evropës. Gjatë vizitës në Itali, studentët vizituan Bienalen e Arkitekturës në Venedik dhe objekte me vlera historike të periudhave të ndryshme kohore dhe me stile të ndryshme të ndërtimit, si dhe bukuri natyrore dhe bregdetare. Po kështu, ata vizituan edhe qytete të ndryshme, si Dubrovniku, Rjeka, Lubjana, vizituan edhe disa pjesë të qytetit të Vjenës, si dhe shumë kompani të ndryshme biznesore dhe ndërtimore.

Faqe 4-5



Editorial



Edmond Hajrizi
President i UBT-së

Të nderuar lexues,

Roli i Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe ruajtja e pozicionit të liderit

Institucionet universitare kryesisht kanë dy objektiva kryesore: një në zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohet shoqëria, dhe dy, ne gjenerimin apo krijimin e dijeve të reja. Këto objektiva synohen të arrihen përmes aktiviteteve siç janë: edukimi universitar, edukimi profesional dhe ai gjatë gjithë jetës, hulumtimet shkencore dhe profesionale, publikimet, bashkëpunimet ndërkombëtare si dhe përmes këshillave profesionale për vendimmarrje më të mira.

Mund të themi lirisht se edhe në këtë vit UBT ka ruajtur pozitën e liderit në Arsimin e Lartë në Kosovë në aktivitetet e lartpërmendura. Këtë më së miri e dëshmojnë të dhënat e vitit 2013.

Edhe më shumë ...

Zhvillim i qëndrueshëm

Në vitin që po e lëmë pas UBT (2013) ka më shumë studentë sesa në vitin e kaluar (2012), ka më shumë studentë të dalluar dhe me mesataren mbi 4.5 nga shkolla e mesme, ka më shumë staf akademik dhe administrativ, ka më shumë infrastrukturë dhe laboratorë për ushtrime, më shumë literaturë, më shumë programe studimi të akredituara, më shumë programe studimi të ofruara në bashkëpunim me universitetet partnere prestigjioze, më shumë partneritete me universitete në botë, më shumë projekte hulumtuuese, më shumë grante për mobilitet për studentët dhe stafin, më shumë konferenca shkencore të nivelit ndërkombëtar, më shumë publikime shkencore, më shumë projekte zhvillimore për shoqërinë kosovare, më shumë përfaqësim në komitete shkencore dhe profesionale në botë, më shumë praktika për studentët, më shumë përkrahje dhe orientim profesional, më shumë certifikime ndërkombëtare, më shumë profesorë ndërkombëtarë të involvuar në ligjërata, më shumë përfaqësime dhe anëtarësime të Kosovës në nivelin profesional dhe ndërkombëtar, më shumë debate, më shumë vizita studimore, më shumë bursa dhe përkrahje financiare për studentët dhe më shumë robotë të teknologjisë së fundit.

Disa rezultate specifike:

Po i përmendim vetëm disa rezultate prej shumë të tillave:

- Programin e ri për studime për Inxhinierinë e Ndërtimit, Ambient dhe Infrastrukturë, për Media dhe Komunikim por edhe atë për shkenca Politike.

- Programin e Studimeve si 'Double Degree' me Universitetin e Varshavës dhe me Universitetin e Vjenës për Teknologji

- Konferencën e organizuar ndërkombëtare të IFAC-ut, SWIS 2103 në qershor dhe

Konferencën ndërkombëtare për Biznes, Teknologji dhe Inovacion në nëntor.

- Konferencat Studentore si dhe Universitetin Veror me Akademitë përkatëse verore.

- Ardhen e gjeneratës më të re të robotëve humanoidë NAO në UBT - për herë të parë në Kosovë dhe në Ballkan.

- Fillimi i punës së Kampusit të Ri me Infrastrukturën e Re.

- Zhvillimi i Strategjive për Zhvillim Ekonomik si dhe zhvillimi i kapaciteteve humane për shumë komuna të Kosovës.

- Programi i ri TEMPUS i Komisionit Evropian për energji të rinovueshme.

- Vazhdimi i Programit Erasmus Mundus dhe bursat e reja për studentë. Në këtë program ku ndahen bursa për studentë dhe staf nga Komisioni Evropian vazhdojmë të jemi Institucioni i vetëm jopublik që marrim pjesë në të.

- Anëtarësimi i Kosovës në Organizatën Evropiane për Simulim si dhe në atë Evropiane për Cilësi.

- Implementimi i mësimit të Ndërmarrësisë dhe Inovacionit për të gjitha programet e studimeve.

- Pasurimi i bibliotekës së UBT-së me 25000 libra dhe materiale të reja.

- Projekti akademik dhe shkencor për fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit me Norvegjinë, ku përfshihen bursa, studime të doktoratës dhe hulumtime shkencore.

- Rezultatet e shkëlqyeshme të studentëve të UBT-së në vizitat studimore jashtë vendit (përmes bursave Erasmus dhe AEP) dhe në punësim.

- Nga një Institucion Evropian sivjet ishim ftuar të marrim çmimin për institucionin më cilësor në rajon.

- Në Nivelin e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë jemi Shkolla më e madhe dhe lider në Ballkan në këtë fushë.

- Edhe në Fakultetet e tjera kemi vlerat e veçanta që po na dallojnë nga të tjerët.

- IPMA bëri validimin (akreditimin) tonë, për herë të parë në gjuhën shqipe për Certifikimin e Kompetencës për Menaxhimin e Projekteve.

- Filloi punën Qendra e Karrierës dhe Internshipit, Qendra për Statistika, Analiza dhe Parashikime (UBT Stats) si dhe Instituti i Gjuhëve të Huaja.

Puna ekipore me shpirt ndërmarrësie dhe inovacioni ...

Këto rezultate nuk janë të lehta dhe të vetë nënkuptueshme. Gjatë rrugës kemi hasur edhe ne pengesa dhe vështirësi të ndryshme. Megjithatë, ne po ia dalim falë një kontributi të jashtëzakonshëm të gjitha palëve të interesit në UBT (stafi, studentët dhe partnerët) që po punojnë së bashku si një tërësi dhe me një shpirt të theksuar ndërmarrësie dhe inovacioni.

Ky angazhim po bën që ne të dallohemi në cilësi dhe me suksese, po dëshmojnë sloganet tona tashmë të njohura, të cilat

dërgojnë mesazhe të qarta për vlerat dhe misionin tonë te studentët, te stafi, partneret, prindërit, qytetarët, alumni, punëdhënësit, si dhe palët e tjera të interesit:

- *Zgjidh më të mirin... që të bëhesh më i miri*

- *Top Education for Top Students*

- *American and European University Education in my country*

- *Succeed with Quality*

- *UBT nuk është vetëm diplomë ... është prestigj, është sukses, është cilësi, është krenaria.*

- *12 years Leadership and Innovation*

Për këtë unë dua t'ju falënderoj për përzemërsisht të gjithëve, për kontributin dhe bashkëpunimin e ofruar, për të ofruar në Kosovë një cilësi të Arsimit të Lartë të nivelit ndërkombëtar, për të ndërlidhur arsimin dhe shkencën kosovare me atë evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe për të ofruar konsulentë profesionale për zhvillimin e sektorëve të jetës në Kosovë.

Në vitin 2014 ...

Në vitin 2014 do të vazhdojmë të punojmë edhe më shumë dhe më mirë, në mënyrë që ky trend i zhvillimit dhe sukseseve të vazhdojë edhe më tutje. Në veçanti mund të them se në këtë vit kemi planifikuar disa projekte inovative për Kosovën dhe regjionin për t'u zhvilluar dhe implementuar në UBT në bashkëpunim me partnerë shumë të vlerësuar ndërkombëtarë dhe për këtë do t'ju njoftojmë në vazhdimësi.

Urime...

Në fund, më lejoni t'ua uroj të gjithëve Vitin e Ri 2014, duke ju dëshiruar suksese, shëndet dhe lumturi për ju dhe më të dashurit tuaj.

Në veçanti dua t'i përsërisht studentët dhe alumnin e UBT-së, duke ju dëshiruar edhe më shumë suksese në studime dhe në karrierë. Nga ne, stafi i UBT-së, ju gjithmonë do të keni përkrahjen dhe angazhimin e plotë, ashtu që ju vërtetë të jeni të lumtur, të respektuar dhe sa më të suksesshëm në jetë. Për këtë ekziston UBT.

URIME dhe SUKSESE!

UNIVERSITY FOR BUSINESS AND TECHNOLOGY
UBT
AMERICAN EUROPEAN UNIVERSITY

12 YEARS
LEADERSHIP and INNOVATION

Education • Research • Training • Consulting

IMPRESUM

UBT News - Gazetë e studentëve të UBT-së,

Botues: Edmond Hajrizi

Kryeredaktore: Naile Demiri

Gazetën e përgatitën studentët e Fakultetit për Media dhe Komunikim në UBT.

Adresa: www.ubt-uni.net | **Tel:** 038 541 400, 044 541 400

Thyerja Grafike: ELV Studio

Shtypet në Shtypshkronjën «Roto Print»



**UNIVERSITY EDUCATION
FOR BUSINESS AND TECHNOLOGY**

AMERICAN EUROPEAN UNIVERSITY

NË UBT FILLOI VITI I RI AKADEMIK 2013/2014



SOLEMNISHT NISI VITI I RI AKADEMIK



Prishtinë, 14 tetor 2013- Në UBT, me një ceremoni solemne madhështore për studentët e nivelit bachelore, të hënën është hapur viti i ri akademik 2013/2014. Ceremonia u hap me Himnit kombëtarë dhe atë të Republikës së Kosovës.

Në ceremoni morën pjesë, presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi dhe dekanët e njësive akademike, profesorët, studentët e rinj si dhe familjarët e tyre.

Presidenti i UBT-se, prof. dr. Edmond Hajrizi, u ka dëshiruar mirëseardhje studenteve të rinj në botën akademike universitare, duke shprehur bindjen se ata që nga dita e parë do të angazhohen me intensitet të plotë për të nxënë

dijet e reja, rrugë në të cilën UBT do t'i ndihmojë me të gjitha kapacitetet e tij.

Me këtë rast presidenti i UBT-së, z. Hajrizi i ka prezantuar të arriturat dhe planet për të ardhmen e UBT-së, duke e cekur ngritjen e UBT-së në të gjitha sektorët e veçanërisht atë të cilësisë në studime dhe krijimin e kushteve brenda UBT-së.

Presidenti Hajrizi, ka përkujtuar se ky është viti i dymbëdhjetë që UBT organizon një ceremoni të tillë për fillimin e vitit të ri akademik.

Ai thase në këtë vit të ri akademik 2013/2014 në UBT, janë përcaktuar një numër i madh i studenteve të rinj dhe krahasuar me vitin e kaluar, dhe me ta do

punojnë një numër i madh profesorësh vendorë e ndërkombëtare, eksperte të fushave të përgjdhura, ndërkohë që studentet do të kenë në dispozicion salla, kompjuter, laboratorët në të dyja objektet si në Prishtinë dhe në Kampusin e ri universitar, me modernin në vend dhe më gjerë etj. Po kështu, si një faktor shumë pozitiv, u theksuan edhe akreditimi i programeve të reja ai për Ndërtimtari, Shkenca Politike dhe Media e Komunikim, poashtu marrëveshjet e bashkëpunimit me universitete më prestigjioze në botë, dhe lëvizjen e studentëve në këto universitete për vazhdimin e studimeve të mëtutjeshme dhe enjohja e diplomave ndërkombë-

tarisht, dhe bashkëpunimin me kompanitë më të rëndësishme në vend dhe më gjerë, që studentëve do të mundësojnë zhvillimin në nivel sa më të mirë të punës praktike dhe punësimit të mëtutjeshëm,

“Cilësia në UBT mbetet mbi të gjitha, programet tona të studimeve janë në përputhje të plotë dhe të gjitha standarde evropian dhe amerikane që i shohin në akreditim dhe sistemi i menaxhimit të UBT-së”, tha z. Hajrizi.

Një fjalë rasti në këtë ceremoni, ndërlidhur me punën hulumtuese dhe studimore dhe rezultatet e aritura në UBT, mbajti edhe drejtori për Çështje Akademike, prof. dr. Ibrahim Krasniqi dhe dekanët dhe prodekanët e të gjitha fakulteteve përkatëse në UBT, si prof. dr. Belul Beqaj, prof. dr. Binak Beqaj, dr. Muzafer Shala, prof. dr. Zenjuhall Gruda, can. dr. Muhamet Ahmeti, can. dr. Ardiari Emini etj.

Kurse sipas Alumnit të UBT-së, Armend Merovci, me mbarrimin e studimit themelore në këtë institucion universitar është punësuar në kompani më prestigjioze brenda dhe jashtë vendit, edhe ky si koleget tjerë, në saje të UBT-së, ka vazhduar studimet jashtë vendit në Londër të Anglisë, i cili pas përfundimit të këtyre studimeve është kthyer në Kosovë, dhe menjëherë ka filluar punën si staf akademik në UBT, po ashtu në institucione publike dhe privatë në vend.

“Nga përvoja ime, dhe kushtet e ofruara në UBT, më kanë ndihmuar shumë në jetën profe-

sionale në zbatimin e njohurive në praktikë. Kushtet e ofruara nga UBT-ja nuk lënë vend për humbje përpjekjesh në gjëra dytësore, por vetëm përqendrim në studime. Mbetet që ju të punoni, në mënyrë që të sigurohet sukcesi profesional pas studimeve”, tha Kushtim Dragusha, Alumnit i UBT-së, të cilit pas përfundimeve të dy palë studimeve në UBT është punësuar në punë menaxheriale në njëra nga banka vendore, staf akademik në UBT, dhe UBT ia ka mundësuar që të pranohet dhe të vazhdon më bursë të plotë studime e doktoratës në Universitetin Gjovik në Norvegji.

Në ceremoninë e pritjes së studentëve të rinj me nga një fjalë paraqitën edhe disa studentë të dalluar të UBT-së, dhe studentët të rinj, ku sukcesi i tyre ka nisur në UBT dhe po lulëzon ditë e më shumë.

Në emër të familjarëve Adnan Merovci, gjatë fjalimit të tij falënderoj Presidentin e UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizin, menaxherin dhe stafin akademik të UBT-së, për punën e tyre të palodhshme në nivelin akademik, shkencorë e profesional. “Në UBT më studiojnë katër fëmijë e mijë, dy djemtë të cilët kanë mbaruar studimet themelore dhe janë në vazhdim të masterit, gjithashtu janë të punësuar në kompani më të suksesshme në vend, dhe dy vajzat të cilat po fillojnë që sot. Siç po shihet, studimet në UBT-së kanë një qëllim, e kjo është që çdo student të jetë i përgatitur për tregun e punës”.

STUDENTËT E UBT-SË VIZITË STUDIMORE NË



Vizitë studimore në Sarandë

Prishtinë 17 tetor 2013 - Një grup studentësh të vitit të dytë dhe të tretë të Fakultetit të Arkitekturës së UBT-së kanë marrë pjesë në programin trajnues në metodologji anketimi, i cili për katër ditë më radhë është zhvilluar në Sarandë.

Përveç tre leksioneve në skicim kërkimor, kampionim dhe metodologji anketimi të shpjeguar nga pedagogu i UBT-së, prof. dr. Ridvan Peshkopia, studentët kanë zhvilluar edhe një vizitë dhe seancë vizatimore në qytetin antik të Butrintit si edhe një vizitë në qytetin antik të Antigonesë.

Në Antigone, studentët u shoqëruan nga drejtori i parkut arkeologjik të Antigonesë Engjëll Seriani dhe takuan e biseduan me arkeologun Dhimitër Çondi i cili bën gërmime në Antigone dhe është njëkohësisht edhe drejtor i arkeologjisë i parkut arkeologjik të Butrintit.

Mes të tjerash studentët ndihmuan në pastrime mes objekteve arkitektonike e arkeologjike. Si studentët e UBT-se ashtu edhe drejtuesit e parkut arkeologjik të Antigonesë shprehën dëshirën e përbashkët për një bashkëpunim afatgjatë mes UBT-së dhe parkut arkeologjik të Antigonesë.

Vizitë studimore në Evropë

Po ashtu, gjatë muajit dhjetor, mbi 60 studentët të Fakultetit të Arkitekturës në UBT, gjatë këtyre ditëve organizuan vizitë tetë ditore nëpër vende të ndryshme të Evropës. Këtij organizmi ju bashkëngjiten edhe disa nga stafi akademik si prof. dr. Edmond Hajrizi, prof. Muhamet Ahmeti dhe prof. Ajhan Bajmaku.

Studentët gjatë vizitës në Itali, kanë vizituar Bienalen e arkitekturës në Venedik, dhe objekte me vlera historike të periudhave të ndryshme kohore dhe me stile të ndryshme të ndërtimit, dhe buku-

ritë natyrore dhe bregdetare. Ata, po kështu kanë vizituar edhe qytete të ndryshme si Dubrovnikun, Rjekën, Lubjanën, vizituan edhe disa pjesë të ndryshme të qytetit të Vjenës, dhe shumë kompani të ndryshme biznesore dhe ndërtimore.

Në qytetin e Vjenës, përveç vizitës nëpër disa zona konkrete urbane ata ndoqën edhe disa ligjëratë në Universitetin Teknik të Vjenës, të mbajtur nga prof. Skënder Kosumi me temën "Revitalizimi dhe Regjenerimi i hapësirave urbane" dhe te prof. Thomas Dillinger, me temën "Vienna University of Technologie at a Glance", kurse presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, foli për bashkëpunimin mes UBT-së dhe Universitetit Teknik të Vjenës. "Njohuritë që i kemi marrë gjatë studimeve për objektet nëpër lëndë të ndryshme na u dha rasti t'i shohim drejtpërsëdrejti, si vizita në objektin e Zaha Hadid, vizita e pallatit mbretëror Schonbrun, vizita në

Kampusin e ri të Fakultetit Ekonomik të Universitetit Teknik të Vjenës, po ashtu qytetin e vjetër të Dubrovnikut, mënyra se si objektet i kanë mbijetuar kohës të bënë shumë përshtypje, në Venecia të Italisë, arkitektura e veçantë e cila përsëritej në tërë qytetin, objektet e vjetra të cilat kanë ruajtur stilin e tyre ishte madhështore etj", tha Blerta Emini, studente në UBT.

"Ishte një eksperiencë e mrekullueshme. Deri me tani qyteti i Venedikut me arkitekturën e vjetër dhe urat e shumta dhe Vjena me muzet dhe zbukurimet e saj për festat e fund vitit deri më tani janë qytetet e mia të preferuara", tha Aida Bakalli, e cila shton se në vendet e vizituara ka shumë kryevepra të arkitekturës të cilat mund të merren shembuj të një arkitekture të suksesshme.

Prodekani i Fakultetit të Ndërtimit në UBT, can. dr. Muhamet Ahmetin, njëherësh edhe ndër organizatorët e vizitës tha vizitat studimore janë te parapara

në planprogramin e Fakultetit të Arkitekturës. "Në Venedik, qëllimi kryesor ka qenë vizita e Bienales, që si vjet ka qenë ekspozita e artit, ka qenë ekspozitë botërore. Ky ka qenë qëllimi kryesor që e kemi vizituar Venedikun, kurse vizita e Dubrovnikut dhe Rijekes janë bërë rrugës për Venedik. Pra të njëjtën kohë kemi shfrytëzuar që t'i vizitojmë edhe këto qytete, të cilat kanë objekte interesante, karakteristike dhe arkitekturë të zhvilluar, që janë shumë interesante për studentët. Qëllimi i vizitës në Austri ka qenë mbajtja e ligjëratave nga Thomas Dillinger dhe Skënder Kosumi. Vizita në Venedik nuk ka qenë vetëm vizitë e objekteve, mirëpo ka pas që secili student të kryejë detyra punuese. Ata kanë bërë skicimin projekteve të ndryshme, objekte të ndryshme, ne mënyre që ato punime të vlerësohen edhe nga profesori bartës i kësaj lënde. Bashkë ne vizitë ka qenë edhe profesori i kreativitetit".



ORGANIZUAN PËR EVROPË



Vizitë studimore nëpër Kosovë

Studentët e Fakultetit për Media dhe Komunikim në UBT, gjatë semestrit të parë, kanë zhvilluar një varg vizitash studimore, si, në Komisionin e Pavarur për Media (KPM), ku për së afërmi janë njohur me zhvillimin e këtij institucioni që nga fillimi i punës, proceset e deri në ditët e sotme, gjithashtu studentët u njoftuan për rolin dhe funksionin e institucionit, i cili është organ kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit në Republikën e Kosovës. "KPM-ja licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale", ka thënë para studentëve shefja ekzekutive, Naile Selimaj- Krasniqi.

Ajo shtoi se ky institucion përgjegjësi e KPM-së është të nxisë dhe të mbajë një sistem të drejtë dhe të hapur për licencimin dhe rregullimin e shërbimeve mediale-audiovizuale dhe për menaxhimin e spektrit të frekuencave të transmetimit në pajtim me standardet më të mira ndërkombëtare.

Studentët e këtij fakulteti, një vizitë studimore e kanë realizuar edhe në Këshilli i Medieve të Shkruara të Kosovë (KMSHK), ku studentët u njoftuan për rolin dhe funksionin e institucionit, i cili është një trup vetë-rregullativ i formuar për dhe nga sektori i medieve të shkruara.

Më pastaj, studentët e vizituan edhe gazetën "Zëri", nga afër panë se si mbahet mbledhja e mëngjesit me gazetarë dhe shpërndarja e temave, dhe u bë një debat mes



studentëve gjithashtu edhe redaktorëve se si funksionon gazeta nga mëngjesi deri në mbylljen e saj.

Vizita në Departamentin e Informacionit në Presidenten e Republikës së Kosovës.

Drejtori i këtij departamenti, Safet Zejnullahu dhe zëdhënësi Arbër Vllahu, thanë se Departamenti i informacionit, është njësi e rëndësishme organizative në kuadër të Zyrës së Presidentit të Kosovës. Ky Departament ka për qëllim të njoftojë opinionin publik dhe mediat me veprimtarinë zyrtare të Presidentit të Kosovës, të mbajë kontakte të rregullta me mediat, të akreditojë përfaqësuesit e tyre, si dhe të informojë Presidentin me qëndrimet e opinionit publik dhe medias lidhur me punën e Presidentit.

Që të dy përfaqësuesit në fjalë u shprehën se këto qëllime arrihen përmes komunikimit të rregullt e transparent me mediet, analizës dhe monitorimit, si dhe publikimeve. Gjithashtu ky departament bashkëpunon ngushtë me Kabinetin e Presidentit në çështjet e informimit, si dhe është përgjegjës për paraqitjen e aktivitetit të Presidentit nëpërmjet faqes së internetit.

Gjithashtu studentët vizituan edhe Odën Ekonomike në Kosovë, Policinë e Kosovës dhe Odën e Avokatëve të Kosovës.

Gjatë këtyre vizitave të cilat i kemi cekur si më lartë, përveç mikpritjes ndër të tjera i kanë njoftuar edhe me objektivat zhvillimore dhe aktivitetet vepruese që ky institucion do t'i ketë në periudhën vijuese konform planit të tyre. Gjithashtu studentët për së afërmi panë të gjitha departamente e këtyre institucioneve.

Nga ana e studentëve u shtrua çështja e mundësisë së bashkëpunimit ndërmjet UBT dhe institucioneve në fjalë. Palët pritisë përkrahjen iniciativën dhe shprehën mikpritje edhe në të ardhmen për studentet në këto institucion për vizita, hulumtime shkencore, etj, etj.

Studentët më një fjalë, rekomandojnë që vizitat tilla profesionale të organizohen edhe në institucion të shumta që ka vendi dhe më gjerë.

*Punuan: Erza Brahushi,
Iliriana Krasniqi,
Qëndresa Ferati, Ilaz Luzha*



UBT, UNIVERSITETI I VLORËS DHE UNIVERSITETI I TIRANËS ORGANIZUAN KONFERENCË NDËRKOMBËTARE PËR BIZNES, TEKNOLOGJI DHE INOVACIONE

MBI 200 STUDIUES NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE NË DURRËS



“Të koordinosh konferencë të karakterit të tillë është vërtet kënaqësi, e mua personalisht kjo kënaqësia më ka përcjellë prej momentit që më është besuar të jem koordinatorja kryesore e konferencës në fjalë”, ka thënë koordinatorja gjenerale e konferencës në fjalë, can. dr. Krenare Pireva.

Ajo më tej ka shtuar se synimi i konferencës ka qenë i qartë, ta ngre nivelin e bashkëpunimit në mes akademikëve, hulumtuesve dhe komuniteteve shkencore duke ndarë në mes vete diturinë, eksperiencat dhe idetë e tyre, të cilat kanë qenë të shumta. “Shpreh mirënjohjen time më të lartë ndaj rektorit prof. dr. Edmond Hajrizi, i cili ma besoi këtë organizim dhe të gjithë stafin e UBT-së, duke u nisur nga dekanët e fakulteteve, koordinorët etj., të cilët nuk kursyen as kohë dhe as mund për të kontribuar deri në momentin e fundit, pa ndihmën e të cilëve konferenca nuk do ta gëzonte suksesin që e gëzoi dhe falënderoj bashkorganizatorët dhe partnerët e konferencave, siç janë të cituar pak më lartë”, ka përfunduar ajo.



deklaruar se të njëjtën konferencë në vitin e kaluar e organizuan në Prishtinë, kurse në këtë vit në Durrësin e bukur jo vetëm për ne por edhe për kolegët ndërkombëtar. “Vitin e kaluar ka qenë më shumë event i organizuar për një komunitete të caktuar intelektual, ndërsa event i sotshëm është shumë më i gjerë edhe në numrin e fushave të shqyrtuara si dhe për numrin e pjesëmarrësve”, ka theksuar ai.

Gjithashtu UBT dhe Fakulteti Ekonomik i Universitetin e Vlorës kanë arritur marrëveshje të përbashkët për master. “E falënderojmë presidentin e UBT-së, z. Hajrizin, që na ka ftuar për ta ndarë konferencën me ne. Është viti i dytë dhe fatmirësisht po shndërrohet në traditë”, ka thënë dekania Bazini. Ndërkaq prof. dr. Kozeta Sevrani, nga Universiteti i Tiranës, përveçqë i përshëndeti të pranishmit ndër tjera ka thënë: “Nëpërmjet kësaj konference synonim të vazhdojmë të kontribuojmë për përmbushjen e nevojave që kanë akademikët, kërkuesit, lektorët e studiuesit e fushës, për të ndarë mendimet, idetë, eksperiencat dhe punimet e tyre”.

Edhe prof. dr. Felix Breitencker, njëherësh përfaqësues i EUROSIM-it dhe profesor në Universitetin e Vjenës është shprehur: “E falënderoj studentin tonë të doktoratës Edmond Hajrizin që më ofroj mundësinë të prezantohem para këtyre njerëzve të shkencës. Për mua është kënaqësi”.

Durrës, 1 nëntor 2013 - UBT në bashkëpunim me Universitetin e Vlorës dhe Universitetin e Tiranës, dhe institucione tjera akademike, si dhe me mbështetjen e Universitetit Teknik të Vjenës, Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), EUROSIM, Quality Kosova, IPMA Kosova, AEP dhe IFAC organizuan konferencën dyditore ndërkombëtare për Biznes, Teknologji dhe Inovacione, e cila i nisi punimet sot në hotelin “Blearti”, në Durrës dhe është kah përcillet nga shumë të interesuar. Në këtë Konferencë Ndërkombëtare për Biznes, Teknologji dhe Inovacione, janë paraqitur rreth 200 pjesëmarrës - akademikë dhe profesionistë të fushave si me theks të veçantë: Computer Science and Information Systems, Management, Business and Economics, Mechatronics and Robotics, Architecture and Spatial Planning, Law, nga Republika e Kosovës dhe Republi-

ka e Shqipërisë, si dhe akademikë nga shumë vende të ndryshme të botës.

Përveç krerëve të këtyre institucioneve organizatore, si presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, dekania e Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Vlorës, prof. as. Evelina Bazini dhe prof. dr. Kozeta Sevrani, përgjegjëse e Departamentit Matematikë, Statistikë dhe Informatikë e zbatuar në Universitetin e Tiranës (UT) në hapjen solemne morën pjesë edhe përfaqësues të lartë të Republikës së Kosovës, si dhe të universiteteve, kompanive dhe institucioneve partnere që i ka UBT nëpër Evropë dhe botë.

Duke folur para të pranishmëve, si përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe të atyre ndërkombëtare, përfaqësues të medieve, profesorë dhe studentë të

UBT-së dhe të ftuar të tjerë përveçse ju shprehur mirëseardhje, presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi ka thënë: “Është hera e dytë që organizojmë një konferencë të tillë, ideja është me krijuar disa nënkonferenca dhe mbase me i ndërthurur me një konferencë të vetëm, dhe është një mundësi e mirë për të rinjtë të publikuar punime shkencore po edhe mu njohet më komunitetin akademik ndërkombëtar, siç i kemi të pranishëm në këtë konferencë. Dhe tjetra ide është me përmirësuar bashkëpunimin rajonal të komuniteti ndërkombëtar bashkë me Universitetin e Vlorës dhe Universitetin e Tiranës, dhe me përfaqësues vendorë të shoqatave menaxheriale, kështu që kjo konferencë mundëson orientimin dhe koordinimin e sektorëve të ndryshëm brenda rajonit”.

Ndërkaq prof. dr. Peter Kopacek nga Universiteti Teknik i Vjenës, ka

Në konferencën në fjalë, e cila zgjati për du ditë me radhë, me punime e tyre hulumtuese janë paraqitur vargu i studiuesish nga fushat e cekuar më lartë. Po ashtu në konferencë me punime e tyre hulumtuese nga fusha e cekur me lartë u paraqitën edhe një varg studiuesish të rinj të tria universiteteve organizatore si të UBT-së, UV-së dhe UT-së, si studentë dhe profesorë të universiteteve dhe institucioneve partnere të UBT-së. Në Konferencën Ndërkombëtare për Biznes, Teknologji dhe Inovacione, janë paraqitur rreth 200 pjesëmarrës - akademikë dhe profesionistë të fushave përkatëse, nga Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë, si dhe akademikë nga shumë vende të ndryshme të botës. Punimet e konferencës, janë duke u zhvilluar paralelisht në katër sesione të fushave të cekura më lartë. Punimet e konferencës u zhvilluan në hotelin “Blearti” në Durrës në Shqipëri, dhe u përcjell nga shumë të interesuar.

INTERVISTË ME DREJTORIN E FINANCAVE, PROF. SELMAN BERISHA

PUNËTORI MË I VJETËR NË UBT

"Kur punoj në zyrën e financave, relaksohem, ndërsa kur jam para studentëve ndiej një kënaqësi shpirtërore", tha z.Berisha.

Fotografia: Anisa Rada



UBT News: Para se ta zhvillojmë intervistën, pse ju quajnë Aga Man?

Berisha: Të them të vërtetën kjo është histori në vete, por po mundohem që në pika të shkurtra ta shpjegoj. Gjyshi im (babai i nënës sime) e kishte pasur emrin Selman. Gjyshi im të cilin nuk e kam parë kurrë, kishte qenë person i respektueshëm dhe trim i madh. Asnjëherë nuk ishte pajtuar me pushtetin e asaj kohe dhe si rezultat i kësaj dajati e mi kishin pësuar shumë nga regjimi serb, duke i shfarosur egërsisht dhe duke i ekzekutuar. Nga situata e krijuar dhe presione të vazhdueshme, gjyshi im vdes. Nga kjo do të nxjerrim se unë kurrë nuk e kam shijuar kënaqësinë e dajave. Me lindjen time në atë kohë kishte qenë gëzim i madh edhe pse isha fëmija i gjasthë me radhë, por i lindur pas katër motrave dhe një vëllai. Familja e gjerë Berisha në shenjë respekti për gjyshin tim më pagëzojnë në emër të gjyshit tim Selman. Nëna ime nuk ishte pajtuar, por rrethanat e asaj kohe kanë qenë që mos të flitet. Sa herë që kanë përmendur emrin tim, apo më kanë uruar në djep, nëna ime ishte mërziur shumë. Me të kuptuar, pas disa ditëve më ndërrojnë emrin duke ruajtur prapashitesën MAN dhe duke vendosur parashitesën AGA, po ashtu gjyshin tim e kishin quajtur Aga Selman, ndërsa mua më thërrasin Aga Man.

UBT News: Gjatë bisedave tona me stafin brenda UBT-së, na treguan se jeni ndër të parët që keni filluar punën në UBT. Konkretisht si e keni gjetur rrugëtimin për në UBT?

Berisha: Më keni kthyer 10 vite mbrapa, gjegjësisht 12 vite. Flitet që kjo pikërisht ishte pjesë e karrierës sime. Jam takuar rastësisht me Prof. Edmond Hajrizin dhe në udhëtim e sipër kemi shkëmbyer mendime rreth punës, çka pas dy viteve kjo u shndërrua në realitet, ku nga qershori i vitit 2004 u bëra pjesë e sfidave dhe rezultateve të UBT-së. Unë uroj që të gjithë studentët e UBT-së të kenë fat në karrierën e tyre, ashtu siç kisha fat të jem pjesë e këtij tempulli të dijes dhe shkencës. E takova në UBT thuhet me një person, e ky ishte rektori i sotëm. Një person me shumë energji dhe i palodhshëm, djalë i ri me ambicie të madhe.

Fillimi i rrugëtimin të UBT-së ka qenë goxha i vështirë, por kuptimi i drejtë i mesazheve të ndërsjella bëri që ky tempull i dijes të rrugeton sigurt dhe të jetë i suksesshëm.

UBT News: Cila ka qenë pozita e juaj e parë dhe cila është tani?

Berisha: Kemi filluar me një sipërfaqe veprimi më pak se 30m² e tani... Tani i bëj plot 10 vite në UBT. Sa i përket pozitës, është interesant se asnjëherë nuk jam marrur me këtë çështje. Qysh nga dita e parë në UBT. Kështu që as sektori i sotëm në atë kohë nuk u merrte më pozitë, por me punë dhe mendoj që pikërisht kjo qasje na bëri që të zhvillohemi dhe të jemi këtu ku jemi. Në cilën pozitë jam tani? Tani jam në pozitën e personit shumë të respektuar në UBT, kjo është dhuratë më e mirë për mua. Përkrah kësaj që thashë, menaxhoj zyrën e financave dhe jam ligjërues asistent për lëndët

në Hyrje në kontabilitet financiar dhe SNK.

UBT News: Cila është puna më e këndshme që bëni në UBT?

Berisha: Unë mendoj që nuk mundesh të jesh ligjërues i mirë i kontabilitetit dhe i standardeve po që se nuk ke përvojë nga fusha e praktikës. Kjo mua më bën shumë të qëndrueshëm, sepse gjatë karrierës sime tridhjetëvjeçarenë kontabilitet, nga dora ime kanë kaluar jo më pak se 3000 bilance të profileve të ndryshme. Prandaj këto dy profesione janë shumë të lidhura në mes vete. Dmth kur punoj në zyrën e financave, relaksohem, ndërsa kur jam para studentëve ndiej një kënaqësi shpirtërore.

UBT News: Aktualisht jua menaxhoni arkën e UBT-së, a keni ndarë ndonjëherë pakënaqësi dhe gëzime me punëdhënësin tuaj, të natyrës pse po shteret apo po mbushet arka?

Berisha: Në karrierën time kam takuar shumë menaxherë, fjala është udhëheqës të bizneseve, person i cili ka dijeni çka kërkon, person që hapat i bën me kujdes dhe këshillat i pranon dhe i zbaton - është rektori i sotëm. Me këtë dua të them se asnjëherë nuk kemi qenë jo solvent, kemi pasur shumë kujdes në menaxhimin e shpenzimeve dhe të hyrjeve. Natyrisht, me komodë e ndiejmë veten kur llogaria është e mbushur, por planet e biznesit gjithmonë na japin detyra të reja, siç është rasti i ndërtimit të kampusit, zhvillimi i programeve të reja, trajnime të ndryshme të stafit, vizita studimore etj. Është

e vërtetë se sektori ka një respekt, por jo vetëm rektori dhe shoqja e rektorit, që nganjëherë ngushtohem nga respekti që më bëjnë. Kjo ma merr mendja është nga kultura që e kanë.

UBT News: A të respektojnë stafi për shkak të pagave, korrektësisë apo sillesh mirë me ta?

Berisha: Kjo pyetje është më mirë të ju adresohet punëtorëve të UBT-së, mirëpo nuk e kam atë ndjenjë se më respektojnë për shkak të pagave, sepse zyra ime është zyre ekzekutive. Falënderimi për paga duhet t'i adresohet rektorit, ndërsa unë njihem si person me zero tolerancë. Kështu që të gjithë stafi i UBT-së ju falënderohem për respektin që më bëjnë padyshim kjo vërehet në këtë rast ata nderojnë veten e paralel me këtë më nderojnë edhe mua.

UBT News: Po ashtu e njëjta pyetje vlen edhe për presidentin Hajrizi, ka respekt për ju?

Berisha: Kjo është nga kultura që e kanë këta dy persona, por nuk përjashtohet edhe puna imë 10 vjeçare në këtë universitet. Respektin që më kanë ofruar këta dhe besimin që e ndërtoan tek unë më obliguan që vetes ti jap detyra dhe përgjegjësi të reja të cilat gjatë kësaj dekade i zbatova me përkrahje të plotë.

UBT News: Prej themelimit të punës së saj UBT-ja ndonjëherë ka kaluar dhe nëpër kriza të ndryshme, a është vërejtur kjo edhe tek stafi administrativ dhe akademik?

Berisha: Është e vërtetë se kemi pasur kriza, por ato kanë qenë

nën kontroll maksimal dhe këto nuk janë reflektuar tek stafi administrativ dhe akademik.

UBT News: Me cilat banka keni bashkëpunime?

Berisha: Thuhet me të gjitha bankat kemi bashkëpunim, por me disa banka bashkëpunimi është më i theksuar.

UBT News: A mendoni se i gjithë stafi janë të kënaqur me rrogat që i marrin?

Berisha: Ky universitet qysh nga ditët e para të funksionimit kultivoi në vete traditën e universiteteve botërore të cilësisë duke i afuar studentëve kosovarë profesorë nga universitetet më prestigjioze botërore dhe evropiane vetëm e vetëm për t'u arritur niveli i duhur shkencor-hulumtues. Paralel me këtë mendoj që UBT është edhe lider nga institucionet shkollore për paga të qëndrueshme. Është shumë me rëndësi ta cekim këtë se për 10 vite me radhë nuk më kujtohet se ndonjëherë është marrë paga pas datës 29, 30 apo 31 të muajit, kjo do të thotë se kemi qenë shumë likuid.

UBT News: Nganjëherë dilni pak vonë nga puna, ndoshta për festën e Vitit të Ri do të shkoni me kohë?

Berisha: Po, është e vërtetë që nga puna dal ndonjëherë edhe më vonë. Shkaku është se unë UBT-në nuk e shikoj vetëm si punëdhënë, kjo është shtëpia ime e dytë. Është diçka që kam shumë "borxh" ndaj UBT-së, prandaj jam duke e kthyer një pjesë të "borxhit".

UBT News: Kemi dëgjuar që e keni një nip dhe e doni shumë, çka keni planifikuar t'i blini për Vitin e Ri?

Berisha: Dikush që i dha kuptim jetës time padyshim është nipi im. Nipi për mua është kopsht i madh me lule që për çdo ditë më dhuron nga një lule me aroma të ndryshme dhe më bën të disponueshëm çdo herë. Nuk mundem t'i përshkruaj ndjenjat e mia ndaj tij. Nuk kam vendos ende sepse nuk varet nga unë se çka do t'i blej, kjo varet ekskluzivisht nga ai, vetëm këtë e di duhet të jem i përgatitur për shopping me të.

UBT News: Mesazhi juaj për Vitin e Ri?

Berisha: Familjen time të ngushtë, të gjerë, farefisit tim, miqve, studentëve të UBT-së dhe studentëve të tjerë, gjithë njerëzve të botës ju dëshiroj fillimisht shëndet, suksese të njëpasnjëshme gjatë vitit 2014 dhe viteve me radhë. Mesazhi për UBT-në do të ishte që edhe më tutje të vazhdon të kultivoj në vete traditën e universiteteve botërore të cilësisë.

Realizuan intervistën:
Albina Zeneli dhe Anisa Rada

INTERVISTË MË PROF.DR. IBRAHIM KRASNIQIN, DREJTOR PËR ÇËSHTJE AKADEMIKE NË UBT

UBT NË RANG ME UNIVERSITETET EVROPIANE DHE AMERIKANE

“UBT në fakt nuk ngelet prapa universiteteve evropiane dhe amerikane. Kjo për faktin se është orientuar drejt cilësisë si standard i edukimit që garanton të ardhme dhe për këtë arsye gjeneratat që dalin nga këtu në fakt e kanë të lehtë rrugën e integrimet në tregun e punës”, thotë dr. Krasniqi për ‘UBT News’

UBT News: Rugëtimi për punësimin e Juaj në UBT?

Krasniqi: Në realitet ka pasur një tërheqje të dyanshme për bashkëpunim nisur nga fakti se kam njohur kohë më përpara Presidentin e UBT-së dhe kjo ka zgjatur deri në një moment kur është arritur një pajtueshmëri për bashkëpunim bazuar në cilësinë dhe reputacionin e UBT-së që përputhet me vizionin tim për një edukim cilësor universitar.

UBT News: I nderuari Krasniqi, po bëhen thujt më shumë se një vit që keni filluar punën në UBT, njëherë si profesor në Fakultetin për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, dhe ngadalë u ngjitet deri te një pozitë e rëndësishme për institucionin, si Drejtor për çështje akademike. Natyrisht si dhe pse vendosët që të merrni edhe këtë pozitë?

Krasniqi: Në fakt ka qenë një dëshirë e dyanshme për të shtyrë edhe më tej përpara çështjet akademike në UBT dhe për të forcuar pozicionin e institucionit që nënkupton se jam shprehur i gatshëm ta marrë këtë pozitë të rëndësishme me qëllimin e vetëm që të avancoj edhe më tej aspektin kualitativ që ofron institucioni, të thellohet edhe më shumë qasja akademike e stafit dhe profesorëve me studentët në qendër të vëmendjes së institucionit dhe të punohet më shumë drejt profilizimit të të gjitha fakulteteve në kuadër të UBT-së.

UBT News: I nderuari Krasniqi, përveç që keni një shkollim nëpër universitete prestigjioze nëpër vende të ndryshme të botës, keni



punuar edhe si ligjërues nëpër këto universitete. Nabëni një krahasim gjeneral mes atyre ku keni ligjëruar me UBT-në?

Krasniqi: UBT në fakt nuk ngelet prapa universiteteve evropiane dhe amerikane. Kjo për faktin se është orientuar drejt cilësisë si standard i edukimit që garanton të ardhme dhe për këtë arsye gjeneratat që dalin nga këtu në fakt e kanë të lehtë rrugën e integrimet në tregun e punës. Kjo mbështet faktin se pothuaj të gjithë të diplomuarit nga këtu kanë një vend pune, shpesh edhe në vende të rëndësishme udhëheqëse e që UBT-në e bën të jetë e krahasueshme me universitetin ku unë kam studiuar dhe punuar. Edhe këtu mësimi është i orientuar drejt ndërlidhjes së pjesës teorike me atë praktike dhe hulumtuese që dëshmon edhe seriozitetin e punës këtu.

UBT News: Prej se jeni ardhur në këtë pozitë, çka keni ndërmarrë për përmirësime dhe projekte shtesë për UBT?

Krasniqi: Si çdokund edhe këtu gjithmonë ka vend për përmirësim dhe nga ardhja ime në këtë pozitë synimi im ka qenë dhe mbetet avancimi i institucionit si në aspektin akademik poashtu edhe në atë hulumtues. Mendoj se për këtë periudhë të shkurtër janë bërë përmirësime edhe në aspektin e funksionalizimit organizativ dhe ajo që më mendoj është e arritur kryesore është se në mënyrë të rregullt është avancuar debati për të gjitha çështjet akademike në çdo nivel të UBT-së. Është synimi im dhe i UBT-se që edhe më shumë të punojmë drejt avancimit të hulumtimit shkencor dhe

të arrijmë të jemi konkurrentë në nivel evropian në të gjitha fushat e studimit që ne i ofrojmë.

UBT News: Për thirrjet akademik brenda institucionit, kjo punë përveç presidentit Hajrizi ndërlihet edhe me pozitën e Juaj. Deri ku është arritur në këtë drejtim?

Krasniqi: Ne kemi përgatitur Rregulloren e avancimit në tituj akademikë për stafin e UBT-së, e cila është nënshkruar nga rektori i UBT-së, pastaj kemi bërë një shpallje publike për stafin që të aplikojnë për avancim në thirrje dhe ndërkohë janë konsultuar profesorë ndërkombëtarë për ta finalizuar procesin. Shpresojmë që shumë shpejt ne do të kemi rezultatet e para dhe pas kësaj i gjithë procesi do të jetë më i lehtë dhe secili që synon të punojë në të ardhmen në UBT si staf akademik do t'i nënshtrohet këtij procesi.

UBT News: Ju keni menaxhuar edhe disa dikastere të rëndësishme të vendit në qeveritë e pasluftës, qoftë si Sekretar i Përgjithshëm apo Drejtor Departamenti në ministri përkatëse. Natyrisht është më mirë dhe më lehtë të punosh në institucione arsimore apo në institucione publike qeveritare?

Krasniqi: Në fakt nuk është lehtë nëasnjerë në qoftë se përgjegjësia kuptohet si obligim për përbushje të objektivave institucionale, por dallimi është se puna në institucione publike ka më pak mundësi kreativiteti, ndërsa në institucione arsimore universitare kjo komponentë është shumë më e theksuar, prandaj edhe satisfaksion është shumë më i madh. Por në të dy rastet duhet vullnet, për-

kushtim dhe angazhim nëse doni që të ecni përpara.

UBT News: Konkretisht, në kontekst me stafin, na thujt sa jeni të kënaqur me punën që bëhet në UBT?

Krasniqi: UBT ka ndërtuar një staf dinamik akademik, i cili bazohet në praktikën e mira të universiteteve moderne dhe kjo ka bërë që edhe të jetë lider i cilësisë dhe inovacionit në shumë fusha studimore në vend dhe më gjerë. Unë mund të them që ky staf meriton respekt për punën që bën, por patjetër që ende ka vend për përmirësim nëse duam të jemi dhe të qëndrojmë si institucion lider në arsimin e lartë.

UBT News: I nderuari Krasniqi, cilat janë risitë për vitin 2014?

Krasniqi: Viti 2014 besoj që do të vazhdojë të jetë vit i sukseseve të UBT-së dhe studentëve të tij dhe kjo nuk paraqet risi. Ne do të vazhdojmë edhe të thellojmë pjesën e hulumtimeve ku studentët tanë do të jenë të involvuar, pastaj do të organizojmë për herë të parë Universitetin Ndërkombëtar Veror në korrik 2014 me pjesëmarrje të studentëve nga universitete evropiane dhe UBT. Jeminë vazhdim të kompletimit të Laboratorëve për Fakultetin e Ndërtimit dhe Infrastruktura dhe Mjedis, Laboratorin e Mediave... e të mos i përmend të gjitha, sepse mund të bëhet një listë e gjatë. Ne shpresojmë që vitin tjetër procesi i akreditimit të programeve të sjell edhe disa programe të reja për studentët potencialë të UBT-së dhe krahas gjithë këtyre risive jemi në hapat finalë të vendimmarrjes për iniciimin e punëve në objektin e radhës në Kampusin Inovativ në Lipjan.

UBT News: Mesazhi për studentët dhe stafin e UBT-së për vitin 2014?

Krasniqi: Për studentët mesazhi është i thjeshtë - punoni dhe studioni shumë, sepse ky është investimi i vetëm i sigurt në të ardhmen tuaj, ndërsa për stafin mendoj se mesazhi i vetëm është që të vazhdojnë të identifikohen me institucionin më të mirë të edukimit universitar në vend, sepse kjo u bën nder edhe atyre.

Krejt në fund, të gjithë studentëve të UBT-së, Stafit Akademik dhe atij administrativ ua uroj festat e fundvitit, me urimin që vitin tjetër të jemi edhe një hap më tej në përbushjen e misionit tonë.

Gëzuar!

Intervistuan: Egzona Arifi, Besart Troshupa, N. Demiri

UBT NË VAZHDIMËSI PËRFITON PROJEKTE NGA TEMPUS-I

Prishtinë, 26 tetor 2013 - UBT prej themelimit në vazhdimësi është përfituese e projekteve ndërkombëtare të sektorit të arsimit në Evropë dhe më gjerë. Përveç të tjerave, po gjatë këtyre ditëve UBT është përfituese nga projektet Tempus, projekt i Bashkimit Evropian.

Ky projekt, përveç të tjerave, ka për qëllim të zhvillojë programin e studimit për energji efiçente, në bashkëpunim me disa nga universitetet më prestigjioze si nga rajoni dhe Evropa.

Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, tha se UBT, në vazhdimësi përkrahët nga projekte për zhvillimin e programeve të studimit që ofrohen përmes Komisionit Evropian.

UBT NËN SHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN FATIH NË TURQI

Prishtinë, 26 dhjetor 2013 - Është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit Ndëruniversitar në mes të UBT-së dhe Universitetit Fati në Stamboll të Republikës së Turqisë.

Më konkretisht, kjo marrëveshje parasheh mundësinë e bashkëpunimit ndëruniversitar në të gjitha nivelet e studimit, si dhe shkëmbimin e stafit akademik dhe të studentëve, projekte të përbashkëta zhvillimore dhe hulumtuese, studentët të organizojmë seminare dhe takime tjera akademike për çështje shkencore, përdorimin e bibliotekave përkatëse për nevojat të studimeve dhe hulumtimeve shkencore, programe të studimit në distancë, zbatimin e përbashkët të programeve studimore, aktivitetet lidhur me kurset verore dhe takime tjera akademike për çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet.

Bashkëpunimi ndëruniversitar në mes UBT dhe universiteteve më të njohura në Republikën e Turqisë, ka filluar edhe më herët, po në këtë vit kalendari është nënshkruar edhe marrëveshja e bashkëpunimit ndëruniversitar me Universitetin "Mimar Sinan",

Universitetit Fati, sot renditet në listën e universiteteve të kategorisë botërore dhe është universiteti me nam në vend, ka numër të madh të studentëve, programeve të studimit që ofron, gjithashtu ka bashkëpunime ndërkombëtare me përmasa botërore, dhe një numër të madhe të stafit akademik.

EKSPOZITA TRADICIONALE UBT 2013

STUDENTËT KANË MUNDËSI TË SHUMTA TA SHPREHIN TALENTIN

Prishtinë, 11 qershor 2013 - Në ambiente të Kampusit të ri të Universitetit UBT, u hap Ekspozita tradicionale UBT 2013, në të cilën janë ekspozuar mbi 100 punimet e studentëve të Departamentit të Arkitekturës të këtij Universiteti.

Të pranishëm në ceremoninë e hapjes së ekspozitës ishin studentë dhe profesorë vendorë e ndërkombëtarë, prindër, përfaqësues të institucioneve të vendit, përfaqësues të universiteteve dhe institucioneve të tjera partnere të UBT-së, etj.

Ekspozita u shpall e hapur nga prodekani i Departamentit të Arkitekturës në UBT, Dr. Binak Beqaj, presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, zëvendës presidenti i UBT-së prof. dr. Mo. Vaziri, zëvendës rektorjae Universitetit të Varshavës, prof. Marta Kicinska-Habiov, e cilapas aktit solemn të nënshkrimit të marrëveshje ndëruniversitar, bashkëme delegacionin e saj, kanë marrë pjesën në hapjen e kësaj ekspozite, po ashtu në hapjen kanë marrë pjesë edhe prof. Fatmir Krypa, can. dr. Ajhan Bajmaku, dipl. inxh. Mimoza Sylejmani, can. msc. Vlora Aliu, etj. I pranishëm në ceremoninë e hapjes së ekspozitës ishte edhe Udhëheqësi i Zyrës për Aftësim dhe Arsimit Privat në MASHT, Osman Shahini,

"Ekspozita në UBT është bërë tradicionale në çdo vit në muajin qershor të kemi të paraqitura punimet e studentëve tanë. Ky është një grumbullimi punës dhe përvojave të palodhshme të studentëve dhe të profesorëve që nënkupton shkëmbimin e përvojave dhe njohurive për një temë të caktuar, dhe kjo që po shihet është puna njëvjeçare që është bërë nga studentët në bashkëpunim me profesorët e tyre", tha Dr. Binak Beqaj.

Po ashtu, gjatë kësaj ekspozite u dhanë edhe mirënjohje disastudentëve për punën e tyre të suksesshme si: *Albulena Doli, Luiza Hoxha, Labinot Sylja, Albana Krasniqi, Rozafa Dërguti, Donjeta Duraj, Nora Zejnullahu, Ardian Maliqaj, Fatlum Ejupi, Armend Begisholli, Qendrim Sejdiu, Leart Stavileci, Erëza Këpuska, Fistin Bllaca, Mergime Krasniqi, Arta Jashari, Besart Gashi, Ledri Mahmuti, Ermal Krasniqi, Anyla Berisha, Alma Rapuca, Nazuf Kabashi, Baton Mekulli, Aida Bakalli, Driton Tahiri, Muharrem Cani, Merita Shahini, Laberi Daka, Diamant Bytyqi, Alban Azemi, Leonard Emiri, Ard Gashi, Arben Lushi, Alban Misini, Flamur Imeri, Florim Gashi, Gentiana Xhemajli, Premtim Reçica, Ilirida Rama, Agon Gacaferri, Zana Prelvukaj, Ibrahim Krasniqi, Shkëndije Ramadani, Shahindere Krasniqi, Ruzhdi Dakaj, Liridona Gërguri, Driton Begisholli, Suad Morina, Festina Bucaliu, Florim Maloku, Bujar Statovci, Nora Lika, Emel Vërbiqi, Dodona Blakaj, Vesa Shasivari, Kadri Krasniqi, Anduena Hundozi, Fastina Mustafa, Armend Begisholli, Driton Begisholli, Festina Avdija, Donika Xhakli, Arta Abdyli, Drenushë Taçi, Altin Sytka, Fjolla Abazi, Albulena Doli, Ardian Maliqi, Durim Zeka, Florim Kosumi, Azize Popaj, Muidin Ibrahim, Shkëndije Ramadani, Kujtim Ahmetaj.*

Sipas të pranishmëve, kesi lloj ekspozita kemi të pakta në përgjithësi nëpërinstitucione, kurse në UBT studentët kanë mundësi më të shumta të shprehin talentin e tyre dhe të komunikoj me publikun. Po ashtu edhe studentët këtij fakulteti ndihen të privilegjuar meqë u ka dhënë mundësi të prezantojnë punën vet para një audience profesional dhe të gjerë.



UBT BASHKËPUNON ME INSTITUTIN GJYQËSOR TË KOSOVËS

17 qershor 2013 - Me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në pajtim me qëllimet dhe interesat e përbashkëta, presidenti i Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT), prof. dr. Edmond Hajrizi, nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, Mr. sc. Lavdim Krasniqi.

Kjo marrëveshje e dëshmon qëllimin e të dy institucioneve që të fillojnë dhe zhvillojnë bashkëpunim të ndërsjellët në procesin e edukimit dhe punën kërkimore-shkencore.

Po ashtu marrëveshja parasheh se dy institucionet do të marrin pjesë në programet arsimore dhe shkencore, do të angazhohen të realizojnë projekte kërkimore-shkencore me interes të përbashkët, konferenca shkencore, simpoziume, seminare, punëtori profesionale.

Po ashtu, do të shkëmbejnë libra, revista, publikime dhe literaturë shkencore me interes të përbashkët, si dhe shkëmbimin e përvojave dhe krijimin e hapësirave që studentët e UBT-së të realizojnë aktivitetet praktike në IGJK.

Presidenti i UBT, dr. Hajrizi, pas nënshkrimit të marrëveshjes theksoi se UBT ka qenë gjithëherë aktive në ofrimin e mundësive për të ndihmuar dhe



zhvilluar të gjitha institucionet vendore, duke dhënë kontribut nga ana shkencore dhe profesionale, me anë të stafit akademik dhe infrastrukturorë.

Sipas krerëve të të dyja institucioneve, ky ishte vetëm hapi i parë në rrugën e një bashkëpunimi të mirëfilltë dhe afatgjatë për të ardhmen.

VAZHDON BASHKËPUNIMI MES UBT-SË DHE MINISTRISË SË DIASPORËS



Prishtinë, 19 qershor 2013 - Qendra për Karrierë dhe Internship në Universitetin UBT në bashkëpunim me Ministrinë e Diasporës, filluan të zbatimin e projektit për Internship të studentëve të këtij Universiteti.

Më saktësisht, përmes këtij projekti, rreth 80 studentë të Universitetit UBT, do të marrin pjesë në programin Internship në Ministrinë e Diasporës në Prishtinë dhe një pjesë do të akomodohen në të gjitha Qendrat komunale për shërbime të Diasporës.

Më saktësisht projekti zgjat deri në tremuj dhe u ofron studentëve mundësi të ndjekin punë praktike profesionale dhe të aftësohen për t'u integruar në procesin e punës, dhe përfitimet e këtij programi janë shumë dimensionale, si për Ministrinë dhe qendrat, të cilët përfitojnë nga studentët pa kosto të shkolimit të tyre, gjithashtu edhe për studentët, të cilët kanë mundësi të mësojnë praktikisht ato që nuk kanë arritur përmes teorisë.

"Këtë vit ne do të gjejmë formë të ndryshme të bashkëpunimit me të gjithë partnerët tanë me qëllim që të përgatisim studentët të qasën me sukses tregut të punës", tha Udhëheqësi i Qendrës për Karrierë dhe Internship, z. Halil Bashota.

UBT BASHKËPUNON ME IPKO FOUNDATION

Prishtinë, 25 qershor 2013 - Gjatë aktivitetëve të "Ipko Foundation", është ka zhvillohet edhe programi "Basic Education Program", i cili program ka krijuar klubet të teknologjisë nëpër shkollat fillore, me qëllim që nxënësit të zhvillojnë shkathësitë e tyre në lë-

min e IT me organizimin e projekteve të ndryshme.

Gjithashtu, në kuadër të këtyre aktivitetëve u zhvillua edhe një vizitë në UBT, pikërisht në Departamentin e Mekatronikës, ku më theks të veçantë vizituan Laboratorin e këtij Departamenti,

si dhe ndjekën një ligjëratë për lëminga të mëdha të cekura më parë të dr. Muzafer Shala dhe Kushtrim Dragusha.

Nxënësit dhe organizatorët e këtij projekti u ndanë të kënaqur me vizitën dhe pritjen etyre në UBT.



ZËVENDËSAMBASADORI I NORVEGJISË DELEGACIONI NGA UNIVERSITETI GJOVIK VIZITUAN UBT-NË

UBT NË VAZHDIMËSI BASHKËPUNON ME UNIVERSITETIN GJOVIK NË NORVEGJI

Prishtinë, 1 korrik 2013 - Zëvendësambasadori i Norvegjisë për Kosovën Jon Hansen, me një delegacion nga Universiteti Gjovik në Norvegji, i prirë nga rektoriprof. dr. Jørn Wroldsen dhe menaxhmenti i këtij universiteti, në fund të javës së kaluar vizituan UBT-në dhe utakuan me stafin akademik dhe me presidentin e këtij institucioni prof. dr. Edmond Hajrizin, për të filluar më konkretisht bashkëpunimin ndëruniversitar.

Me këtë rast, presidenti i UBT-së prof. dr. Edmond Hajrizi, së bashku me delegacionin nga Universiteti Gjovik, dhe nga zëvendësambasadori për Kosovën Jon Hansen, në lokalet e



UBT, në Prishtinë biseduan zyrtarisht me të gjithë profesorët vendorë dhe ndërkombëtarë për të qenë pjesë e programeve të përbashkëta studimore të cilat

i kanë aktuale dhe për projekt tjera më të rëndësishme.

Më konkretisht me këtë universitet UBT bashkëpunimi e

ka filluar tri vite më parë përmes projektit Academic Exchange for Progress (AEP), i financuar nga Qeveria Norvegjeze, dhe nga ky projekt përfitojnë stafi

akademik dhe studentët e UBT, në të gjitha nivelet e studimit dhe partneri akademik nga Norvegjia është Gjovik University College. Ky projekt ka për qëllim avancimin në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni. Vlen të theksohet se UBT është institucioni vetëm privat nga Republika e Kosovës dhe rajoni që është përfitues nga ky projekt.

Durim Jusaj dhe Lavdim Menxhiqi, janë përfitues të këtij projekti, të cilët dy vitet e para të studimeve i ka përfunduar në Departamentin Shkencave Kompjuterike në UBT, kurse vitin e fundit në Universitetin Gjovik në Republikën e Norvegjisë, në Departamentin e Shkencave Kompjuterike.

REPUBLIKA E KOSOVËS ME SHUMË INVESTITORË

Prishtinë, 27 qershor 2013 - UBT- "Quality Kosova" në bashkëpunim me "Czech INVENT", gjatë këtij fund muaji për 5 dite më radhë, organizuan një vizitë studimore në kryeqendrën e Republikës së Çekisë.

Përveç kryetarëve të komunave të Republikës së Kosovës, të pranishëm në vizitë ishin edhe përfaqësues të Komunave pjesëmarrëse në kuadër të trajnimit dhe akreditimit të zyrta të komunave për tërheqje të investimeve të huaja direkte në Kosovë.

Interesimi i palëve pjesëmarrëse në vizitë ishte që për së afërmi ta shohin zhvillimin lokal, zhvillimin e zonave ekonomike, të parqeve, bizneseve, për të bërë

promovimin e investimeve të huaja në rajonet e Republikës së Kosovës tek investitorët potencialë çekë. Poashtu gjatë vizitës u diskutua edhe për përvojat e mira ceke në fushën e planifikimit të zhvillimit afatmesëm strategjik në nivel lokal, përvoja këto që nga zyrtarët Komunesë Ferizajt u vlerësuan si të mirëseardhura sidomos në kohën kur UBT është në fazën finale të hartimit të Strategjisë për zhvillim afatmesëm të Ferizajt.

Sipas mendimit të përfaqësuesve të UBT-së, dr. Ibrahim Krasniqi dhe can. dr. Lulzim Beqirit, pjesëmarrësit kanë përfituar shumë me faktin se në mënyrë direkte kanë pasur rastin të shohin të arritura të mëdha

të komunave dhe kompanive ceke në sferën e zhvillimit dhe të investimeve e që do të shërbejnë si model edhe për Komunitet e Kosovës.

Quality Kosova është themeluar dhe drejtohet nga UBT dhe e pranuar me të drejta të plota si anëtare e Organizatës Evropiane për Cilësi (European Organization for Quality).

Quality Kosova funksionon që nga viti 2006 dhe është asociacion që merret me çështjen e kualitetit, standardeve, certifikimeve dhe konfirmimit. Promovon cilësinë në Kosovë, në bazë të standardeve evropiane dhe ndërkombëtare, merret me certifikimin e sistemeve e produkteve, si ISO 9001 e të tjerë.



ASOCIACIONI I ARKITEKTËVE TË KOSOVËS DHA MIRËNJOHJE PËR PROFESORIN E UBT-SË

Prishtinë, 4 korrik 2013 - Profesorin Binak Beqaj, për kontributin e lartë në edukimin ngafusha e arkitekturës, Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës i shenjë respektive nderoi me Mirënjohje.

Dr. Sc. Binak Beqaj është profesori rregullt dhe udhëheqës në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT. Z. Beqaj, ka përfunduar me sukses studimet e doktoratës në Universitetin e Vjenës për Teknologji dhe ka marrë titullin Doktor i Shkencave Teknikë, është nder doktorët e parë të shkencave ngafusha e planifikimit dhe menaxhimit urban në Kosovë. Nga viti 2005, në UBT, me sukses udhëheq programin e studimeve universitare për arkitekturë dhe planifikim hapësinor. Gjithashtu është pjesëmarrës me punime profesionale në shumë konferenca dhe simpoziume vendore e ndërkombëtare, ka të publikuara numërtë madh të punimeve ngafusha hulumtimit profesional dhe shkencore me tematika aktuale nga fusha e arkitekturës, urbanizimit. Ka të botuara dy libra si "Menaxhimi Urban" dhe "Projektimi i konstruksioneve arkitektonike". Është anëtar i shume organizatave dhe asociacione ndërkombëtare e profesionale. Në prill 2013, si mësimdhënës është ftuar dhe ka mbajtur ligjëratë tematike në Universitetin "Mimar Sinan" në Stamboll.

Kryetari Valdet Osmani në emër të shoqatës falënderoi edhe ish drejtoreshën ekzekutive Vjola Aliun, e cila njëherit është asistente ligjëruese në UBT, e cila gjatë tërë kohës me punën e saj profesionale ka qenë aktive në këtë shoqatë. Gjithashtu z. Osmani, falënderoi edhe can. dr. Arbër Sadiku, asistent ligjërues në Departamentin e Arkitekturës në UBT, njëheri edhe anëtar i kryesisë së Asociacionit të Arkitektëve të Kosovës.

Në ceremoni e ndarjes së mirënjohjes për prof. Binak Beqaj, në hotelin "Swiss Diamond" të pranishëm ishin një numër i madh i mësimdhënësve dhe studentëve të arkitekturës, arkitektë, përfaqësues të biznesit dhe përfaqësues të Republikës së Kosovës.



UBT DHE UNIVERSITETI I TIRANËS ORGANIZUAN KONFERENCË NDËRKOMBËTARE



Tiranë, 11 korrik 2013- UBT në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës (UT) organizuan konferencën dyditore shkencore në nivel ndërkombëtar me temën "Sistemet e Informacionit dhe Teknologjitë inovativedrejt një ekonomie digjitale". Konferenca u organizuanën patronazhin e Akademisë të Shqipërisë dhe u mbajt në kryeqendrën e Republikës së Shqipërisë, Tiranë.

Përveç krerëve të tertia institucioneve organizatore, si Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, Rektori i Universitetit të Tiranës (UT), Dhori Kule dhe Kryetar i Akademisë së Shkencave (ASHK), Gudar Beqiraj, në hapjen solemne morën pjesë edhe përfaqësues të lartë të Republikës së Shqipërisë.

Duke përshëndetur konferencën, dr. Hajrizi vlerësoi lart

bashkëpunimin midis institucioneve shkencore të të dyja shteteve, bashkëpunimi i cili duhet të intensifikohet edhe më tej, në mënyrë që të shkëmbehen përvojat dhe të arrihen rezultate edhe më të mëdha në hulumtimet dhe inovacionet shkencore, në mënyrë që studentët dhe ekspertët shqiptarë nga të dy shtetet të ecin krahas kolegëve të tyre nga shtetet më të zhvilluara botore në

fushën e ekonomisë dhe teknologjisë.

Kurse prof. dr. Kozeta Sevrani, organizatore e Konferencës dhe përgjegjëse e Departamentit Matematikë, Statistikë dhe Informatikë e Zbatuar në UT, përveç që i përshëndeti të pranishmit ndër tjera tha: "Tashmë të gjithë e dimë që ndër prioritetet e qeverisë shqiptare është zhvillimi i ekonomisë degjitale. Këto prioritetet nuk mund të kuptohen pa nxitjen e inovacioneve dhe investimeve të rëndësishme në edukim dhe kërkim shkencor. Gjithashtu, kjo nënkupton dhe ofrimin e kurrikulave që çojnë në hartimin e njohurive në fushën e TIK. Për këtë arsye, të gjithë aktorët kryesorë që lidhen me zhvillimin e TI në vend duhet të shkrijnë idetë, forcat, kapacitetet dhe fuqitë e tyre për të qenë pjesë e kësaj shoqërie si dhe për t'i bërë ballë sfidave të së ardhmes".

Ajo falënderoi sponsorët e kësaj konference, akterë të njohur të tregut shqiptar, të cilët me da-

shamirësinë e tyre ofruan mbështetjen e tyre për zhvillimin e kësaj konference dhe konkretisht:

Për dy ditëmë radhënë konferencë mblodhën një numër i madh ipedagogëve, studiuesve dhe ndërmarrjeve të fushës së IT-së nga shumë vendetë rajonit dhe Evropës. Janë paraqitur mbi 150 punime shkencore, dhe u kumtuuan në disa sesione paralele që i dha konferencës një karakter shumë të rëndësishëm me peshë shkencore. Paraqitësit e kumtesave, përveç nga Shqipëria dhe Kosova, ishin edhe ngashtete e shumta të Evropës.

Konferenca i përmbylli punimet me konstatimin e përbashkët se ngjarje të tilla të nivelit ndërkombëtar shënojnë edhe një të arritur të madhe të UBT-së dhe institucioneve partnere në Shqipëri, bashkorganizatorë të konferencës, si dhe dëshmojnë nivelin e lartë të zhvillimit në këtë fushë, duke qenë të barabartë me institucionet më prestigjioze botërore.

STUDENTËT E LIPJANIT GËZOJNË ZBRITJE 50 PËR QIND PËR REGJISTRIM NË UBT

Prishtinë, 18 korrik 2013- Është nënshkruar marrëveshja e Bashkëpunimit në mes të presidentit të UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi dhe kryetarit të Komunës së Lipjanit, zotri Shukri Buja, i cili iu mundëson lehtësime në regjistrim të gjithë atyre duan t'i ndjekin studimet në këtë institucion. Madje, atyre iu ofrohet 50 për qind zbritje nëse regjistrohen në UBT.

Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ka thënë se, komuna Lipjanit ka ndihmuar shumë. "Komuna ka bërë një investim, duke ndarë një pjesë të tokës. Për këtë ne duhet t'ia shpërblejmë në rënd të parë qytetarëve, e, veçanërisht rinisë studentore të Lipjanit, së pari me edukim cilësor, e dyta edhe me mundësi financiare. Këtë e them, duke krijuar rrethana lehtësuese në pagesë për studentët nga Komuna e Lipjanit. Prandaj, ne do të shikojmë mundësi tjera për ta ndihmuar komunën e Lipjanit edhe duke qenë afër për ta mbështetur zhvillimin ekonomik të komunës, mandej duke mbështetur projekte për zhvillim të bizneseve, projekte për zhvillim të arsimit etj. Ne kemi menduar ta bëjmë një inkubator të biznesit, ku mund të gjenerojnë biznese të reja, sepse ekziston dija, ekziston mundësia, sepse ne i përkrahim derisa ata të stabilizohen, e kur të stabilizohen ata dalin prej inkubatorit dhe vazhdojnë së vepruari të pavarur. Ky inkubator nuk mund të dështojë, sepse për dallim me



inkubatorët tjerë, ky në Lipjan e ka institucionin e UBT-së afër. Pastaj kemi mundësi të mira për mbajtur seminare, ligjërata për zhvillimin dhe avancimin e biznesit", ka deklaruar Hajrizi, duke shtuar: "Pra ne jemi në gjendje t'i rrisim kapacitetet e reja hulumtuese dhe profesionale, duke rritur cilësinë në shumë sfera të studimeve bashkëkohore, por edhe në ndërkombëtarizmin e saj". "Kemi infrastrukturë tani që na mundëson t'u përgjigjemi sfidave të shumta që kërkon zhvillimi i vendit. Nëpërmjet laboratorëve

bashkëkohorë, infrastrukturës dhe kompetencës profesionale ne si staf drejtues do t'i përgjigjemi sfidës së prodhimtarisë vendore nga laboratorët e robotikës dhe të teknologjisë më të avancuar do të arrijmë cilësinë edhe në prodhimtarinë e vendit do ta ulim importin dhe do ta rrisim eksportin", ka thënë ndër të tjera Hajrizi.

Hajrizi ka treguar se si UBT i kanë marrë edhe disa programe të reja siç janë: Programi i Ndërtimitarisë, Shkencat Politike dhe Mediet e Komunikimit, etj.

Ndërkaq kryetari Buja ka thënë se "ne kemi dal me projektin për ta ndërtuar UBT-në dhe pas ndërtimit të një pjese, tash e ndien qytetarët se ajo ide për ndërtim ishte e mirëseardhur, mirëpo jo në atë shkallën sa mund ta ndiejnë tani, për shkak se gjithmonë ajo ideja se nuk do të përfitojmë se përfitojnë një shtresë e caktuar, mirëpo krejt ideja kur e kemi nisë këtë, ka qenë që të përfitojnë qytetarët dhe sidomos qytetarët e Lipjanit. Qytetarët e Lipjanit me këtë marrëveshje fitojnë shumë, në

veçanti djemtë dhe vajzat e reja, sepse heqja 50 %, apo forma e kursimit 50 % e shumës të studimeve, do të thotë se është një shumë e madhe, e cila është ngarkesë për juve dhe e mirë për qytetarët, për ata që dëshirojnë të studiojnë e sidomos kur flitet për studimet e veçanta e që janë akredituar tani", është shprehur Buja.

Kampusi i ri i UBT-së është në magjistralen Prishtinë-Shkup, 8 km larg Prishtinës, ku përrurimi i këtij kampusi është bërë në fund të vitit të kaluar, ku shiritin inaugurues, para shumë të pranishmeve ekanë prerë, Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Prof. Dr. Ramë Buja dhe kryetari i Lipjanit, Shukri Buja, objekt ky i cili u cilësua si i rëndësishëm së veçantë dhe me një koncept të ri për zhvillimin e sistemit universitar eshkenor.

Bashkëpunimi ndërinstitucional mes UBT-së dhe Komunës së Lipjanit patë filluar në tetor të 2009-së, në Kuvendin Komunal të Lipjanit u patë nënshkruar kontratë midis Kuvendit Komunal të Lipjanit dhe të UBT-së për lokacion e ri, afër QMI-së, për ndërtimin e kampusit të ri të UBT-së. E patë nënshkruar presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi dhe kryetari i Kuvendit Komunal të Lipjanit, zotëri Shukri Buja.

I ZHVILLOI PUNIMET AKADEMIJA VERORE 2013



Prishtinë, 2 korrik 2013 - UBT në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha Fakultete, stafin akademik dhe ekspertë të shumtë, për herë të dytë ka organizuar "Akademinë Verore 2013", i cili është aktivitet unik dhe atë në nivel vendorë dhe ndërkombëtarë.

Në këtë aktivitet, në të cilin ishin të pranishëm studentët e profesorët të UBT-së, përfaqësues të lartë të Qeverisë së Kosovës, ekspertë nga fusha e ndërmarrësisë dhe mysafirë të tjerë, presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ka thënë se "ky aktivitet është pjesë e planit tradicional dhe strategjik të UBT-së, për t'i plotësuar studimet tona më bashkëkohore si për nga përmbajtja dhe ushtrime praktike dhe vizita të shumta të komuniteti i biznesit". "UBT-ja si mision të vetin ka ofrimin e studimeve të shekullit XXI dhe kjo akademi është një shembull i përpjekjeve të tilla", ka theksuar ai.

Ndërkaq ministri i Zhvillimit Ekonomik i Republikës së Kosovës, Fadil Ismajli është shprehur se "sot në vendin tonë ka një rini bukur të madhe dhe të gatshme për punë, gjithashtu ka edhe një ambient të mirë për investime". "Ne si qeveri jemi të përkushtuar t'i ndihmojmë dhe t'i përkrahim të gjithë ndërmarrësit kosovarë për ndryshime për të mirën e këtij vendi", ka thënë ai, duke shtuar se në UBT, studentët marrin edukim cilësor, të cilët në një të ardhme të afërt mund të bëjnë ndryshime pozitive dhe të ndikojnë direkt në rritjen e mirëqenies së përgjithshme.

Edhe prof. Engelbert Selenko, ka theksuar se ky aktivitet ka për qëllim që pjesëmarrësve t'ju ofrojë një program të ndërmarrësisë inovative si dhe do t'ju mundësojë të zbulojnë ide të reja për produkte dhe njohuri të mirëfillta për zhvillimin e suksesshëm të këtyre produkteve".

Nita Abrashi, koordinatore e këtij aktiviteti, ka bërë me dije se gjatë ligjëratave pjesëmarrësit e akademisë do të punojnë në grupe të vogla, të cilat do të hartojnë ide të reja për produkte dhe biznese. "Po ashtu vizitat në terren do t'ju mundësojnë t'i njohin operimet e kompanive si dhe procesin e krijimit të tyre, pastaj do të mbahen edhe dëgjime nga rrëfimet e disa ndërmarrësve të suksesshëm vendorë. Ata do të takohen me ndërmarrës që operojnë në Kosovë dhe kështu do të kenë mundësi ta dëgjojnë nisjen e suksesshëm të bizneseve të tyre", ka theksuar ajo.

Dr. Sc. Binak Beqaj, udhëheqës në Departamentin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, ka theksuar se ky aktivitet ka për qëllim që pjesëmarrësve t'ju ofrojë një program që do t'ju mundësojë njohuri të reja të përgjithshme nga shume fusha tematike që nuk janë pjesë e programit të studimeve të rregullta".

Po ashtu akademinë e ka përshëndetur edhe Kryetari i Asociacionit Arkitektëve të Kosovës, z. Valdet Osmani, i cili theksoj se kam nderin që marrë pjesë në këtë ceremoni, në hapjen e një ngjarje kaq të rëndësishme për zhvillimin e profesionit të arkitektit dhe të shoqërisë në përgjithësi. Për ju të pranishëm të kësaj akademie, kjo javë le të jetë e shënuar me jetërat e Tuaja si një javë akademike dhe shumë e rëndësishme në aspektin profesional. Ai lavdëroj punën që po behët në Departamentin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, duke theksuar se këto suksese ndërlidhen edhe me vizionin e përgjithshëm zhvillimor të UBT-së.

Ndërsa, prodekani i Fakultetit të Juridikut, can. dr. Ardian Emini, tha se objektiva e kësaj akademie është që studentët e këtij Depar-

tamenti dhe studentet nga fushat tjera të studimeve që janë të interesuar të fitojnë njohuri nga e drejta kushtetuese si dhe bazat e saj.

Në përmbyllje të Akademisë verore 2013 u zhvillua ceremonia e dhënies së certifikatave të "Akademinë Verore 2013" për të gjitha fakultetet që ishin pjesë e Akademisë.

"Ky aktivitet ka pasur për qëllim që t'u ofrohet studentëve pjesëmarrësnjë program shumë prestigjioz, dhe gjatë këtij aktiviteti pjesëmarrësit me një orar të ngjeshur, kanë ndjekur ligjëratat të shumta dhe janë informuar rreth zhvillimeve më të fundit nga fusha ndërmarrësisë inovative, duke u nisur nga ato teorike dhe praktike si dhe për shumë metodat tjera. Gjithashtu pjesëmarrësit morën edhe aftësi për koncepte të ndryshme të ndërmarrësisë, për krijimin e ndërmarrjeve dhe produkteve të reja, zhvillimin e organizatave, karakteristikat e bizneseve familjare, gjetjen e kapitalit, hartimin e biznesplanëve të frytshme etj.", tha para të pranishmëve Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, gjatë ceremonisë solemne, ku përveç studentëve e profesorëve të UBT-së, morën pjesë, personalitete nga jeta politike vendore dhe ndërkombëtare, etj.

Gjatë këtij aktiviteti, më saktësisht gjatë ligjëratave pjesëmarrësit e akademisë kanë punuar në grupe të vogla, kanë hartuar ide të reja për produkte dhe biznese, po ashtu kanë zhvilluar vizitat në terren që kanë pas mundësi t'i njohin operimet e kompanive si dhe procesin e krijimit të tyre, pastaj umbajtën edhe dëgjime nga



rrëfimet e disa ndërmarrësve të suksesshëm vendorë. Studentët u takuan me ndërmarrës që operojnë në Kosovë dhe patën mundësi ta dëgjojnë nisjen e suksesshëm të bizneseve të tyre.

Ndryshe, punimet e kësaj akademie shkencore u përcollën edhe me disa vizitanëdisa kompani më të suksesshme të vendit si në "PESTOVA", "Raiffeisen Banka" dhe në fabrikën e ujit dhe djathit "Rugova". Gjatë vizitës ishin të pranishëm edhe zëvendës-presidenti i UBT, prof. dr. Mo Vaziri, si dhe profesorët e UBT-së.

Studentët përveç mikpritjes së ngrohët nga menaxherët elartë të kompanive në fjalë, ata për së afërmi panë prodhimin dhe u ndanë të kënaqurme të arriturat e tyre për produktin që ofrojnë në tregun vendor dhe më gjerë.

Ky aktivitet është financuar nga UBT-ja dhe punimet e tija u ndoqën gjatë muajit korrik 2013, paralelisht në të gjitha fakultetet. Përveç tjerash u përfshihen udhëtime të ndryshme në terren, me ç'rast u vizituan ndërmarrësit më të suksesshëm në tregun e Kosovës dhe në fund të punimeve

pjesëmarrësve ushpërndan edhe certifikata siq janë të cekur edhe më poshtë:

Emrat e studentëve të certifikuar në UBT të cilët i kanë ndjekur punimet e Akademisë Verore 2013:

Amir Morina, Valdrin Asllani, Hadi Salihu, Naim Preniqi, Samire Kurtishi, Nexhmedin Jashanica, Bekim Krasniqi, Sofije Kryeziu, Teuta Hyseni, Visar Ahmeti, Flamur Sadriu, Arbënora Maliqaj, Granit Shala, Bleritë Gara, Elfiqe Hoti, Flamur Hyseni, Bujar Sokoli, Shyhrete Kunushaj, Resmije Hajredini, Aulona Xharra, Fisnik Kingji, Rilinda Xharra, Laureta Miftari, Liridona Rama, Fatbardha Krasniqi, Fisnik Kingji, Shpend Zhuja, Hikmete Veseli, Florije Puka, Bardha Klinaku, Marigona Mahmuti, Liridona Rama, Laureta Miftari, Fatbardha Krasniqi, Bujar Sokoli, Bleranda Musa, Edison Zeka, Teuta Hyseni, Albulena Popaj, Hekuran Popaj, Nora Shabani, Faton Hyseni, Majlinda Hajrizi, Hana Govori; Blendina Llabjani; Bruno Neziraj; Berat Gajtani, Izet Hyseni, Leonarda Emini, Ardit Gashi, Ernes Hajdari, Baton Mekuli, Gentiana Xhemaili, Zana Tasholli, Mirela Qupevaj, Muharrem Cani, Rilind Duriqi, Arian Canta, Erjon Ajazi, Armira Mula, Albulena Doli, Krenare Mustafa, Ledri Mahmuti, Rrustem Brahmi, Ditnis Zekaj, Qëndresa Sokoli, Ideal Kolshi, Fatmire Beqiri, Vjosana Bujupi, Alma Rapuca, Aida Bakalli, Arta Nishori, Edin Salihu, Kushtrim Sylja, Era Nagavci, Shkumbin Isufi, Nazif Arifi, Muiddin Ibrahim, Xheneta Selmani, Drizona Macanil, Gresa Berisha, Mahmut Ajvazi, Rozafa Dërguti, Florim Gashi, Learta Salihu, Merita Asllani.



UBT I VETMI PRIVAT QË OFRON STUDIME TË DOKTORATËS JASHTË VENDIT

STUDENTI I UBT-së ME BURSË TË PLOTË, NIS STUDIMET E DOKTORATËS NË NORVEGJI



Prishtinë, 9 shtator 2013- Kushtrim Dragusha, i cili pas përfundimit të studimeve themelore dhe masternë UBT në Fakultetin Menaxhimii Mekatronikës, fiton bursëpërtë vijuar studimet e doktoratës (PhD) në Gjovik University, pikërisht në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike, dhëmerrpër tezë të doktoratës "Procesimi i imazheve ne video stream ne 2D dhe 3D".

"Studimet në UBT japin mundësitë përgatiten studente në nivelin e barabartë me studimet në shtetet e Bashkimit Evropian, gjithashtu edhe bashkëpunimii UBT-së me universitetet ndërkombëtare jep mundësitë jashtëzakonshme në shkëmbimin e njohurive", tha z. Dragusha për gazetën "UBT News".

Z. Dragusha, gjithashtu pas përfundimit të dy palë studimeve menjëherë angazhohet dhe vazhdoni ligjërues i disa lëndëve në UBT si: BTI, lab course BTI dhe robotike, dhe pjesëmarrës i shumë konferencave në nivel ndërkombëtar, poashtu edhe në garat e robotikës të zhvilluara si në UBT dhe jashtë Republikës së Kosovës.

Me një fjalë sikurse studentëtvetjerë përmes projekteve të ndryshëm, edhe z. Dragushës UBTja ka siguruar bursën për vazhdimin e studimeve të doktoratës përmes projektit AEP. Këtë mundësi studentëve në fjalë u ka mundësuar vetëm UBT-ja, që është i vetmi privat në vend, që është përfituese e projektit "Academic Exchange for Progress

(AEP), projekt i financuar nga Qeveria Norvegjeze, ku partneri kryesor akademik i këtij projekti është Universiteti Gjovik. UBT, këtë vit dhe për tre vitet e ardhshme është përfitues i projektit Academic Exchange for Progress (AEP), i financuar nga Qeveria Norvegjeze, dhe nga ky projekt përfiton stafi akademik dhe studentët e UBT, në të gjitha nivelet e studimit. Ky projekt ka për qëllim avancimin në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni. Përveç UBT-së, në kuadër të këtij përfshihen edhe disa universitete nga rajoni, por vlen të theksohet se UBT është i vetmi privat nga Kosova dhe rajoni që është përfituese nga ky projekt.

UBT STATS, QENDËR E VEÇANTË NË VEND

Prishtinë, 26 korrik 2013- Në kuadër të UBT-së funksionon, dhe gjatë këtyre ditëve u jetësua qendër e kompetencës për Statistika, Analiza dhe Parashikim - UBT STATS, e cilamerret me mbledhjen, organizimin dhe publikimin e të dhënave statistikore.

Para shumë të pranishmeve Presidenti i UBT-së, Prof. Dr. Edmond Hajrizi, tha se kjo qendër, lindi si nevojë e pasjes së një baze të të dhënave konsistente me praktikën statistikore ndërkombëtare, lehtësisht të konvertueshme për analiza kuantitative, ekonomike dhe për parashikime, si dhe modelime të ndryshme që do të ndihmojnë vendimmarrjen në nivel makroekonomik.

Qëllimi i UBT STATS, është të krijojë një bazë të të dhënave statistikore të Kosovës dhe të ofrojë informata statistikore të strukturuara dhe të krahasueshme në kohë për të gjithë të interesuarit. Po ashtu studentët e UBT-së për punimet dhe projektet e tyre do të mund t'i referohen këtyre të dhënave si burime të referencës, të organizuara në formë të qartë dhe lehtë të kuptueshme.

Frekuencat e të dhënave statistikore janë mujore, tremujore dhe vjetore. Burim i informatave lidhur me UBT STATS janë institucionet publike në Kosovë si: Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, etj. Në fazën e parë fokusi kryesor ka të bëjë me statistikat e sektorit real.

UBT STATS nuk pretendon në autorësinë e të dhënave të publikuara ku çdo informate statistikore të publikuar do t'i ceket burimi si një ndër parimet profesionale statistikore. Në fazat e mëtejshme të zhvillimit, UBT STATS do të angazhohet edhe në prodhimin vetanak të të dhënave përmes anketimeve në fushat e caktuara.

Kurse zv. presidenti i UBT-së, prof. dr. Mo Vaziri dhe Kaltrina Bunjaku, ligjëruese në UBT, thanë se në kuadër të kësaj qendre do të ofrohen të dhëna për këto module si: Informatat e tregut të punës: Papunësia e regjistruar - sipas kriterit gjinor dhe rajonal, Informatat e tregut të punës - sipas grup-moshave, Papunësia e regjistruar - sipas përkatësisë etnike, Papunësia e regjistruar - sipas strukturës kualifikuese, Papunësia e regjistruar - personat me aftësi të kufizuara etj.

Kurse në Indeksin e çmimeve të konsumit përfshihen si: Peshat

e përdorura në Indeksin e çmimeve të konsumit sipas kategorive, Peshat e përdorura në indeksin e çmimeve të konsumit sipas kategorive dhe nënkategorive, Indeksi i çmimeve të konsumit sipas kategorive, Ndryshimet vjetore të IÇK-së sipas viteve etj.

Po ashtu kjo qendër ka edhe me Indeksi i çmimeve të importit, që merret me Peshat sipas sektorëve të sistemit të harmonizuar, Numrat e indeksi sipas sektorëve të sistemit të harmonizuar etj.



Modultë veçantë e kemi edhe Indeksi i çmimeve të prodhimit që merret me Peshat e indeksi të çmimeve të prodhimit, Indeksi i çmimeve të prodhimit, Krahasimet tremujore të indeksi të çmimeve të prodhimit, Krahasimet vjetore të indeksi të çmimeve të prodhimit, kurse në Llogaritë kombëtare janë Bruto produkti vendor me çmime aktuale, etj.

Këto të dhëna janë të ofruara online në ueb faqen e UBT STATS, www.ubt-uni.net/stats

BASHOTA MORI PJESË NË KONFERENCËN "ANËTARËSIMI I KROACISË NË BE"

Prishtinë, 2 korrik 2013- Drejtori i Qendrës së Karrierës në UBT, Halil Bashota, për disa ditë me radhë ka qëndruar në Zagreb të Kroacisë dhe njëkohësisht ka marrë pjesë në konferencën "Anëtarësimi i Kroacisë në BE", të organizuar nga Forumi Evropian.

Konferenca vazhdoi punimet me pjesëmarrës të të fushave të ndryshme si politikanë, shkrimtar, publicist, si dhe të rinj përfaqësues të IG-ve nga të gjitha vendet e rajonit e më gjerë.

Ndryshe konferenca aktivitetin e saj e ka zhvilluar për disa ditë me radhë si pjesë e organizimeve të anëtarësimi të Kroacisë në BE.



PETRIT AHMETI MORI PJESË NË "JAVËN E ARKITEKTURËS"

Prishtinë 12 korrik 2013- Gjatë aktivitetit "Java e Arkitekturës" të organizuar në Prishtinë, në kuadër të së cilës janë mbajtur një numër i madh ligjëratah, vorkshope, ekspozita etj, nga arkitektë ndërkombëtarë me renome botërore.

Vlen të citohet se në kuadër të këtij organizimi, Petrit Ahmeti, asistent ligjërues në Fakultetin e Arkitekturës në UBT, ka qenë i ftuar dhe i angazhuar për të kontribuar në vorkshopin "Sustainable Architecture" të udhëhequr nga Martha Pozo Gil (MVRDV-Holandë).

Petrit Ahmeti, ka qenë i angazhuar si mbikëqyrësi grupeve të studentëve, të cilët kanë realizuar projekte të arkitekturës së qëndrueshme dhtë cilat më pas janë prezantuar para audiencës me përbërje ndërkombëtare.

ANKETË ME STUDENTËT E FAKULTETIT MEDIA DHE KOMUNIKIM UBT

SI VENDOSËT TË STUDIOINI NË UBT MË SAKTËSISHT MEDIA DHE KOMUNIKIM?

Shumica e të diplomuarve në UBT sot janë të punësuar nëpër kompani më të mëdha në vend dhe jashtë vendit, dhe në institucione shtetërore. UBT ofron kushte dhe mësim cilësor, ofron praktikën mësimore nëpër institucione brenda dhe jashtë vendit, ka një numër të madh të marrëveshjeve ndëruniversitare në botë për shkëmbimin e stafit dhe të studentëve. Këto ishin arsytet dhe qëllimet e të anketuarve tanë si dhe pse kanë vendosë të studiojnë në UBT.

vjen mirë që zgjedha UBT për të studiuar dhe ju bëj thirrje që të gjithëve që përfundojmë shkollim e mesëm t'i drejtohen një universiteti si është UBT për shkak se do të ndahen shumë të kënaqur.



Alba Merovci

Unë zgjedha të studioj në UBT, sepse është një ndër institucionet para universitare private dhe më të mira në vend. Po ashtu UBT ka zgjidhje të madhe të studimeve, përmban një staf dhe ligjërues të nivel të lartë dhe ka një jetë të shkëlqyer shoqërore. Unë shpresoj dhe besoj se do të ndihem e kënaqur me këtë institucion pas përfundimit të studimeve dhe do ta fitojë përvojën e duhur në këtë fushë.



standarde ndërkombëtare. Planet e programet, si dhe stafi akademik i UBT-se e ngrit këtë universitet në radhë të Universiteteve Evropiane. Diploma e UBT-së është diplomë e vetme e këtij lloji në Kosovë dhe në rajon. E modular sipas modelit në Mbretërinë e Bashkuar. Jam e bindur që me ndihmën e UBT-së edhe unë edhe studentet e tjerë do të jemi të suksesshëm në karrierën tonë.



Edona Haxhihajdini

Pas përfundimit të shkollimit të mesëm, pas një mendimi të gjatë, para së gjithash për shkak të programit unik që ofron UBT, vendosa ta ndaj suksesin tim pikërisht me këtë institucion. Kriteri i parë ishte drejtimi dhe stafi akademik me të cilin arriti të më ofronte siguri për studimet e mia, kriteri i dytë është padyshim akreditimi dhe menaxhimi i suksesshëm nga stafi akademik. Por këtë anë formale tani e plotëson edhe ana praktike, me që avancimi në fushën e studimeve gjegjësisht në Media dhe Komunikim është evident. Mundësi për qasje si studente e vitit të parë në aftësim praktik përmes angazhimit në gazetë e veçon UBT-ne sipas botëkuptimit tim nga universitetet e tjera. Kjo do të mundësojë qasje më të strukturuar në tregun e punës por para së gjithash në avancimin e zhvillimit shoqëror nëpërgjithësi. Uroj t'i përfundoj studimet e mia me elanin pozitiv të startit tim të suksesshëm në UBT.



Besart Troshupa

Arsyeja pse kam vendosur të studioj në UBT është se më ka

ofruar kushte më të mira për mësim, një program shumë efikas dhe profesorë shumë profesionalë për drejtimin që studioj. Jam shumë i kënaqur me punën që bëhet brenda UBT-së. Në UBT ia vlen të studiosh.



Ilaz Luzha

Mendoj se është një ndër universitetet më të miranë rajon që ofron kualitet të lartë në studime. Sipas mendimit tim, UBT ofron mundësin e marrjes së njohurive nga një personeli akademik kombëtar. Me mbarimin e studimeve në universitetin UBT mendoj që rrugët për një të ardhme më ndritur janë thjeshtë pa pengesa.



Xhejlane Sopa

Procesi i edukimit universitar është një proces shumë i rëndësishëm për ne. Profesorët e përgjedhur dhe programi që ofron UBT janë adekuat për të përveçuar njohuri të reja, dhe të aftësuar për ta ushtruar një profesion të caktuar.



Erza Brahuhi

Arsyeja pse kam zgjedhur UBT-në ka të bëjë me kushtet që ky universitet ofron. Gjithashtu posedon një staf shumë cilësor dhe mjaft të përkushtuar për studentët. Jam mjaft e kënaqur që kam zgjedhur si vatrë të diturisë këtë universitet.

Egzon Hyseni

Arsyeja pse e kam zgjedhur pikërisht Media dhe Komunikim UBT, sepse është profesion që dallohet nga profesionet e tjera dhe që ndoshta më pëlqen dhe më detyron ta dua më shumë. Që nga fëmijëria kam dashur të jem një ko-



mentues sporti, pasi edhe jam marrë me sport, dhe kjo ka qenë një motiv shtesë.



Labiot Hoxha

Arsyet kryesore që më kanë shtyrë që të studioj në UBT janë programet e studimeve nëpërfundim të plotë me standardet evropiane dhe amerikane.

Mundësi për përvojë të jashtme dhe studime profesionale e praktike, kuadro profesionale në lëmi përkatëse, posaçërisht në fakultetin tim të preferuar Media dhe Komunikim.

Më pëlqen vizioni serioz: "TOP EDUCATION FOR TOP STUDENTS" dhe "SUCCEED WITH QUALITY".



Fortesa Krasniqi

Termin UBT përherë të parë e kam dëgjuar nga motra ime, sepse edhe ajo bën pjesë në njërin nga drejtimet që ky universitet posedon. Po mbaronte shkollën e mesme dhe tashmë secili prej nesh filloj t'i mendoj që ato ëndrra të fëmijërisë t'i bëj realitet. Ishte ajo rruga që do merrnim për të ardhmen tonë dhe është dashur kohë të mendojmë dhe të vendosim se cila nga këto universitete do të bëhet vatrë e diturisë sonë... Fillova të mendoja dhe me rekomandimet që mora nga motra vendosa që njohuritë e mëtuajtshme t'i merrja në këtë universitet. Duke dëgjuar se ka një staf madhështor, profesorë të mrekullueshëm që me plot mund e vullnet ndajnë dituritë e tyre me ne. Vendosa të orientohesha tek Media dhe komunikimi për të vetmen arsye se në këtë drejtim e gjej më tepër veten. Më



Iliriana Krasniqi

Të studiosh dhe të mësosh nuk është humbje kohe e sidomos në njërin nga universitetet më të mira private siç është UBT. Kam nderin dhe ndjem mjaft lumtur që jam pjesë e këtij institucioni. Shtrohet pyetja: Pse kam zgjedhur UBT për studime? Është shumë ethjeshtë, sepse në portale, radio, TV, nëpër gazeta, kudo kemi UBT si një vend ku kërkohet punë, mençuri, dije dhe cilësi nga studentët. E këto do t'i fitojmë me vullnet që kemi dhe me dëshirën për të studiuar që do na shfaqin profesorët nëpër ligjëratat e tyre. E po ashtu mos të harroj që UBT është i vetmi universitet sipas informatave të mia që ka marrëveshje me universitet jashtë Kosovës ku na ofron mundësi studimi dhe jashtë vendi me fitimin e bursës. Në fund u uroj të gjithë studentët që janë pjesë e UBT shumë suksese në studime.



Gentiana Hoxha

Arsyeja pse kam vendosur të studioj në UBT janë kushtet që ky fakultet posedon. Fatmirësisht janë edhe profesorët e mirë dhe që punojnë me përkushtim të madh ndaj studentëve. Unë tani jam në vitin e parë në degën "Media dhe Komunikim", kam 3 vite për ta përfunduar dhe besoj se do të ja arrij qëllimin të bëhem ajo që gjithmonë kam dashur - një gazetare e suksesshme.



Valdrin Maloku

Arsyeja pse kam zgjedhur të studioj në UBT është sepse ka shumë perspektivë për mua dhe ka infrastrukturë të përshtatshme, qëu shkojnë përshtati ambicieve të mia.



Albina Zeneli

Arsyeja pse kam zgjedhur UBT është shumë e thjeshtë dhe e kuptueshme, stafi i shkëlqyer profesional, hapësira që na jepet neve të shprehemi në drejtimin tonë të fakultetit të Media dhe Komunikimit janë përparësitë kryesore që posedon ky institucion, është viti i parë dhe po ndjem mjaft e privilegjuar që kam të bëj me mësimdhënësit të mirë dhe të specializuar për fushën që bëjnë. Zgjidh më të mirin që të bëhesh më i miri është motoja e këtij rrugëtimi tre vjeçar dhe do e vazhdoj, shpresoj me sukses të plotë. Unë besoj te UBT-ja.



Egzona Arifi

Arsyeja pse unë zgjedha UBT-në të studioj është se ky universitet është mjaft cilësor dhe janë kushtet mjaft të mira. Po ashtu kemi mundësi të studiojmë jashtë vendit.

Anisa Rada

Arsyeja pse e kam zgjedhur UBT-në është sepse me të vërtetë ky universitet është me cilësi të lartë dhe në pozitë të mirë me

UBT QENDËR E DEBATEVE DHE KOMUNIKIMIT



Prishtinë, 4 tetor 2013 – Në ambientet e UBT-së, u mbajt sot tryeza me temën: “Roli i mediave dhe shoqërisë civile në zgjedhjet lokale të 3 nëntorit” organizuar nga Fakulteti i Shkencave Politike dhe Fakulteti i Medias dhe Komunikimit. Pjesëmarrës në tryezë ishin përfaqësues të mediave të ndryshme në Kosovë dhe nga shoqëria civile.

Diskutimet u përqendruan në rolin e mediave në mbulimin e procesit për zgjedhjet lokale të 3 nëntorit, rëndësisë së tyre, sfida me të cilat përballen mediat në mbulimin e procesit zgjedhor dhe veçorive që sjell ky proces për politikën në Kosovë.

Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi tha se UBT-ja po shndërrohet si qendër për zhvillimin e debateve të hapura dhe analizave të mirëfillta profesionale. “Kjo temë në shikim të parë duket e nënkuptueshme, por nëse hyhet në aspektin pak më të thellë analitik ka një kompleksitet shumë të madh. Katribute të ndryshme që lidhen rreth zgjedhjeve, rreth mënyrës së qasjes etj. Do të ishte shumë mirë sikur mediat të ofronin tek qytetarët informacione për atë se kush çfarë ofron dhe pastaj u takon qytetarëve që të vendosin”, tha Hajrizi.

Dekani i Fakultetit të Shkencave Politike, prof. dr. Belul Beqaj tha se UBT-ja dhe këto fakultete janë tani më edhe një mundësi e re e komunikimit me median dhe shoqërinë civile. “Ndoshta për dikë duket jo logjike tema, por në fakt kjo është bërë sepse mediat kanë një funksion specifik në zhvillime të tilla”, tha Beqaj. Sipas tij, është shumë e vështirë në raportet aktuale të politikës ekzistuese të kesh gazetari profesionale dhe të mos jesh komercial dhe është gati e paimagjinueshme të jesh komercial dhe të bësh gazetari profesionale.

Lorik Arifaj, ushtrues detyre i kryeredaktorit të Televizionit të Kosovës tha se këto zgjedhje janë të rëndësishme historike dhe transmetuesi publik i ka bërë të gjitha përgatitjet për mbulimin e fushatës. Sipas tij, RTK-ja ka kapacitete të mjaftueshme për mbulimin e fushatës në gjithë territorin e Kosovës.

Gazetari Bashmir Xhemaj nga Shkolla Politike, veçoi tri çështje që lidhen me rolin e mediave në këtë proces zgjedhor. Fillimisht nuk angazhohen ekspertë e fushave, së dyti aktiviteti po për-



qendrohet vetëm në Prishtinë, dhe së treti do të duhej, sipas mendimit tim të mendohet edhe për mediat që do të kishin pozicionimin e qartë karshi subjekteve politike. mediat gjithashtu sipas tij duhet të bëjnë edhe filtrimin e qeshjeve që kane te beje me fakte reale dhe premtime te pabazuara.

Kushtrim Sadiku nga Klan Kosova tha se këto zgjedhje janë shumë të rëndësishme për shkak të mbajtjes së tyre në gjithë territorin e Kosovës. Mirëpo, ai tha se për mediat në Prishtinë problem të veçantë paraqet qasja në veri të Kosovës. Duke vlerësuar rolin

e madh të medias në procesin zgjedhor, dhe veçoi shembullin e keqpërdorimeve në zgjedhjet e kaluara dhe ngritjen e këtij problem nga mediat, gjë që ka ndikuar në reagimin e instancave përkatëse dhe përmirësimin e gjendjes në këtë proces zgjedhor.

Në debat, morën pjesë edhe shume diskutues tjerë, të cilët dhanë vlerësime të ndryshme e për zgjedhjen e 3 nëntorit, por shprehojmë se kjo edhe shumë tema tjera do të trajtohen në mënyrë profesionale në të ardhmen meqë UBT-ja po shndërrohet në një qendër të debateve dhe komunikimit profesional.

UNIVERSITETI TEKNIK I VJENËS EDHE NË KOSOVË, SHQIPËRI E MË GJERË

Prishtinë, 8 tetor 2013 - Për herë të parë në Kosovë, Shqipëri e më gjerë, Universitetin Teknik i Vjenës ofron programe për studime Master në fushën e Menaxhimit Inxhinierik, falë nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me UBT.

Përfaqësuesit e Universitetit Teknik të Vjenës, së bashku me përfaqësuesit nga UBT, në holin e UBT-së, në Prishtinë, po ashtu më pas në ambientet e hotelit “Rogner” në Tiranë, para të gjithë profesorët vendorë dhe ndërkombëtarë si dhe studentët të interesuar tjerë, në detaj prezantuan programin e përbashkët dhe dhanë informata direkt përmundësitë e studimit në këtë fushë.

Kjo marrëveshje do t’ua mundësojë studentëve kosovarë dhe të gjithë atyre nga regjioni, që studimet universitare në nivelin master në fushën e Menaxhimit Inxhinierik, nëpërmjet Universitetit Teknik të Vjenës ligjëratat i ndjekin në UBT në Kosovë, dhe në fund të marrin diplomën e Universitetit Teknik të Vjenës.

Drejtori i programit në Universitetin e Teknik të Vjenës, prof. dr. Peter Kopacek, po ashtu edhe profesor që disa vite me radhë në UBT dhe Drejtoresha e përgjithshme e qendrës për edukim të vazhdueshëm në UT, në znj. Petra Aigner, para të pranishmëve është shprehur e kënaqur me të arriturat e UBT-së, sidomos me programet e studimit me tekno-

logjinë më moderne, me infrastrukturën, me stafin akademik dhe me arritjet e studentëve.

Universitetit i Teknik i Vjenës, është ndër universitetet më të vjetra në Evropë dhe më gjerë, dhe sot renditet në mesin e universiteteve të kategorisë botërore dhe është numër një në vend, gjithëpërfshirës dhe publik. Ka një numër të madhe të marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërkombëtar me përmasa botërore, përfituesi rregullt i projekteve të Unionit Evropian.

Pas aktit solemn të nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, mysafirët nga Vjena së bashku me menaxhmentin e lartë të UBT-së e kanë vizituar kampusin e ri të UBT-së.



UBT ZGJERON BASHKËPUNIMIN ME KOLEGJIN UNIVERSITAR “PAWEŁ WŁODKOWIC” NË POLONI

Prishtinë, 10 tetor 2013 - Në kuadër të Marrëveshjeve të Bashkëpunimit, që UBTi ka me universitete nëpërbotë dhe Evropë, gjatë këtyre ditëve një delegacion nga Kolegji Universitar “Paweł Włodkowic” nga Polonia i prirë nga Prof. dr. Andrzej Straszak, Drejtorii zyrës për marrëdhënie me jashtë-Piotr Nasiadko dhe drejtori financiar i Kolegjit, qëndrojnë vizitë dy ditore në Kosovë, gjegjësisht në UBT, për të vazhduar dhe zgjeruar bashkëpunimin ndërkombëtar, bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit që është nënshkruar kohë më parë, në mes të UBT-së dhe Kolegji universitar “Paweł Włodkowic” në Poloni.

Me këtë rast, delegacioni nga Kolegji Universitar polak u prit nga Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, Drejtori për çështje akademike në UBT, prof. dr. Ibrahim Krasniqi dhe Drejtori i zyrës për marrëdhënie ndërkombëtare Lulzim Beqiri. Gjate takimeve me delegacionin nga Kolegji universitar “Paweł Włodkowic” nga Polonia, në ambiente UBT-së, u prezantuan të arriturat dhe zhvillimi i Kolegjeve përkatëse dhe në parim u pajtuan që të ftohen të gjithë profesorët dhe studentët e dy institucioneve në fjalë për të genë pjesë e programeve të përbashkëta të cilat ata i prezantuan.

Më konkretisht marrëveshja në fjalë do të mundësojë këmbimin e stafit akademik dhe studentëve, të organizojmë seminare të përbashkëta dhe takime tjera akademike për çështje shkencore dhe hulumtuese, zbatimin e përbashkët të programeve studimore, konferenca, aktivitete lidhur me kurset dhe akademike verore përkatëse dhe takime tjera akademike për çështje të rëndësishme për të dy institucionet dhe të dy vendet.

Përveç tjerash mysafirët nga Polonia së bashku me menaxhmentin e lartë të UBT-së e kanë vizituar kampusin e ri të UBT-së, mjediset mësimore, laboratorët dhe infrastrukturën përcjellëse duke shprehur admirim për të arriturat e UBT-së në rrugën e zhvillimit dhe rritës akademike. Shumë shpejt pritet që studentët e të dyja institucioneve të përfitojnë nga marrëveshja dhe bashkëpunimi i arritur.





Departamenti për Trajnime dhe Certifikime në UBT është shumë i angazhuar për të kontribuar në avancimin e shoqërisë kosovare në një shoqëri konkurrense, nëpërmjet trajnimeve tona profesionale, të cekura më poshtë:

Menaxhim

- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
- Administrim Biznesi
- Menaxhimi i Kualitetit (ISO 9001:2000)
- Menaxhimi Strategjik
- Ngritja (Themelimi) e ndërmarrjes së re
- Menaxhimi i Produktit
- Ndërtimi i Brendit
- Inxhinieringu Industrial
- Menaxhimi i Projekteve
- Menaxhimi i Proceseve
- Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit
- E-Biznes
- Transport dhe Logjistikë
- Sisteme Fleksibile të Prodhimit
- Prodhimi mbështetës
- Prodhim, Planifikim dhe Skedulim
- Menaxhimi i Ndryshimeve
- Menaxhimi i Rrezikut
- Menaxhimi i Ankesave
- Menaxhimi i Kohës
- Ndërmarrësi dhe Biznisplan
- Menaxhimi i Sistemeve Informativ
- Prokurimi
- Menaxhimi i Konfliktit
- Përgjegjësia Sociale e Korporatës
- Menaxhimi i Ngjarjeve
- Sistemet HACCP
- Fuzionimi dhe Bashkimi
- Planifikimi i resurseve të manufakturës
- Planifikimi i Materialeve të Kërkueshme (MRP)
- Shkathësi negocimi
- Menaxhmenti i Logjistikës

Financa

- Raportim Financiar i Korporatës
- Tregtia e Jashtme/Doganat
- Analiza e Kostove
- Kontabilitet dhe Menaxhim i Financave
- Vendimmarrja Financiare
- Institucionet Financiare dhe Tregjet

Marketing dhe Shitje:

- Marketing dhe Shitje
- Planifikimi i Burimeve të Shpërndarjes
- Mjetet e IT për Marketing

- Menaxhimi i Lojalitetit
- Merchandising
- Modeli i Optimizimit të çmimeve
- Zhvillimi i Produkteve dhe Brendimi
- Menaxhimi i Shitjes
- Shitja Efikase dhe Teknikat e Shitjes
- Menaxhimi i Ankesave të Konsumatorëve

Shkathësi kryesore të këshillimit:

- Menaxhimi Personal
- Komunikimi
- Punët e suksesshme grupore
- Grupimi dhe Krijimi i Grupeve
- Periodizimi
- Kodi i Etikës së Këshilltarit
- Zgjidhja e Konfliktit
- Negocimi i Kontratës
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Klientë
- Shërbime Këshillimi për Marketing
- Menaxhimi i Proceseve Këshilluese

Gjuhët e huaja:

- Gjuhë angleze
- Gjuhë gjermane
- Gjuhë frënge

Vërejtje e rëndësishme: Gjuhët e huaja, varësisht prej kërkesave të grupit në fokus, mund të mbahen edhe në bazë të kërkesave specifike të grupit për mësimin e terminologjive të ndryshme profesionale për gjuhët përkatëse

Drejtësi, Shkenca Politike dhe Diplomaci:

- Teknika Negocimi
- Zgjidhja e Konfliktit
- Aqvi Comunnitëre e Bashkimit Evropian
- Institucionet e Bashkimit Evropian
- Komunikimi Masiv
- Shkathësi Diplomatie
- State Protocol

Mekatronikë dhe Teknologji të tjera

- Mekatronikë (Pneumatikë, Elektro-Pneumatikë, E-Teknika / Programmable Logic Controllers (PLC), Hidraulikë, Elektro-Hidraulikë, Sistemet e Kontrollit Hidraulik, Sensorët
- Design Assembly & Mirëmbajtja e Sistemeve Mekatronike
- CAx - Teknologjitë (CAD/CAM, CAQ, CAP dhe CA të tjera)
- CNC-Teknikat
- Robotikë
- Teknika të Punës/ Organizim i Punës
- Mbrojtja e Mjedisit

- Teknika të Sigurisë për mbrojtjen së punëtorëve
- Dokumentimi Teknik
- Saldimi
- Inovimi

Teknologji Informativ

- CISCO
- IT Essencial
- CCNA Discovery 1.2.3.4
- CCNA Exploration 1.2.3.4
- ECDL
- Hardware
- Inxhiniering i Software (Gjuhët programuese dhe Bazat e të Dhënave)
- Rrjetizim
- Simulim i Kompjuterit
- Disenj Kompjuterik dhe Animacion
- Sisteme Aplikative të Ndërmarrjes
- Aplikime të Internetit
- Paketat CAD/CAM
- Menaxhimi i Marrëdhënieve me Konsumatorë (CRM)
- Modelimi, Optimizimi dhe simulimi

Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor

- Menaxhimi i Projekteve Konstruktuese
- Projektim me AUTO CAD, ARCHI CAD
- Materiale Konstruktuese dhe Kontroll Kualiteti
- Menaxhim Urban
- Certifikim për Kualitet
- Marketing në Arkitekturë

Trajnimet profesionale në disiplinat e lartcekura ofrohen në periudha të ndryshme, në bazë të kërkesës së individëve, institucioneve, kompanive dhe korporatave të ndryshme. Një grup profesionistësh vendorë dhe ndërkombëtarë, me përgatitje akademike superiore dhe përvojë të suksesshme, janë në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar një vistër të gjerë trajnimesh për një karrierë personale të avancuar dhe për sukses të padiskutueshëm të ndërmarrjes apo institucionit tuaj.

Vërejtje e rëndësishme: Ju lutemi, mos hezitoni të kontaktoni zyrtarin përgjegjës për Trajnime profesionale në Universitetin për Biznes dhe Teknologji, përmes numrit të telefonit 038 541 400.

Kredi për studentë



**Raiffeisen
BANK**

...JETO MË MIRË

Financoni studimet tuaja

- Norma të volitshme interesi
 - 10,000 Euro deri në 5 vjet
 - 0% - shpenzime administrative

www.raiffeisen-kosovo.com
Raiffeisen Direct: 038 222 222

STUDENTËT E UBT-së MIRËPRITËN LIGJËRATËN PËR DIPLOMACINË PUBLIKE

Prishtinë, 9 tetor 2013 - Zëvendësministri i Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës, Petrit Selimi, morripjesë në debatin e organizuar sot në UBT, në temën "Diplomacia publike dhe diplomacia digjitale".

Të pranishëm në debat ishin profesorë të UBT-së, mysafir nga Polonia, studentë dhe të interesuar të tjerë, të cilët e përcollën me interesim debatin.

Fillimisht, Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi përshëndeti mysafirët dhe i njoftoi me punën dhe organizimin e UBT-së, si dhe i falënderoi ata për pjesëmarrje në debat në UBT, një institucion që ka traditë të gjatë në organizimin e debateve nga fusha të ndryshme, me interes për studentët dhe për opinionin e gjerë. Z. Hajrizi, gjithashtu në fjalën e tij hyrëse shprehu fjalë miradije për punën e çmuar të Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ) dhe të zëvendësministrit Selimi në promovimin e Kosovës përmes aktiviteteve të shumta në kuadër të diplomacisë publike dhe diplomacisë digjitale të Kosovës.

Në fjalën e tij hyrëse, zëvendësministri Selimi përgëzoi UBT-në

për kontributin e rëndësishëm në avancimin e arsimit të lartë në Kosovës përmes pasionit për dijen. Ai tha se angazhimi i profesorëve dhe studentëve të UBT-së ka një peshë të veçantë në sjelljen e standardeve ndërkombëtare të programeve të studimit, por edhe në ndërtimin e kapaciteteve vendore profesionale dhe akademike.

Para të pranishmëve Selimi tha se, përqendrimi kryesor dhe theksi i veçantë i MPJ-së në periudhën pas shpalljes së pavarësisë është vënë në njohjet e Kosovës përmes bashkëpunimit bilateral me shtete nga Evropa, Azia e deri te Afrika dhe Amerika Latine.

Selimi tha se në kohën kur me miliarda njerëz janë përdorues të rrjeteve sociale dhe rrjeteve të informacionit në përgjithësi, prania e Kosovës dhe projekcioni i rrëfimit të saj përmes këtyre rrjeteve dhe mjeteve të tjera të rëndësishme të teknologjisë bashkohore nuk është një nevojë, por është një domosdoshmëri, duke shtuar se është koha që të shkohet përtej diplomacisë klasike konfidenciale. Ai theksoi mungesën jo të rrallë të informacionit të saktë për Kosovën në internet, kryesisht për shkak të propagandës së qëllimshme të



Serbisë ku Kosova portretizohet me një imazh shumë të errët. Në këtë drejtim, shtoi Selimi, MPJ, në bashkëpunim me ekspertë të jashtëm, ka përpiluar Strategjinë Kombëtare për Diplomacinë Digjitale, të cilën revista prestigjioze për diplomaci publike në Turqi, "Yeni Diplomasi" ("Diplomacia e Re"), është vlerësuar si Strategjia më e mirë Kombëtare për Diplomaci Digjitale nga të gjitha vendet e Ballkanit dhe e katërta në botë, pas Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Britanisë së Madhe, dhe Izraelit. Si rezultat i përkushtimit të MPJ-së në promovimin e Kosovës përmes diplomacisë publike dhe diplomacisë

digjitale, në mesin e aktiviteteve të shumta, u realizuan edhe 3 projekte të suksesshme: 1) Projekti WikiAcademyKosovo 2013, ku nga 85 artikuj të dërguar në lëmitë prej më të ndryshme që lidhen me Kosovën, u përzgjedhën 10 artikujt më të mirë, të cilët u bënë pjesë e Wikipedias; 2) Gara kombëtare App Camp Kosovo 2012, ku u përzgjedhën aplikacionet më të mirë për telefoni mobile në të cilët prezantohet turizmi dhe ekonomia e Kosovës; 3) Gara kombëtare për fotografim më të mirë për Kosovën, në tri kategori: njerëzit, ngjarjet dhe natyra, në të cilën mbi 11,000 foto janë dërguar, prej të cilëve 20 ga-

ruer janë shpërblyer me çmime, kurse është botuar edhe një libër me 100 fotot e përzgjedhura nga juria përkatëse.

Selimi foli edhe për faqen e internetit www.digitalkosovo.org, e cila është rezultat i nismës së MPJ-së dhe partnerëve të saj, në të cilën të gjithë qytetarët e Kosovës mund të kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në promovimin dhe realizimin e objektivave të diplomacisë digjitale të Kosovës.

Selimi tha se Kosova duhet të përfitojë nga demografia e saj, nga të rinjtë e saj, të cilët përbëjnë shumicën dërrmuese të popullatës dhe të cilët shquhen me ndërmarrësinë e tyre, dhe që tërë potencialin sipërmarrës ta shndërrojnë në përparësi krahasuese ndaj vendeve të rajonit. Kosova, tha Ai, mund të bëhet shembull në sektorin e teknologjisë informative, sidomos kur kihet parasysh se shtrirjen e gjerë të pranisë dhe përdorimit të internetit në tërë vendin. Zëvendësministri i Jashtëm, Selimi tha se të gjitha sondazhet e kryera nga kompanitë ndryshme kanë treguar se integrimet euro-atlantike të Kosovës nuk janë vetëm synim politik dhe shtetëror, por edhe përbëjnë një konsensus shoqëror.

UNIVERSITETI I VARSHAVËS EDHE NË KOSOVË E MË GJERË

Prishtinë, 18 tetor 2013 - Për herë të parë në Kosovë e më gjerë, Universiteti i Varshavës ofron programe për studime bachelor dhe master në fushën e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, falë nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me UBT.

Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, para të gjithë profesorët vendorë dhe ndërkombëtarë si dhe studentët të interesuar tjerë, në detajta prezantoi programin e përbashkët dhe dhainformata direkt përmundësitë e studimit në këtë fushë.

"Kjo marrëveshje do t'ua mundësojë studentëve të UBT-së dhe atyre kosovarë dhe të regjionit që studimet universitare në nivelin bachelor, master dhe atë të doktoratës' indjekin në UBT dhe në Universitetin e Vrhavës dhe në fund të marrin diplomën e Universitetit të Vrhavës", ka theksuar presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi.

Bashkëpunimi ndëruniversitar në mes UBT dhe Universitetit të Varshavës, ka filluar edhe më herët nëpërmjet projektit "ErasmusMundus", për shkëmbim të studentëve dhe stafit. Gjithashtu presidenti Hajrizi, ka



zhvilluar takimet dhe vizita të njëpasnjëshme në Universitetin e Varshavës, dhe biseda të shumta me menaxhmenti e lartë të këtij universiteti deri tek marrëveshja konkrete. Gjithashtu, vitin që shkoi, një delegacionin nga Universiteti i Varshavës, i përbërë nga zëvendësrektorja prof. Marta Kicinska-Habiovr, prof. Edward Halizak dhe dr. Jakub Zajaczkowski, patë qëndruar për disa ditë më radhë në Republikën e Kosovës, pikërisht në UBT, dhe paratë gjithë profesorët vendorë dhe ndërkombëtarë, nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit ndëruniversitar dhe ftuan studentët që të bëhen pjesë e programit të përbashkët, të cituar si më lartë.

Pas aktit solemn të nënshkrimit të kësaj marrëveshje, mysafirët nga Varshavës së bashku me menaxhmentin e lartë të UBT-së e kanë vizituar kampusin e ri universitar, dhe mbajtur një ligjëratë publike nga lëmi i shkencave politike, si dhe kanë folur për të arriturat e Universitetit të Varshavës.

Gjithashtu, zëvendësrektorja prof. Marta Kicinska-Habiovr, para të pranishmëve është shprehur e kënaqur me të arriturat e UBT-së, sidomos me programet e studimit me teknologjinë më moderne, me infrastrukturën, me stafin akademik dhe me arrijtet e studenteve. "Shpreh kënaqësinë time që vizitoj Kosovën me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes për

bashkëpunim në mes UBT-së dhe Universitetit të Varshavës".

Universitetit i Varshavës është themeluar në vitin 1816, dhe sot renditet në 4% të universiteteve të kategorisë botërore dhe si universitetin numër një në vend. Është universitet gjithëpërfshirës publik, dhe më i madhi në vend, me 54 mijë studentë, 3500 staf akademik dhe ligjërues. Ka bashkëpunim ndërkombëtar me përmasa botërore, me 240 marrëveshje bashkëpunimi universitar në 54 vende botërore, me 1600 marrëveshje bashkëpunimi, 1000 nga to në kuadër të programit "ErasmusMundus", të Unionit Evropian, dhe është anëtar aktiv në kuadër të këtij projekti, është shprehur ajo.

UBT MORI PJESË NË KONFERENCËN E ORGANIZUAR NGA UNIVERSITETI CITY NË NOVI SAD

Prishtinë, 17 tetor 2013 - Universiteti City në Londër, njëheri edhe si koordinatore e projektit "Erasmus MUNDUS - EM2STEM" gjatë kësaj jave në Novi Sad, organizoi konferencë dy ditore me temën "Perspektiva e Institucional EM2STEM".

Përveç përfaqësuesve të UBT-së, në konferencë morën pjesë edhe mbi 50 pjesëmarrës nga të gjitha universitetet e Evropës dhe Ballkanit Perëndimor, që janë pjesë e projektit "ErasmusMundus EM2STEM".

Vlen të veçohet se UBT është përfaqësuar në dy sesione si në sesionin e parë "Perspektiva e institucional EM2STEM" nga drejtori i Zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Zhvillimin e Projekteve, Lulzim Beqiri, dhe në sesionin në vijim "Mobiliteti për shërbime të karrierës" nga Halil Bashota, udhëheqës i Zyrës së Karrierës dhe Intership.

UBT MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME INSTITUTIN E MEDIAS SË KOSOVËS

Prishtinë, 22 tetor 2013 - Me qëllim të zhvillimit të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në pajtim me qëllimet dhe interesat e përbashkëta, sekretari i UBT-së, Artan Tahiri, priti sot në një takim në kryetarin e Bordit të Institutit të Medias në Kosovë, z. Fazli Veliu, dhe nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucional.

Me konkretisht, kjo marrëveshje hedheshmon se UBT dhe Instituti i Medias i Kosovës pajtohen që të zhvillojnë bashkëpunimin në shkëmbimin e përvojave dhe

krijimin e hapësirave për realizimin dhe vendosjen epajisjeve nga Instituti i Medias i Kosovës në objektin e UBT-së, të cilat mjetojnë të shfrytëzohet për qëllime të Institutit, dhe studentët e Fakultetit të Medias dhe Komunikimit në UBT, do t'i shfrytëzojë këto pajisje pa kufizim për punë profesionale dhe praktike.

Po ashtu marrëveshja parasheh se dy institucionet do të marrin pjesë në programet arsimore dhe shkencore, do të angazhohen të realizojnë projekte kërkimore-shkencore me interes të përbashkët, konferenca shkencore,

simpoziume, seminare, punëtori profesionale.

Sekretari UBT-së, z. Tahiri, pas nënshkrimit të marrëveshjes theksoi se UBT ka qenë gjithëherë aktive në ofrimin e mundësive për të ndihmuar dhe zhvilluar të gjitha institucionet vendore, duke dhënë kontributin nga ana shkencore dhe profesionale, si me anë të stafit akademik dhe infrastrukturorë.

Sipas palëve nënshkruesetë të dyja institucioneve, ky ishte vetëm hapi i parë në rrugën e një bashkëpunimi të mirëfilltë dhe afatgjatë për të ardhmen.



DR. HAJRIZI, MORI PJESË NË SIMPOZIUMIN NDËRKOMBËTAR NË HUNGARI

Prishtinë, 28 tetor 2013 - Në vazhdim të aktiviteteve me karakter shkencor të zhvilluara jashtë vendit, presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, për tre ditë me radhë ka qëndruar në Pecs të Hungarisë, me ç'rast ka marr pjesë në Simpoziumin e nëntë me radhë Ndërkombëtarë Shkencor "Architecture, Engineering and Information Technology", të organizuar nga Universiteti i Pecs të Hungarisë.

Në kuadër të këtij Simpoziumi, presidenti i UBT-së, dr. Hajrizi, prezantoi punimin e tij shkencor me titull "Reflektimi në vlerësimin dhe akreditimin institucional të programeve studimore në vendet në tranzicion: UBT dhe Republika e Kosovës si rast studimi".

Presidenti i UBT-së, dr. Hajrizi, me ftesën e organizatorit është edhe anëtar i komitetit shkencor të këtij simpoziumi.


UBT-ja PËRFITON EDHE TRI VITE PROJEKTIN ME SEECEL

Prishtinë, 29 tetor 2013 - SEECEL - Qendra për mësimin e ndërmarrësisë për vendet e Evropës Juglindore ka përfunduar edhe një projekt nga Komisioni Evropian për ta zhvilluar edhe më tutje mësimin e ndërmarrësisë në Institucionet e Arsimit në regjionin e Ballkanit Perëndimor.

UBT-ja edhe në këtë projekt do të vazhdojë të jetë partner me SEECEL, duke përfaqësuar institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, si pilotprojekt dhe duke ndihmuar edhe të tjerët në këtë drejtim.

Gjatë këtyre ditëve, takimi i parë është mbajtur për tre ditë me radhë në Zagreb të Kroacisë, ku i pranishëm ishte edhe presidenti UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi.

Hajrizi me këtë rast u takua me shumë përfaqësues të institucioneve regionale dhe të Bashkimit Evropian me qëllim të bashkëpunimit më të ngushtë në këtë projekt, por edhe në projekte të tjera me rëndësi për studentët dhe stafin e UBT-së.



DELEGACIONI I AMBASADËS GJERMANE NË PRISHTINË VIZITOI UBT-në

Prishtinë, 25 nëntor 2013 - Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi dhe drejtori për Çështje Akademike, prof. dr. Ibrahim Krasniqi, pritën në një takim delegacionin nga Ambasada Republikës Federale të Gjermanisë në Prishtinë, të udhëhequr nga Milena Tutsch dhe Malthias Kiesler, me të cilët kanë biseduar për ndërlidhjen e sektorit të arsimit universitar në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Gjermanisë, si dhe mundësitë e rritjes së bashkëpunimit të ndërsjellët.

Presidenti i UBT-së, Hajrizi, para mysafireve me theks të veçantë ka folur për zhvillimet dhe të arriturat e UBT-së dhe ka shprehur interesimin për ndihmë dhe mbështetje të vazhdueshme nga ambasada në drejtim të zgjerimit të bashkëpunimit me partnerë nga Gjermania.

Përfaqësuesit e Ambasadës janë impresionuar nga faktet e treguara dhe gjetën mirëkuptimin e bashkëbiseduesve për ta shtrirë bashkëpunimin në një varg fushash. Ata kanë shprehur gatishmërinë për ta mbështetur dhe iniciuar hapa konkret drejt thellimit të bashkëpunimit në një të ardhme të afërt.

STUDENTËT E UBT-së BISEDOJNË NE INDUSTRIJË

Prishtinë, 21 nëntor 2013 - Në UBT vazhdimisht ligjërata zhvillohen edhe nga personalitete të fushave të ndryshme etj. "Information and Communication Technology - ICT in Kosovo", ishte tema e radhës, për të cilën para studentëve të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri dhe Fakultetit për Menaxhimin e Mekatronikës në UBT, ligjëroi anëtar i Bordit të kompanisë "Asseco", z. Armend Skeja.

Studentët e dyja fakulteteve, shprehën interesim të dinë më shumë për kompaninë në fjalë, ku z. Skeja, tha se aty janë punësuar një numër i shumëfishuar i punëtorëve krahasuar me vitet e para të punës të 1997, të profileve të ndryshme, dhe përkatësisht secili punëtor është profesionist për punën që e bënë.

Ai më konkretisht shpjegoi se si e ka filluar punën me Pronet-in, e më pas bashkëngjitja me Asseco, pastaj si ka arriti të depërtoj në tregun e brendshëm dhe të jashtëm.

"Çështja e shtrirjes qëndron mirë, që nënkupton se kompania jonë është prezentë në gjithë tregun botëror".

Po ashtu, z. Skeja me konkretisht foli për trendet e shërbimeve të teknologjisë informative në regjion dhe në Kosovë, për trendet e zhvillimit të aplikacioneve në botë, çka kërkon industria e TI nga shkollimi dhe nga kandidati etj.

Studentët përveç që u ndan të kënaqur me ligjërimin e z. Skeja, ata përfituan njohuri të reja nga fushë e inxhinierisë.

Ligjëratën përveç studentëve dhe profesorëve të dyja fakulteteve të cekura si më lartë, e përcjellën edhe studentët e mysafirë tjerë të interesuarit.



PROFESORËT NDËRKOMBËTARË LIGJËROJNË PËR BETONIN

Prishtinë, 22 nëntor 2013 - "Betonit dhe vetitë e tij", ishte tema e radhës, për të cilën para studentëve të Fakultetit të Arkitekturës dhe Fakultetit për Ndërtimtari në UBT, ligjëruan profesorët ndërkombëtar si z. Saulo Ferrara dhe Visar Krelani.

Studentët përveç që u ndan të kënaqur me ligjërimin e profesorëve në fjalë, ata përfituan njohuri të reja fushëbetonit si dhe vetitë e tij, përkrahjet e reja si në vetëshërimin plasaritjeve të betonit tradicional dhe atë me rezistencë të larta.

Ligjëratat përveç studentëve dhe profesorëve të dyja fakulteteve të cekura si më lartë, u përcjell edhe nga shumë të interesuarit tjerë.



PROFESORI THOMAS DILLINGER LIGJËROI PËR DIZAJNIN URBAN

Prishtinë, 26 nëntor 2013 - Me ligjëratën e radhës para studentëve të Fakultetit të Arkitekturës në UBT, u paraqit profesori ndërkombëtar, Thomas Dillinger, i cili ligjëroi nga fusha e dizajnit urban.

Studentët përveç që u ndan të kënaqur me ligjërimin e profesorit në fjalë, ata përfituan njohuri të reja nga fusha për temën të cilën ligjëroi.

Ligjëratat përveç studentëve dhe profesorëve u përcjell edhe nga shumë të interesuarit tjerë.



UBT NË PANAIRIN E PARË TË KARRIERËS

Prishtinë, 17 dhjetor 2013 - Shumë studentët të UBT-së në bashkëpunim me Qendrën për Karrierë dhe Internship brenda këtij institucioni, po ashtu në bashkëpunim me të gjitha njësit akademikë, përveç aktiviteteve tjera, sot kanë marr pjesë edhe në Panairin e Parë të Karrierës, të mbajtur në hollin e Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, në mesin e shumë kompanive, firmave, institucioneve shkencore dhe hulumtuese etj etj.

Në këtë panair studentëve kosovarë, iu dha mundësia që të njoheshin më me shumë biznese të vendit, po ashtu edhe bizneset patën mundësin të nihen me institucionet arsimore-shkencore etj, si me UBT-në e tjera të cila ishin prezentë.

FILLIMI I INTERNSHIPIT TË STUDENTËVE TË UBT-së NË IGJK

Prishtinë, 5 dhjetor 2013 - Procesit studimeve në UBT, përveç ligjëratave, ushtrimeve dhe konsultimeve, përfshin gjithashtu praktikën/internshipin e studentëve në kompani dhe institucione publike si në Republikën e Kosovës dhe jashtë saj.

Qendra për Karrierë dhe Internship në UBT, përfazën eparëe ka nisur me Fakultetin e Juridikut, dhe në bashkëpunim të ndërsjellë kanë përzgjedhur një grup prej katër studentësh për praktikë profesionale dymujore për në Institutin Gjyqësor të Kosovës, e të cilët janë si: Majlinda Hajrizi, Nora Shabani, Ali Sejdiu dhe Edona Hasani.

"Qendra e Karrierës dhe Internshipit në UBT, do të angazhohet në bashkëpunim me të

gjitha njësit akademikë që ka, që të gjithë studentët të kenë mundësinë e kryerjes së praktikës profesionale, ku studentët do të fitojnë aftësitë dhe shkathtësitë shtesë që do të përballohen nëpunë dhe profesionet e tyre në të ardhmen", tha përgjegjësi për këtë zyrë, Halil Bashota. Ai më tej shtoi se kjo praktikë profesionale në Fakultetin Juridik është koordinuar në bashkëpunim me prodekanin Ardian Emmini, si dhe profesorin Lavdim Krasniqi. Gjithashtu studentët në fund të periudhës së internshipit do të pajisen me certifikata, përmes të cilave do t'u njihet praktika profesionale.

Më saktësisht kjo Qendër ka për qëllim që t'i ndihmojë studentët e vitit të II dhe III- të

të Shkencave Kompjuterike, që të ndërlihdin procesin akademik me praktikën profesionale e cila mundëson ata të marrin njohuri në fusha të caktuara të cilat janë me interes për zhvillimin e tyre personal.

Gjithashtu UBT ka një varg marrëveshjetë bashkëpunimit me institucionet publike vendor, ndër to dhe gjatë këtij viti presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me drejtorin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, mr.sc. Lavdim Krasniqi, ku përveç tjerave kjo marrëveshje ndër institucionale parasheh edhe krijimin e hapësirave që studentët e UBT-së të realizojnë aktivitete praktike në IGJK.

DORUNTINA KUPINA ZGJEDHET KRYETARE E ORGANIZATËS STUDENTORE TË UBT-së



Prishtinë, 12 dhjetor 2013 - Në garë për postin e Kryetarit të Organizatës Studentore të UBT-së ishin si Edona Thaqi, Flakron Jahaj, Afrim Bajraktari, Albina Zeneli, Agon Hysaj, Blend Humolli dhe Doruntina Kupina.

Pas votimit nga anëtarët e përcaktuara nga Fakulteti përkatës, Komisionit Zgjedhor i përbërë nga sekretari i UBT-së, z. Artan Tahiri, si dhe koordinatoret dhe përfaqësuesit enjësitë akademikë, para të pranishmëve në sallë e mbledhjeve po në objektin e UBT-së, numëruan votat ku Kryetare e Organizatës Studentore të UBT-së

u zgjodh Doruntina Kupina, kurse nënkryetaru zgjodh Edona Thaqi, sekretar Flakron Jahaj, anëtar i Këshillit Akademik Afrim Bajraktari, anëtar i Këshillit për Cilësi Blend Humolli.

Sipas planit të znj. Kupinës, para të pranishmëve citoi disa aktivitete të cilat mendon të realizohen gjatë udhëheqjes së saj: vizitat nëpër vende të ndryshme të Evropës, të karakterit shkencorë pjesëmarrja nëpër konferenca studimore, pjesëmarrja në aktivitete të shumta sportive, kulturore, etj etj.

Biografia e Kupinës

Doruntina Kupina, është e lindur në Prishtinë, më 7 gusht 1993. Shkollën e mesme a ka përfunduar në gjimnazin "Samir Frashëri" në vendlindje në drejtimin - Matematikor, dhe aktualisht është studente e vitit të dytë në Fakultetin e Arkitekturës në UBT, dhe është njohëse e mirë e gjuhës angleze.

Është pasionante e shumë aktiviteteve si: sportit, biznesit, debateve politike, udhëtimeve, muzikës, ekspozitave të profilit që i studion.

NJË DELEGACIONI I UNIVERSITETIT OFFENBURG DHE PËRFAQËSUES TË INDUSTRIJË E BIZNESIT VIZITUAN UBT-NË

UBT BASHKËPUNON ME UNIVERSITETET GJERMANE

Prishtinë, 19 dhjetor 2013 -

Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi dhe Drejtori për Çështje Akademike në UBT, prof. dr. Ibrahim Krasniqi, pritën në një takim delegacionin e përbërë nga përfaqësues të botës universitare, industriale dhe bizneseve nga Republika Federale e Gjermanisë, të udhëhequr nga Dekani i Fakultetit të Makinerisë dhe Materialeve të Universitetit Offenburg, prof. dr. Alfred Isele, i shoqëruar nga përfaqësues reprezentativ të sektorit të industrisë nga ky regjion në Gjermani, z.


Clemens Sexauer, Roman Bertram dhe Karl Heinze. Matt.

Me theks të veçantë, gjatë këtij takimi palëtbiseduan për ndërlidhjen e sektorit të arsimit universitar në mes të UBT-së dhe Universitetit Offenburg, dhe mundësitë e bashkëpunimit në projekte të ndryshme nga sektori i industrisë dhe biznesit, si dhe mundësitë e rritjes së bashkëpunimit të ndërsjellët.

Gjithashtu është biseduar edhe hapja e një zyre reprezentative brenda filialeve të UBT-së, në të cilën do të punësohen studentë absolutë në UBT.

Presidenti i UBT-së, Hajrizi, para mysafirëve me theks të veçantë ka folur për zhvillimet dhe të arriturat e UBT-së dhe ka shprehur interesimin që në fillim të vitit që vjen t'i kemi hapat konkretë në drejtim të zgjerimit të bashkëpunimit me partnerë nga Gjermania.

Delegacioni gjerman është impresionuar nga faktet e treguara dhe gjetën mirëkuptimin e bashkëbiseduesve për ta shtrirë bashkëpunimin sa më parë edhe në fusha tjera.



UBT NË VAZHDIMËSI BASHKËPUNON NGUSHTË ME REPUBLIKËN E POLONISË

DELEGACIONI I UNIVERSITETIT TË VARSHAVËS NË POLONI VIZITOI UBT-në

Prishtinë, 20 dhjetor 2013 - Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, bashkë me drejtorin për çështje akademike prof. dr. Ibrahim Krasniqi, studentët dhe stafin akademik, pritën në një takim delegacionin nga Universiteti i Varshavës në Poloni, i përbërë nga zëvendësrektorja prof. Marta Kicinska-Habiovr dhe dr. Jakub Zajaczkowski, të cilët kanë biseduar për nisjen e bashkëpunimit ndëruniversitar, e cila është nënshkruar në qershorin e këtij viti.

Kjo marrëveshje do t'ua mundësojë studentëve të UBT-së dhe atyre kosovarë dhe të regjionit që studimet universitare në nivelin bachelor, master dhe atë të doktoratës ti ndjekin në UBT dhe në Universitetin e Varshavës dhe në fund të marrin diplomën e Universitetit të Varshavës.



Z. HAJRIZI CERTIFIKOHET SI ASSESORI I PARË NË TROJET SHQIPTARË PËR EFQM ILEP

Prishtinë, 24 dhjetor 2013 - Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, gjatë qëndrimit të tij disa ditore në Bazel të Zvicrës, dhe është certifikuar si asessor i parë për EFQM ILEP, nga Organizata Evropiane për Menaxhimin e Cilësisë, gjatë në workshopeve të organizatave në fjalë. Certifikimi i z. Hajrizi, është i pari në trojet shqiptare në këtë fushë.

Presidenti i UBT-së, prof. dr. Hajrizi, gjatë këtij workshopi ka prezantuar punën e UBT-së, konferencat dhe takimet e tjera me karakter ndërkombëtar që ka organizuar UBT, me mjaft sukses.

Po ashtu në këtë takim, pjesëmarrës ishin përfaqësues të rëndësishëm të universitete dhe firmave, më të cilët ka biseduar mundësi bashkëpunimi me universitete të ndryshme, si ato gjermane dhe zvicerane.

ENTET SHËNDETËSORE NË KOSOVË

SPITALI RAJONAL I PEJËS - MIRË, POR ME MUNGESA

Institucionet publike shëndetësore prej pas luftës nuk kanë arritur ta përmbushin listën esenciale me barna, për shkak të buxhetit të ulët që ka Ministria e Shëndetësisë, dedikuar furnizimit me barna.

Edhe vetë zyrtarë shëndetësorë thonë se sfida më e madhe në punën e tyre është mungesa e barnave.

Në spitalin rajonal të Pejës, doktor Atdhe Miftari ka deklaruar se vërehet mungesa e barnave.

"Kushtet në Spitalin e Pejës janë mjaft të mira, d.m.th kemi ngrohje dhe pastërtia është në nivelin e duhur. Kemi kërkuar material meridional dhe material teknik.

Materiali vjen kohë pas kohë nga Ministria Shëndetësisë pavarësisht se me çka janë të furnizuar ata, por mungesa vërehet", thotë.

Por, doktor Miftari ka thënë gjithashtu se përveç barnave, në spitalin rajonal të Pejës ka edhe mungesë të stafit, e që përbën vështirësi në punën e tyre.

"Gjithashtu ka mungesë të theksuar të mjekëve, si emergjente dhe anesteziologë, por edhe të kuadrit të mesëm. Vitin e kaluar Ministria e hapi një konkurs për 10 mjekë por e anuloi", shtoi ai.

Por megjithë mungesat e theksuara, pacientët shprehen të jenë

të kënaqur me kushtet dhe kujdesin që u ofrohet në spitalin e Pejës.

Njëri nga pacientët është Afrim Berisha i cili po kurohej në repartin e Otorinolarologjisë. "Kushtet janë të mira, ka ngrohje, pastërtia është në nivel, por shumë nga barnat duhet ti blejmë vetë. Ka disa barna që i ka spitali, por shpeshherë duhet edhe t'i blejmë", tha ai.

Derisa doktor Miftari gjithashtu ka përmendur edhe cilësinë e ushqimit si jo të mirë brenda spitalit, me të cilin ushqehen pacientët dhe stafi.

Punuan: D. Haxhijadini, M. Belegu, L. Bytyqi dhe A. Berisha



DIPLOMATI DHE SHKRIMTARI BESNIK MUSTAJ, DISKUTOI ME STUDENTËT E UBT-SË



Prishtinë, 23 dhjetor 2013- Ish-ministër i Jashtëm i Republikës së Shqipërisë, ish-ambasadori i Shqipërisë në Francë, autor i shumë titujve nga bota letrare, Besnik Mustafaj, sot ka marrë pjesë në debatin e organizuar nga Fakulteti për Media dhe Komunikim, Fakulteti i Shkencave Politike dhe Fakulteti i Juridikut në Kolegjin UBT, me temën "Faktorizimi i shqiptarëve në Ballkan".

Përveç, profesorëve të UBT-së, studentëve dhe të interesuar të tjerë, të cilët e pritën dhe e përcollën me interesim debatin, z. Mustafaj, u pritë edhe nga dekani

i Fakultetit për Shkenca Politike dhe Fakultetit për Media dhe Komunikim, prof. dr. Belul Beqaj dhe nga drejtori për Çështje Akademike, prof. dr. Ibrahim Krasniqi.

Diplomati dhe publicisti shqiptar, Besnik Mustafaj, tha se më të gjitha bilancet e deri tanishme, rezulton se shqiptarët kanë arsye të jenë të kënaqur me atë që është arritur. Ai foli për të arriturat e shqiptarëve në shtetet e rajonit ku ata jetojnë, duke theksuar pavarësinë e Kosovës, që siç tha, në këto pesë vjet pavarësi ka arritur një klasë politike shumë serioze.

"Ne jemi sot faktorë, sepse merremi me veten. Kërkohej një kohezion më i madh, kërkohej një sinkronizim më i madh, kërkohej një lloj programimi me i qartë se çfarë është aspiratë e përbashkët dhe se çfarë është veçanti për secilin shtet ku jetojnë shqiptarët" tha Besnik Mustafaj. Ndërsa, ajo që e bën Kosovën shtet të rëndësishëm, është se Kosova për herë të parë është përcaktuese për fatin e Serbisë drejt Brukselit, tha Besnik Mustafaj.

"Sa realist është ky lloj përcaktimi, është një gjë që do analizë. Por, sa do çojë në njohjen

reale ky proces i evropianizimi të Serbisë në njohjen nga Serbia të pavarësisë së Kosovës, është një proces i filluar, është më mirë se sa kur nuk kishte filluar" tha Besnik Mustafaj.

Sa i përket integritetit të shqiptarëve në Bashkimin Evropian, Mustafaj theksoi se shqiptarët kanë mundësi të mjaftueshme për të ardhmen e tyre në Bruksel. Ai beson se ka ende potenciale që duhen shfrytëzuar për të qenë shqiptarët e bashkuar në Bruksel. Pas kësaj është e mundur të ndërtohen dhe realizohen ëndrrat e tjera të shqiptarëve, tha Besnik Mustafaj.

Diplomati dhe shkrimtari Besnik Mustafaj, zhvilloi dhe përgjigjën në vijim të debatit edhe në një varg pyetjesh e çështjesh të shtruar për diskutim nga pjesëmarrësit, profesorët dhe studentët e UBT-së.

Besnik Mustafaj - Biografia

Besnik Mustafaj, ka lindur në Bajram Curr, në 1958. Ai njihet si poet, novelist dhe diplomat bashkëkohor. Ka studiuar Frëngjisht në fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Universitetin të Tiranës. Nga viti 1992 deri në vitin 1997 ka shërbyer si Ambasadori Shqiptar në Francë ndërsa në vjeshtë të 2005 u emërua Ministër i Punëve të Jashtme të Shqipërisë.

Mustafaj njihet si autori i:
- katër përmbledhjeve me poezi - Motive të gëzuara (Tiranë 1978); Fytyrë burri (Tiranë 1987); Legjenda e lindjes sime (2005)...
- përmbledhjeve me ese dhe studime - ndër të cilat ja vlen të përmenden: Fletorja rezervat: shënime jashtë valixhes diplomatike (Prishtinë 1995); Midis krimeve dhe mirazheve: (ese - Tiranë 1999).

- librave për fëmijë,
- pesë prozave - Vera pa kthim (Tiranë 1989); Gjinkallat e vapës (Tiranë 1994); Një sagë e vogël (Tiranë 1995); Daullja prej letre (Tiranë 1996); Boshti (Tiranë 1998). Me novelën 'Boshti' ai ka fituar dhe çmimin 'Medicis' në Francë më 1999, "Autoportret me teleskop", 2013.

Disa prej krijimeve të tij janë përkthyer në Frëngjisht, Gjermanisht dhe Bullgarisht.

VËSHTRIMI I DR. BELUL BEQAJ NË KONFERENCËN E MBAJTUR NGA GRUPI PËR STUDIME JURIDIKE POLITIKE ME TEMËN; "NGA NJË MJET INTEGRIMI, DREJT NJË DËSHTIMI NË NDËRTIM"



Të nderuar pjesëmarrës, misioni i serbëve të Thaçit ka përfunduar, po fillon misioni i serbëve të Daciqit. Është çështje rrethanash kur ministri kosovar i pushtetit lokal, Petroviq do të shpallet tepriçë teknologjike ngase të gjitha punët në komunat serbe po i kryen ministri i Serbisë për Kdhe M, Vulin. Figurativisht mendoj se, këto janë pasojat fillestare të zgjedhjeve, të cilat dikush i konsiderojë historike për shkak të pjesëmarrjes së gjithë serbeve në to. Ndërsa,

përmbajtësish është fatkeqësi që një projekt dështues po prezantohet si e arritur historike. Meqë, nëse i analizojmë rezultatet e këtyre zgjedhjeve duke u bazuar në argumente, mund të konstatojmë se ato nuk janë historike për shkak të pjesëmarrjes së gjithë serbëve në zgjedhje, por për shkak se të pasojave që do t'i shkaktojnë Kosovës dhe "primeve evropiane" të cilat duke i thirrë në multietnicitet dhe multikultur mbështeten zgjedhje ekskluzivisht etnike dhe jodemokratike në Kosovë. Në vend se partnerët ndërkombëtar të ndikojnë për shumë arsye, në ndërrimin pushtetit të Kosovës, që edhe pas 15 vjetëve nuk fitoi besimin e serbëve, qendrat e ndikimit ndërkombëtar të udhëhequr nga kryeministri Kosovës, po ndikojnë në ndërrimin raportin e brendshëm të forcave politike nacionale që në një periudhë jo shumë të gjatë do të shndërrohen potencialisht

në casus belli për stabilitetin regional. Pra, një problem i vogël, siç është largimi i këtij pushteti, po tentohet që të zgjidhet duke krijuar një problem të madh të sovraniteteve të ndara mes shumicës Shqiptare dhe pakicës Serbe! Meqë, Kosova pas zgjedhjeve lokale nuk është rrezikuar nga katër komunat e veriut por, s'është paku nga dhjetë komunat e Kosovës dhe paternalizmi i Beogradit Pse?

1. Zgjedhjet komunale në komunat serbe mund të konsiderohen legale por assesi nuk janë demokratike për shkak të daljes jashtëzakonisht të ulëte dhe presionit të pushtetit beogradas për të fituar me çdo kusht lista IQ' Serpska'. Realisht, fituesit e vërtete të zgjedhjeve lokale në Kosovë janë serbet të cilët më rreth 20 mijë votues kanë fituar 10 komuna, pra po aq, sa ka fituar PDK e kryeministrit, me mbi dyqind mijë votues!

2. Lista unike "Serpska" nuk është demokratike ajo është listë shtetërore në funksion të homogenizimit të qytetarëve serb të cilët do të ndjekin qëllimet hegjemoniste të pushtetit. Hegjemonizmi shihet nga privimi i drejtave karshi bashkësisë shqiptare apo hungareze në Serbi ndërsa për serbet në Kosovë kërkohej që procesi decentralizimit të kryhet në baza centraliste ku patroni kryesor nuk do të jetë Prishtina por pushteti i Beogradit.

3. Rrjedhimisht si pasojë e këtij koncepti, Bashkësia e komunave serbe do të jetë më e rëndësishme se vete Kosova ngase ajo do të determinojë politikën e saj të brendshme dhe jashtme, fillimisht me presione duke i ndryshuar rrethanat dhe pastaj duke ndryshuar statusin, me veprime politike duke shpallur referendum, duke kërkuar federalizmin Kosovës apo shkëputjen nga Kosova...

4. Shtete normale nuk kanë vende të rezervuara. Në vend se të shkojmë drejt kthimit të funksioneve të qeverisjes normale, po destabilizojmë dy fishë vendin. Përmes formimit të komunave etnike në nivelin lokal dhe përmes mbështetjes së vendeve të rezervuara në aspektin e qeverisjes qendrore.

5. Sa ma shumë zgjedhje speciale dhe etnike aq më pak besim dhe siguri në shtetin e Kosovës. Pasojat e zgjedhjeve të përkohshme do të shkaktojnë pasiguri afatgjate. Rrjedhimisht si pasojë e këtij koncepti, Bashkësia e komunave serbe, vendete rezervuara do të jenë më e rëndësishme se vete Kosova ngase ato do të determinojë politikën e saj të brendshme dhe jashtme.

Autori është profesor i rregullt në UBT, dekan për Fakultetin Shkenca Politike dhe u.d-dekan për Fakultetin Media dhe Komunikim.

“QUALITY KOSOVA” BËHET ANËTARE E RREGULLT DHE ME TË DREJTA TË PLOTA E ORGANIZATËS EVROPIANE PËR CILËSI

Prishtinë, 24 dhjetor 2013- Asociacioni kosovar “Quality Kosova” është pranuar si anëtare i rregullt dhe me të drejta të plota e Organizatës Evropiane për Cilësi (European Organization for Quality), në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të kësaj organizate, mbajtur në Stamboll të Turqisë.

Presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, që drejton edhe asociacionin “Quality Kosova”, këtë akt e ka quajtur si një sukses të madh në përfaqësimin e Republikës së Kosovës në institucione ndërkombëtare. Pas pranimit si anëtare e rregullt dhe me të drejta të plota Republikës së Kosovës i mundësohet të marrë pjesë në shumë forume dhe organizata të tjera ndërkombëtare të cilësisë.

Vlen të theksohet se pranimi i “Quality Kosova” përmes një

porosie të shkruar në letër është tentuar të pengohet nga përfaqësues të Serbisë, për mos pranimin e Kosovës në këtë organizatë, por pranimi u mundësua falë votave më të shumta të 35 shtete evropiane pjesëmarrëse në Këshillin e Përgjithshëm të Organizatës Evropiane për Cilësi.

“Quality Kosova” funksionon që nga viti 2006. Ajo e ka bërë kërkesën për anëtarësim në Organizatën Evropiane për Cilësi, kërkesë që është aprovuar nga Bordi Ekzekutiv i Organizatës Evropiane për Cilësi në tetor të këtij viti. Pas kësaj, z. Hajrizi është ftuar për ta bërë prezantimin e “Quality Kosova” në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të këtij asociacioni, të mbajtur në Kiev.

Edhe në vitin 2008, pas prezantimit nga dr. Hajrizi të punës së

“Quality Kosova”, Këshilli i Përgjithshëm votoi pro pranimit të “Quality Kosova” si përfaqësuese kombëtare e Kosovës në Organizatën Evropiane për Cilësi, ka pasur tendenca të pengohet nga përfaqësues të shteteve që nuk e kanë njohur ende pavarësinë e Kosovës, por pranimi u mundësua falë votave më të shumta në Këshillin e Përgjithshëm të Organizatës Evropiane për Cilësi.

“Quality Kosova” është asociacion që merret me çështjen e kualitetit, standardeve, certifikimeve dhe konfirmimit. Ai promovon cilësinë në Kosovë, në bazë të standardeve evropiane dhe ndërkombëtare, merret me certifikimin e sistemeve e produkteve sipas standardeve ndërkombëtare, si ISO 9001 e të tjerë.

VIZIONET TONA

Çfarë kërkojmë nga jeta? Jemi nevojtar të një sistemi të çuditshëm që po merr rrugën e gjatë e pa kthim tek lavdia. Ne të gjithë kemi një pikë kyqe e cila na mban të lidhur fortë në krahët e lavdisë, kërkojmë të jemi të respektuar e të ditur ngado që shkojmë. Zemra jonë nuk është xhep të mbushet me para, mirëpo ja që ato shifra të larta na kanë verbuar duke menduar se çdo gjë blihet me to. Paraja nuk të bën vitrinë e asaj që je, e as lavdia nuk ta shfaq mirësinë që ke brenda teje. Jetojmë në një botë ku, ekspozimi i vetës tënde është sfida më e mistershme! Si të bëhemi ata që dëshirojmë të jemi kur, në çdo çast një pëshpërma në vesh të vjen nga larg duke të thënë që nuk je aq i mirë sa duhet, duke njollosur emrin tënd e duke e çjerra me thonjtë e tyre ëndrrën tënde. Jeta është shumë e çuditshme. Duhet trishtimi për të ditur se ç’është lumturia, zhurmat për të vlerësuar heshtjen dhe mungesa për të vlerësuar praninë.

Ideologjitë tona kanë arritur në atë cep ku çdo gjë na duket e realizueshme. Zhburojmë persona të cilët nuk i njohim vetëm për interesat tona. Bëhemi miq me ta vetëm pse na ndihmojnë pa prituri asgjë në rikthim. Lakmojmë në energjinë e tyre duke absorbuar gjithçka që ata kanë vetëm për të qenë shërbëtorët tanë. Jemi bërë qenie të pangopura, altruizmin e kemi humbur thellë diku në mendjen tonë. Të qenurit një individ, një fjalë e së sotmes do të thotë të jesh një frymë unike që ekziston në Tokë. Nuk të duhet literaturë për të mësuar si të jetosh. Nuk ka manual të caktuar që të dërgon tek rruga e duhur e jetës. Mos humbisni shikimin tek gjërat që në dukje shkëlqejnë e të lënë gojëhapur sepse bukuria e tyre nga brenda të bënë të mendosh se e ke çuar jetën në gjurmë duke koleksionuar shumë gurë në vend të një diamanti.

Të nisësh një ecje të re sjell frikë. Por pas çdo hapi që përshkojmë kuptojmë se sa e rrezikshme ishte të rrije i ndalur. Jeta është si të ngasësh një biçikletë, për ta mbajtur ekuilibrin duhet të vazhdosh përpara. Andaj, gjeje fuqinë dhe qetësinë brenda teje dhe kur mos rresht në të qenit kurioz për gjithçka, sepse kurioziteti të dërgon tek mendimet më të kthjellëta, mendimet më të kthjellëta të dërgojnë tek veprimet, veprimet i realizon në atë mënyrë që kurrë të mos pendoresh se çfarë ke bërë, e të gjitha këto të dërgojnë tek e ardhmja, kurse e ardhmja.. është ajo me të cilën do jetosh tërë jetën!!

Diellza Olluri



VAZHDON BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN E TIRANËS

Tiranë, dhjetor 2013 - Përpos konferencave, projekteve hulumtuese të përbashkëta UBT që ka me Universitetin e Tiranës, gjatë këtyre ditë është thelluar edhe me tej bashkëpunimi mes dyja universiteteve si në ligjërata, në vlerësime, etj, kështu që presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, ishte pjesëmarrës në jurinë e ngritur nga Këshilli i Profesorëve të Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Tiranës, për mbrojtjen e temës së doktoratës nga fusha e cekur të kandidatit z. Ragmi Mustafa, kryetar i Komunitetit të Preshevës, me temën “ Roli i Sistemeve të Informacionit në ekonominë e tregut të vendeve në tranzicion, probleme dhe sfida të epokës bashkëkohore” me udhëheqës (mentor) prof. dr. Kozeta Sevrani.

Juria përbehej nga: prof. dr. Dhori Kule, rektor i UT, akademik Gudar Beqiraj, nënkryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, presidenti i UBT-së, prof. dr. Edmond Hajrizi, prof. asoc. dr. Nevila Bac, Departamenti MSIZ, Fakulteti i Ekonomisë, prof. asoc. dr. Rovena Bahiti, Departamenti MSIZ, Fakulteti i Ekonomisë.



FAKULTETET E UBT-SË: ÇKA U PUNUA NË 2013 E CILAT JANË PLANET PËR 2014

GJITHÇKA PËR STUDIME SUPERIORE, GJITHÇKA PËR STUDENTIN

Fakultetet në kuadër të UBT-së kanë zhvilluar një aktivitet të ngjeshur në vijim të realizimit të planeve mësimore, shkencore e hulumtuese. Një pjesë të punëve dhe planeve të tyre do ta prezantojmë në vijim



Dekan i Fakulteti të Shkencave Kompjuterike dhe Mekatronikë, dr. Muzafer Shala

Në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierike si dhe në Fakultetin e Menaxhimit të Mekatronikës, viti 2013 është vazhdimësi e sukseseve të mëhershme.

Fillojmë me sukseset e studentëve ku këtë vit kemi numër më të lartë të të regjistruarve me një kualitet dhe interesim të theksuar, mbajtja e suksesshme e Universiteti veror, Konferenca verore dhe Dimërore e Studentëve, vazhdimi i studimeve të mëtuajtshme nga disa studentë në fakultetet evropiane e më gjerë, organizimi i ligjëratave tematike (ku folës kanë qenë profesorë të njohur dhe udhëheqës të kompanive të njohura), nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompanitë që zhvillojnë aktivitete biznesore e qëndërlidhen me programet e UBT-së, pajisja e laboratorëve me pajisje të teknologjisë së fundit të cilat mundësojnë ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies e një varg aktivitetesh të tjera.

Ndërsa, sa i përket sukseseve të stafit, këtë vit kemi zgjerim të stafit profesional, brenda stafit është ofruar mundësia e vazhimit të doktoratës në fakultetet me të cilat kemi bashkëpunim bilateral e që janë të ranguar në top-universitetet botërore.

Mbajtja me sukses e Konferencës së SHKI-së dhe MEK dhe pjesëmarrja e stafit me hulumtime në temat aktuale, të cilat e kanë ngritur cilësinë e punës si dhe kanë hapur mundësi për bashkëpunime të mëtuajtshme me qendra të hulumtimit në rajon e më gjerë.



U.D. Dekan i Fakultetit të Menaxhimit, Biznes dhe Ekonomi dhe dekan i Fakultetit të Sistemeve Informacioni, dr. - ing. Ibrahim Krasniqi,

Fakultetet MBE dhe Sisteme Informacioni e përmbyllin vitin kalendari 2013 me të arritura të konsiderueshme të cilat ndërliken me proceset e mësimdhënies dhe mësimnxënies nga ana e studentëve të tyre. Gjatë këtij viti është punuar shumë në rritjen e vazhdueshme të cilësisë dhe kjo është shpërguar me interesimin e treguar për këto dy fakultete gjatë procesit të regjistrimit të studentëve të rinj për vitin akademik 2013/2014.

Edhe më tej Fakulteti i MBE mbetet një ndër shtyllat e zhvillimit institucional brenda UBT-së, ndërsa në Fakultetin të Sistemeve Informacioni ne kemi arritur pothuaj të dyfishojmë numrin e studentëve për vitin e ri akademik.

Kjo dëshmon që, përkundër situatës së pafavorshme ekonomike, cilësia e studimeve të ofruara garanton zhvillim të qëndrueshëm dhe na jep shtysë drejt avancimit të mëtejshëm në të dy fushat e mbuluara nga fakultetet përkatëse.

Ne kemi arritur që studentëve të fakulteteve të lartpërmendura t'u mundësojmë jo vetëm një mësim efektiv por përmes qendrës së karrierës shumë nga studentët tanë kanë kryer pjesën e praktikës profesionale brenda ose jashtë institucionit dhe kjo do t'i përgatisë ata edhe më mirë për një jetë të suksesshme profesionale në të ardhmen.

Gjatë viti në vijim ne do vazhdojmë edhe më shumë të kujdesemi që studentët tanë të jenë pjesë e proceseve dhe projekteve hulumtuese dhe kjo do t'u garantojë atyre avancim të vazhdueshëm dhe do t'ua hapë rrugën drejt suksesit në jetë.



Dekan i Fakultetit të Arkitekturës, dr. Binak Beqaj

Gjatë këtij viti në Fakultetin e Arkitekturës në UBT janë zhvilluar aktivitete gjithëpërfshirëse në shumë drejtime (në bazë të planit vjetor), duke kontribuar në zhvillimin e fakultetit dhe në ngritjen e cilësisë.

Prioritet ka qenë riakreditimi i programit të studimeve për Arkitekturë, ku kujdes i është kushtuar përmirësimit të programit, kushteve të studimit bazuar në standarde të larta. Në fund të procesit, programi është riakredituar dhe është vlerësuar në nivele shumë të larta.

Prioritet tjetër ka qenë zhvillimi i procesit të rregullt mësimor, duke siguruar staf adekuat, duke i ndarë studentët në grupe të vogla të ushtrimeve dhe ligjëratave dhe duke siguruar infrastrukturë adekuate.

Regjistrimi i studentëve të rinj dhe sistemimi i tyre (mbi 250 studentë).

Konferenca ndërkombëtare ICAS-PCE 2013 e organizuar në Durrës, ku kanë marrë pjesë shumë hulumtues vendorë e ndërkombëtarë, si dhe stafi akademik i UBT-së me punime shkencore dhe me prezantime.

Vizita studimore në Itali dhe në Austri, për studentët e arkitekturës ka qenë mjaft e rëndësishme në aspektin e shkëmbimit të përvojave me shumë universitete.

Konferenca verore dhe dimërore e studentëve 2013.

Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Universitetin "Mimar Sinan" në Stamboll.

Këto janë disa nga aktivitetet më të rëndësishme, që kanë kërkuar angazhim të vazhdueshëm. Ndërsa, në planet në vitin e ardhshëm, mes të tjerash, hyjnë: Akreditimi i programit master në Arkitekturë; Cilësia në mësim; Konferenca verore dhe dimërore e studentëve 2014; Regrutimi i stafit të ri akademik; Vizitat studimore; Vorkshoptet ndërkombëtare etj.



Prodekan i Fakultetit Juridik, can. dr. Ardian Emini

Aktivitetet gjatë vitit 2013:

1. Studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT) patën rastin të mësojnë më shumë rreth strukturës së gjykatave dhe prokurorive në Kosovë. Në bashkëpunim me Programin për Sundimin Efektiv të Ligjit (EROL) të USAID-it.

2. Në bashkëpunim me Zyrën e Intershipit në UBT është realizuar edhe intershipi sidomos në muajt qershor, korrik, gusht me studentet e Fakultetit Juridik. Pjesamë e madhe e studentëve patën fatin të ndjekin praktikën në Ministrinë e Diasporës dhe nëpër komunat e tyre nga viti.

3. Gjatë muajve maj dhe qershor të vitit 2013 u organizuan vizita të ndryshme në institucionet gjyqësore të Kosovës, ku studentët përcollën edhe seancat gjyqësore.

4. Gjatë muajit korrik u organizua edhe Universiteti veror.

5. Në muajin qershor u lidh edhe marrëveshja e bashkëpunimit me Institutin Gjyqësor, si rezultat i së cilës, me fillimin e vitit të ri akademik, një numër i studentëve kryejnë praktikën në këtë institucion.

6. Organizimi i vizitave të shumta nëpër institucionet tona shtetërore.

7. Organizimi dhe implementimi i Lëndës Klinike si Zhvillimi i shkathtësive gjyqësore.

8. Sjellja e ligjëruesve mysafirë nga institucione të ndryshme nëpër lëndë specifike.

Fakulteti Juridik qëllimet e përcaktuara më parë për vitin 2013 i ka tejkaluar, gjë që nënkupton që të gjitha këto të arritura janë falë përkushtimit dhe angazhimit të Rektorit të UBT-së, Edmond Hairizit dhe stafit akademik të Fakultetit Juridik të cilët u përkushtuan në ngritjen dhe prosperimin e këtij fakulteti.

Aktivitetet për vitin 2014:

1. Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit edhe me institucione të tjera juridike në Kosovë.

2. Përgatitja për nxjerrjen e generatës së parë të diplomuarve të Fakultetit Juridik, si një generatë e suksesshme dhe e kompletuar.

3. Organizimin e ligjëratave të ndryshme profesionale në lëndë specifike nga ekspertë të ndryshëm si ligjërues mysafirë.

4. Organizimi i një vizite studimore.

5. Vazhdimi dhe zgjerimi i intershipit.

6. Krijimi i një gjykatoreje në UBT.

7. Aktivizimi i studimeve Master në Juridik.

8. Krijimi i një instituti.

9. Organizimi i lëndëve klinike nga lëmi të ndryshme të së drejtës etj.



Prodekan i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Mjedisit me Infrastrukturë, can. dr. Muhamet Ahmeti

Ky fakultet është drejtuar me programe të akredituara pranë UBT-së. I vetmi program i akredituar në Kosovë në universitetet private, Fakulteti i Ndërtimit ka startuar shumë mirë, ku interesimi i studentëve për këtë drejtim ka qenë shumë i lartë.

Gjatë vitit 2013 ne kemi arritur që të funksionalizohet dhe të menaxhohet sa më mirë dhe sa me shpejtë Fakulteti i Ndërtimit, e po ashtu të organizojmë në mënyrën më të mirë të mundshme procesin e mësimin në këtë fakultet, duke angazhuar profesorë të lëndëve përkatëse, me një përvojë shumë të gjatë në lëmit e caktuara.

Në vitin 2013 ne kemi organizuar edhe ligjërata tematike me profesorë të ndryshëm ndërkombëtarë. Një prej ligjëratarave më të rëndësishme ka qenë edhe ligjërata me profesorin nga Brazili, i cili ka ligjëruar ligjëratarin: "Përdormi i fibrave natyrale në përmirësimin e vetive të ndryshme të betonit".

Gjatë vitit 2014 Fakulteti i Ndërtimit është pajisur me laboratorin më modern për shqyrtimin e materialeve në regjion.

Gjithashtu është paraparë të vizitohet edhe panairi i materialeve ndërtimore që do të organizohet në Turqi - Stamboll, një prej panairëve më të mëdhenj në Evropë dhe Azi, po ashtu do të zbatohet dhe implementohet edhe strategjia e fakultetit tonë, qëllimi i së cilës është që sa më shumë studentët e ndërtimit të marrin pjesë në vizitën e punishteve të ndryshme ndërtimore, ku do të njihen me të gjitha detallet e ndërtimit, në procese të ndryshme ndërtimore, të njihet dhe të bëjë lidhje në mes ligjërimit dhe praktikës, në mënyrë që të jetë i gatshëm që të inkorporohet qysh në fillim të studimeve me procesin e ndërtimit - të implementohet strategjia praktik-ligjërimit.

Po ashtu kemi të paraparë edhe ligjërata të ndryshme tematike të cilat do të organizohen me profesorë të ndryshëm Kombëtar dhe Ndërkombëtarë.



Koordinator i Fakultetit të Shkencave Politike, msc. Alban Lauka

Nisur nga ideja e krijimit të një institucioni akademik gjithë përfshirës dhe nevojës së shtetit të ri të Kosovës për kadro profesionale në të gjitha fushat e shkencave politike në sivjet arritëm që të e realizojmë Programin e Shkencave Politike i cili UBT –së, ia jep edhe atributin e qendrës për studime sociale, meqë krahas Programit Juridik, është akredituar edhe programi i Mediave dhe Komunikimit.

Të vetëdijshëm për rrethanat ekzistuese dhe me qëllim për ta përballuar konkurrencën e tregut të punës brenda dhe jashtë Kosovës kemi përfshirë programe specifike të cilat janë në funksion të kërkesave të institucioneve administrative dhe politike të cilat janë mungese në politikën zhvillimore të Kosovës. Synimet strategjike për gjithë përfshirjen e UBT-se edhe në fusha të tjera për ata studentë që kanë zgjedhur vetëm një objekt studimi, siguron një program të planifikuar dhe të ndryshëm të lëndëve me zgjedhje për të mundësuar që studentët të ndjekin dhe të thellojnë njohuritë e tyre në fusha të caktuara të administratës dhe ligjit.

Fillimisht, specifika e programit qëndron në kurrikulën e tij, e cila ka elemente diferencuese karshi programeve homonime, dhe e cila u vlerësoi lart nga ekspertet ndërkombëtare gjatë akreditimit. Se dyti, stafi adekuat, kompetent dhe profesional, i cili është i dëshmuar në të gjitha fushat e shkencave politike. Se treti, si rrjedhojë e logjikshme e këtyre përpjekjeve kemi arritur dhe cilësinë dhe kuantitetin e tej pritur të studenteve të cilët përkundër kualitetit relativisht të diskutueshëm të mësimeve paraprake, megjithatë, po arrijnë me përpjekje vetëmohuese që të përfshihen në rrjedhat aktuale të gjitha disiplinave të shkencave politike. Së katërti, angazhimi i përgjithshëm shihet edhe në pjesëmarrjet, shkrimet, studimet dhe hulumtimet e stafit, por edhe studenteve në konferenca dhe debate të ndryshme me të ftuar të fakultetit, që i japin një veçori komplementare praktike njohurive të cilat po krijohen gjatë procesit mësimor. Fundja, ekziston një gatishmëri dhe angazhim i veçantë për internshipin e studenteve, të cilët, qysh tani, krahas njohurive akademike, po i krijojnë eksperiencat e para profesionale praktike duke qenë pjesë e angazhimeve neper institucione të ndryshme politike, administrative, etj.

Ky koncept ka për qëllim që studentët të angazhohen në mënyrë konstruktive me praktikën e menaxhimit krijues dhe profesional për të përcjellë, arsyetimin, rezultatet dhe përfundimin suksesshëm funksional të studimeve. Jemi të përcaktuar që studentët që dëshirojnë të zgjerojnë studimet e tyre, të sigurojnë një numër të skemave të identifikueshme në program për të lehtësuar zhvillimin e njohurive të specializuara në fusha të caktuara në fokus meqë, zhvillojnë aftësitë e të mësuarit të pavarur dhe të vetë-reflektimit të nevojshëm për të mësuar gjatë gjithë jetës. Kjo qasje ju ndihmon në zhvillimin e aftësive kritike, intelektuale dhe është çelësi i suksesit për përgatitjen e studentëve për punësim, apo në studime të mëtejshme profesionale ose akademike. Prandaj, me përfundimin e studimeve në presim të kenë njohuri, të kuptojnë dhe zbatojnë një gamë të gjerë administrative, ligjore, proceset politike, sociale, ekonomike dhe konceptet e menaxhimit, vlerat dhe parimet e ligjit në Kosovë, marrëdhënie ndërkombëtare, integritet evropian dhe të shpjegojnë marrëdhëniet që ekzistojnë midis këtyre fushave. Saktësi për të interpretuar rolin dhe funksionin e institucioneve politiko-ligjore dhe procedurat e ligjit në Kosovë. Të demonstrojnë se brenda fushave të studiuara politike është një kuptim që ligji ekziston në një shumëllojshmëri të konteksteve, duke përfshirë edhe kontekstin evropian. Për studentët të cilët kanë bërë këtë zgjedhje, ka mundësi zhvillimi edhe në njohuri të veçanta, brenda fushës së tyre të zgjedhur. Të gjitha këto, mobilizimi i vazhdueshëm i stafit akademik, menaxhmentit administrativ dhe akademik të UBT-së, na bëjnë të besojmë se viti i ardhshëm do të jetë edhe më i suksesshëm se viti nismëtar.




Koordinatore e Fakultetit të Komunikimit dhe Mediave, ma. Naile Demiri

Me qëllim të realizimit të përpjekjeve për të bërë sa më të larmishëm spektrin e programeve në kuadër të UBT-së, sivjet është akredituar edhe Programi për Komunikim dhe Media. Ndonëse, synimet tona kanë pasur parasysh edhe nevojat për kadro në fushën e medieve në Kosovë, meqë, në Kosovë ende ka mungesë të theksuar të gazetarëve profesionistë. Shi për këtë Programi për Komunikim dhe Media është i dizajnuar në mënyrë që të ofrojë kombinim të tri fushave, esenciale duke nisur nga aftësitë praktike, njohuritë teorike profesionale dhe parimet etike që studentët duhet ti zotojnë në lëmin e gazetarisë. Në harmoni me këtë kemi bërë përpjekje që edhe stafi akademik të jetë në konkordancë me synimet e fakultetit. Prandaj, kemi angazhuar staf me aftësi akademike shkencore dhe përvojë profesionale. Në këtë mënyrë do të mundësohet studentëve që të mbledhin, të vlerësojnë dhe të shfrytëzojnë informacionet nëpërmjet medieve të ndryshme. Ngase qëllimi i programit Komunikim dhe Media është që të aftësohen studentët me dije teorike dhe praktike për të kryer me sukses punët në institucionet ku do të punojnë. Duke mbështetur në objektivat e UBT-së, kemi programin dizajnuar në atë mënyrë që të ofrojë një kombinim mes shkathësisë së të shkruarit akademik, transmetimit të qartë duke u bazuar në ligje dhe etikën gazetareske. Njëherë kërkohet nga studentët që të zotërojnë njohuritë më të reja teknologjike digjitale dhe gjuhëve të huaja. Të kuptojnë rolin e liderit dhe strategjinë e politikës dhe marketingut duke punuar në ëb .faqe. Të zhvillojnë aftësi të domosdoshme në dizajnim dhe redaktim të shtypit, të zotërojnë aftësi prezantuese edhe komunikuese veçmas në procesin e komunikimit ndërkulturor. Meqë, është fillimi i këtij programi në perspektivë mendojmë që studentët tanë të përfshihen në projektet tona, të cilat nënkuptojnë hapjen një portali, radio stacioni dhe stacionit lokal televiziv në perspektivë duke qenë kështu jo vetëm strumbullar për krijimin e kuadrove të gazetarisë por edhe absorbues direkt të tyre duke i aktivizuar në projektet brenda dhe jashtë UBT-së.

Punuan: E. Brahuhi, F. Azemi, F. Krasniqi, L. Bytyqi



Top University Education for Top Students



- 12 vite Lider i Arsimit të Lartë
- I certifikuar sipas standardit ISO 9001 për cilësi
- Përfitues nga Kosova i Programit Evropian ERASMUS MUNDUS
- Përfaqëson Kosovën në Organizata Evropiane dhe Botërore
- Kampion Evropian në Robotikë
- Kampusi i parë për Inovacione

Zgjedh më të mirin ...


... që të bëhesh më i miri!

Come to UBT and go everywhere...

Programet e studimit :


- **MENAXHMENT, BIZNES DHE EKONOMI (BA, MA)**
 - Financa, Banka dhe Kontabilitet,
 - Marketing dhe Shitje,
 - Manaxhment dhe Ndërmarrësi
- **SHKENCA KOMPJUTERIKE DHE INXHINIERI (BSc, MSc)**
 - Rrjeta dhe Telekomunikacion
 - Softuer dhe Sisteme Inxhinierie,
 - Baza e të Dhënave dhe Sistemet e Informacionit
 - Dizajni dhe Multimedia
 - Mekatronikë dhe Robotikë
- **MENAXHMENT I MEKATRONIKËS (BSc, MSc)**
(Elektroteknika, Elektronika, Teknologjia e Informacionit, Prodhimtaria Industriale, Dizajni Industrial, Ndërmarrësi dhe Menaxhment)
- **ARKITEKTURË (BSc)**
(I vetmi privat i akredituar në vend)
- **JURIDIK (LLB)**
(Civile, Penale dhe Ndërkombëtare)
- **SISTEMET INFORMATIVE (BSc)**
(Menaxhment, Biznes dhe Informatikë)
- **SHKENCA POLITIKE (BSc)**
 - Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci
 - Integritime Europiane
 - Administratë Publike
- **MEDIA DHE KOMUNIKIM (BSc)**
- **INDXHINIERI NDËRTIMORE (NDËRTIMTARI) DHE INFRASTRUKTURË (BSc)**
(I vetmi privat i akredituar në vend)


Përmes UBT-së ju mund të studioni dhe të përfitoni bursa studimi në Universitetet partnere si:


 Vienna University of Technology, Austri
Engineering Management (MSc)


 University of Warsaw, Poloni
International Relation (BA, MA)

 City University London, Angli
Computer Science and Engineering (BSc, MSc)

 HiG - Gjøvik University, Norvegji
Computer Science and Engineering (Mobility)

 CIFE - Centre International de Formation Europ, Francë
European Integration and Law (MA)

 Danube University Krems, Austri
Master in Business Administration (MBA)

 WIT (Waterford Institute of Technology), Irlandë
Master in Information Systems (MSc)

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

Diploma, dëftesat e notave, certifikata e lindjes, kopja e letërnjoftimit dhe dy fotografi 4X6

Gjuha e studimeve: Gjuha Shqipe dhe Gjuha Angleze

Mënyra e studimit:

UBT organizon ligjërata të rregullta gjatë ditës. Për të punësuarit ofrohen ligjërata pas orarit të punës dhe gjatë fundjavës

Që sukcesi juaj të jetë i garantuar, UBT ofron për secilin studentë:

- Orientim profesional, kurse përgatitore, praktika profesionale, vizita studimore dhe certifikime ndërkombëtare
- Nga një kompjuter gjatë studimeve dhe sisteme online
- Praktika dhe Eksperimente në Laboratorët bashkëkohorë.
- Trajtime: CISCO, Microsoft, AutoCad, ECDL, Projekt, etj.

Financat dhe pagesat:

- Çmimi i studimeve për një vit akademik është **1200 €**, me mundësi pagese deri në **12 kështe**.

Për të gjithë nxënësit e dalluar UBT ofron zbritje 20-50%

UBT ofron zbritje deri në 30% edhe për këto kategori:

- Të punësuarit në Doganat e Kosovës
- Pjesëtarët e FSK-së dhe Policisë së Kosovës
- Të punësuarit në Institucionet Publike të Kosovës
- Familjarët e dëshmorëve dhe veteranëve të luftës
- Studentët që vijnë nga e njëjta familje dhe si grup
- Studentët që paguajnë në fillim të vitit akademik

nuk është vetëm diplomë...



... ËSHTË PRESTIGJ!

... ËSHTË SUKSES!

... ËSHTË CILËSI! American European University Education

Lagjja Kalabria p.n., Prishtinë, Tel:038 541400 Mob:044 541400 Email:info@ubt-uni.net Koha e regjistrimit çdo ditë prej orës 09:00 deri në 17:30

Apliko online: www.ubt-uni.net/apliko ose në qendrat për Informim dhe Regjistrim në Ferizaj, Prizren, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë, Podujevë, Gjiilan dhe Rahovec



THE DEVELOPMENT OF EXECUTIVE FUNCTIONS IN CHILDREN



*Fatbardha Qehaja-Osmani,
South East European
Research Centre (SEERC),
University of Sheffield 1,
fosmani@seerc.org*

Abstract. Life success depends increasingly on the mastery of executive functions such as, working memory, shifting, and inhibiting. Executive functions, are cognitive processes that regulate behaviour, also influencing and predicting the development of other cognitive skills (Van der van et al, 2012). These functions are processes that regulate one's thoughts or behaviour. This paper will provide an overview of evidence regarding the development of executive functions in children, including key findings discussing their implications for children's learning, and indicating issues that merit further investigation.

Keywords: Executive functions, cognitive flexibility, working memory, inhibition, children

1. Introduction

Cognitive control mechanisms allow us to respond flexibly and efficiently to the changing demands of our environment, such as when a situation affords multiple possible responses (Snyder et al, 2008).

Executive function is a broad term that encompasses many higher order skills necessary for independent, goal-directed behaviour, including holding and manipulating information in working memory, switching between rules, inhibiting irrelevant information, planning, sequencing multistep tasks, and ascertaining the "big picture" from a complicated set of details (Denckla, 1989).

Executive functions play a crucial role in everyday cognitive tasks, such as estimating time and distance when going on holidays, or even when encountering work problems by planning solutions and implementing them.

The study of executive functions has been a popular field of study for several decades. Many studies (see Carreti, et al, 2004; Chyrsochoou & Bablekou, 2011) found relationships between executive functions and cognitive skills and processes important for educational achievement (e.g. comprehension skills and processes, visual processes, attention skills, etc.) which possibly results in bad or poor performance at school. Therefore, this paper has focused primarily on three EFs: working memory, cognitive flexibility (switching flexibly between tasks), and inhibition (deliberate overriding of dominant or prepotent responses) (see Miyake & Friedman, 2000).

2. Inhibition

Based on the theoretical model of Barkley (1997), inhibitory control is central to effective executive functioning in general. Inhibition is a mechanism that allows children to stop the activation of the current task, and switch to a new task (e.g. "OK enough with sorting cards based on their shape. Now we are going to match the cards based on the colour. So the red card goes with the red box and so on"). Inhibitory control develops significantly during the preschool.

In the day-night task, used to assess inhibition, children are presented with either a day picture of the sun or a night picture of the moon (and some stars) and are instructed to say 'night' to the day picture and 'day' to the night picture (see Gerstadt et al., 1994; Diamond et al, 2002). In this task the prepotent response of naming the stimulus must be suppressed in order to produce the 'conflicting' response required by the rule (Simpson & Riggs, 2005).

Similarly, Levin and colleagues (1991), proposed go/no go test in detecting the ability to inhibit responses. Levin and colleagues found that the greatest results in missed responses were found between the youngest (7-8) and the middle (9-10 years) age groups with little or no further improvements in the oldest age group (13-15 years).

3. Working Memory

Working memory plays an important role in everyday cognitive task such as deciding which items to buy in a supermarket. Working Memory (WM) capacity reflects the amount of information that can be retained, while processing is carried out, for a short period of time, (Cowan et al, 2003). However the short term memory (STM) refers to the ability to temporarily maintain and store information.

Working Memory tasks, also called complex span tasks, are designed to evaluate the capacity of working memory by requiring both the maintenance of information for subsequent recall and some concurrent processing (e.g.

reading sentences loud while trying to remember the last word of each sentence for a coming task) For example, in a counting span task (Case, Kurland, & Goldberg, 1982), children are asked to count dots on series of cards of ascending length and to recall the totals at the end of the series.

In an attempt to explore the effect of working memory and short term memory in cognitive flexibility in children, two groups of children are identified: children who could be perseverators or switchers. Perseverators are children who, despite being asked to move to a new task, they keep repeating the previous task which is not relevant anymore. Switchers are children who are able to switch to new tasks, as required, without repeating the previously relevant task. Thus, some researchers argue that switchers may have stronger working memory strength than perseverators, with stronger rule representation supporting both flexible switching and faster responses to switching (Blackwell et al, 2009). However, which executive functions are directly associated with failures in cognitive flexibility, still remains an important question for future investigations.

Diamond (1988) postulated that inhibition and working memory are inextricably linked, where if an individual is not able to maintain information over time and/or inhibit prepotent responses, he or she will continue to inflexibly choose the incorrect response. Furthermore, in recent studies when assessing cognitive flexibility in children, inhibitory control and working memory are tested jointly.

Similar to Barkley's theory Roberts and Pennington (1996) propose that normal development of executive functioning should be described in terms of the development of the two fundamental cognitive processes: inhibition and working memory. This was supported by the study conducted by Borella, Caretti & Pelgrina (2010), in which they posit that children with lack of inhibitory mechanisms have difficulty in controlling irrelevant information in the text to prevent overloading of memory capacity, which leads to damaging of the maintenance of relevant information and thus its integration as well as the comprehension and memorization of text.

4. Cognitive flexibility

People are often exposed to situations where they need to respond flexibly or even quickly e.g. after being used to cross the road in UK where people drive on the left side of the road, crossing the road in Greece where people drive on the right side of the road. When people are not able to flexibly switch to new demanding tasks they often perseverate or repeat older irrelevant behaviour or response. Children

are particularly robust perseverators (Yerys & Munakata, 2006). In a DCCS (Dimension Change Card Sort) task pre-schoolers perseverate by continuing to sort pictures on cards according to their shape even when asked to switch and sort cards according to their colour (e.g. Zelazo, Frye, & Rapus, 1996). This perseveration occurs despite children being able to correctly verbally report what rule they should be sorting by.

In the course of their learning, children are often required to switch sources of information as task relevance changes. The study of task switching has become one of the major research tools in studying the dynamic and flexible control of task sets (Koch et al, 2010). In recent studies (Posner & Rothbart, 2007) findings show that switching is subserved by two distinct skills: selective attention and attention switching, sometimes called shifting. Attention switching enables a child to switch from one task to another as required by others, e.g. "let's move on to retelling the story", however in some cases children need to discover when a given rule has become invalid and switch to a new rule e.g. a child might be shown two items at a time and asked to indicate which one is correct.

Switching in preschool children is often assessed by the DCCS task. To date, the main finding is that although three year old children are able to follow instructions and sort without error on pre-switch trials, they have trouble switching sorting rules, but instead they tend to perseveratively sort by the pre-switch dimension (Hannania & Smith, 2009).

In this task, the child is not told which dimension is relevant but is asked to discover the relevant dimension through trial and error (Hannania & Smith, 2009). Recent studies claim that successful set shifting requires (a) determining which task goal is relevant and, if it is different from the previous one, (b) implementing a switch in task set (i.e., reorienting attention to the newly relevant information, selecting the correct response, and so on) (Craig, Chavalier, 2009).

An important current question is how these executive functions underpin cognitive flexibility, which is the ability to flexibly switch between routine behaviours or tasks (Munakata et al, 2012). Flexibility is often required when children are asked to treat a single object in two different ways (sorting objects by shape or sorting by color) or even when they themselves decide to change activities e.g. from hide-and-see to playing cards. When they decide not to play the first game ("We're not going to play the hide-and-see game anymore") then the inhibitory mechanism needs to suppress the activation of this game in order

for them to switch to a new game (Now we're going to play the card game"). During their card game they need to remember who was the last person who took the card, in this case they need to memorize and update previous information.

Executive functions have been considered to play a crucial role in bilinguals. Managing two languages at the same time requires a control mechanism that resolves the competition between two languages effectively in order to use one language; the target language (Poarch et al, 2012).

Modern research has supported the early findings (Costa et al, 1998) that when bilinguals use one language, either the target or non-target language, both languages are active and may compete for selection. Inhibitory control mechanism that enables the selection of languages, as proposed by Bialystok (2004), has larger impact on cognitive control in bilinguals over monolinguals.

5. Conclusion- Indications for future research

We cannot evaluate or investigate children's educational achievement, without relating it to their cognitive system and executive functions and the extent to which they affect children's lives. Several researchers have theorized that inhibition, as well as working memory and cognitive flexibility have a crucial role in children's educational performance.

Clearly more research is needed to better understand the nature of inhibitory mechanisms, working memory and short term memory as well as cognitive flexibility in young children. Furthermore, this literature review indicates that future research is needed to identify the impact that each function has in perseveration. Also concentration on the measurement of timing in WM processes indicates a need for future research (see Cowan et al, 2003). An important goal for future research will be to disentangle whether various forms of processing conflicts in task switching (i.e. at the stimulus level vs. at the response level, see Koch et al, 2010). Moreover, it would be interesting to further investigate the impact of bilingualism in all three executive functions.

The following questions are considered for future research: Does speaking a second language provide a benefit in children? Are bilingual children, compared to monolingual, faster switchers? Do monolinguals suffer less task interference than bilinguals, who are used to switching between two languages and inhibiting the one that is not currently being used in everyday life?

Answers to these and many other questions seem to constitute relevant research necessary and valuable.

INTERVISTË ME PIKTORIN ZAKEPRELVUKAJ

TË PUNOHET ME NDER

“Të punojë secili me nder punën dhe profesionin, prej kryeministrisë e deri te njeriu i thjeshtë, sepse nuk është nënçmim vetëm të bëhet ashtu siç duhet të ndërtohet. Nëse kemi ndër mend ta ndërtojmë një shtet të mirë dhe nëse e kryen një detyrë duhet ta kryesh punën me nder”, tha Zake-Prelvukaj, për gazetën “UBT News”

UBT News: Cilat janë fillimet e karrierës tënde?

Zake Prelvukaj: Unë jam rritur në këtë studio, sepse vëllai im por edhe familja ime kryesisht janë marrë me art, kështu që talenti dhurohet me lindje dhe nëse di ta zhvillosh, t'ia zësh fijen do të të shkojë ashtu si duhet. Por, asnjëherë pa iu shmangur, pa bërë pauza... E kam të trashëguar nga gjyshi, nga halla dhe nga vëllai, jam bërë vizatuese dhe e mbështes këtë fjalë timen, vëllai im ka qenë ai që më ka perfeksionuar se ai mund të them me plot kuptimin e fjalës se është një ndër vizatuesit më të mirë shqiptarë.

UBT News: A keni hasur në vështirësi gjatë karrierës?

Zake Prelvukaj: Kurrë, unë jam një tip optimist dhe nuk i dua femrat që presin, sepse ka piktorë apo piktore në krah të tjetërkujt. Unë vet kam filluar dhe vet vazhdoj, nuk e kam pasur të lehtë sepse kam diplomuar në vitet e 90-ta dhe ka qenë periudhë e vështirë ekzistenciale për kafshatën e gojës, por prapë nuk ka mund të më ndalë as kriza, as tmerr.

Natyrisht, kam ecur me hapa të fortë e të sigurt.

UBT News: Cilat nga pikturat tuaja janë shpërblyer me ndonjë çmim?

Zake Prelvukaj: Me çmim janë vlerësuar këto: Ghetto Art, WorldGhetto, poashtu kam marrë edhe mirënjohje, një çmim, në Maqedoni, një çmim në Amerikë etj.

UBT News: A keni ndonjë pikturë që e çmoni më shumë?

Zake Prelvukaj: Të gjitha më pëlqejnë, por e veçoj pikturën "X". Është pikturë e kuqe dhe periudha kohore NoComent e vitit 1998. Janë kujtime që kam përjetuar dhe ato nuk kthehen më.

UBT News: Si e kaloni kohën e lirë?

Zake Prelvukaj: Kohën e lirë dal me shoqëri, pikturoj shumë, lexoj shumë dhe e vizitoj nënën time, familjen time.

UBT News: Nëse nuk do të ishte piktura, çfarë profesioni do të zgjidhni?

Zake Prelvukaj: Po, natyrisht, unë kam dashur të bëhem aktore e të shkoj në Zagreb por për shkak se unë jam nga Mali i Zi por e shkolluar në Prishtinë, ishte e tepërt të kërkoja të shkoja në Zagreb. Kam dashur ta marr pikturën dhe aktrimin, por prapë mendoj se e kam zgjedhur atë që për mua është më mirë.

UBT News: Mesazhi juaj për Vitin e Ri?

Zake Prelvukaj: Mesazhi do të ishte që të punojë secili me nder punën dhe profesionin, prej kryeministrisë e deri te njeriu i thjeshtë, sepse nuk është nënçmim vetëm të bëhet ashtu siç duhet të ndërtohet. Nëse kemi ndër mend ta ndërtojmë një shtet të mirë dhe nëse e kryen një detyrë duhet ta kryesh punën me nder.

UBT News: Faleminderit shumë për kohën që ndatë me neve.

Zake Prelvukaj: Faleminderit edhe prej juve, ju dëshiroj punë të mbarë dhe suksese në studime.

Intervistën e realizuan: Albina Zeneli, Xhejlane Sopa, Ilaz Luzha



BISEDË ME HIP-HOP ARTISTIN KASTRIOT REXHA (DR. MIC)

“HIP-HOPI YNË MUND TË CILËSOHET SI MË I MIRË NË BALLKAN”

Dr. Mic është një ndër reperët më të suksesshëm në vend. Në vitin 2005, ai themeloi grupin TDS, së bashku me Onatin. Në vitin 2012 ata u bënë pjesë e labelit BabaStars.

UBT News: Si dhe kur keni filluar të merreni me Hip Hop? Na tregoni pak sfidat të cilat i keni kaluar për të arritur suksesin që keni sot?

Dr. Mic: Në klasë të katërt kam filluar për herë të parë të dëgjoj Hip-Hop. E veçoj TUPAC-in. Pastaj jam njoftuar me muzikën e BIG-it, e nga ai moment unë u bëra adhurues i muzikës Hip-Hop. Fillimisht sfidat kanë qenë të mëdha për t'i tejkaluar vetëm pasi që nuk kam pasur përkrahjen as nga familja, sepse mendonin se ishte vetëm një fazë kaluese si adoleshent dhe jo si ambicie serioze. Ka pasur raste kur kam kursyer para të mia, vetëm për ta incizuar një këngë.

UBT News: A ekziston ndonjë artist i huaj i cili të inspiroi që të merresh me muzikë?

Dr. Mic: Tupac-i është arsyeja pse unë fillova të pëlqej Hip-Hopin. Pastaj ka pasur edhe reperë të tjerë, ku në mes të rreshtave të



këngëve të tyre unë e kam gjetur veten. Një ndër ta është Eminemi.

UBT News: Cila këngë e juaja mendon që të sollti më shumë sukses?

Dr. Mic: Në vitin 2010 është kënga “Si manekene” dhe “Ka je, ka je”, të cilat kanë bërë “boom” dhe me këto këngë jemi bërë të njohur për publikun. Pastaj kemi vazhduar që me shumicën e këngëve të kemi sukses.

UBT News: A mendon ta lësh muzikën e të merresh me ndonjë profesion tjetër?

Dr. Mic: Unë aktusliht jam student në vitin e tretë dhe pas studimeve patjetër që mendoj se do ta kem një profesion tjetër. Mirëpo, kjo gjë nuk do të thotë që unë të heq dorë nga muzika.

UBT News: Pse “Dr.Mic”?

Dr. Mic: Kjo nofkë më ka mbetur që 7 vite e që nënkupton “doktor i mikrofonit”.

UBT News: A po sheh ndryshime në Hip-Hop skenën shqiptare, a ka kualitet sipas teje?

Dr. Mic: Secilën herë po vijnë reperë më të mirë dhe me vlera

shumë të mëdha. Mendoj që Hip-Hopi jonë mund të cilësohet si Hip-Hopi më i mirë në Ballkan dhe një ndër më të mirët në Evropë. Por, as me amerikanët nuk jemi larg.

UBT News: Cilat janë projektet e radhës, kur lansohen?

Dr. Mic: Projekte të reja kanë filluar mirëpo ende nuk ka data të sakta.

UBT News: Çfarë dhurate po e pret nga babadimri?

Dr. Mic: Asgjë, kam dëgjuar se nuk po vjen babadimri këtë Vit të Ri në Kosovë hiç (hahaha).

UBT News: A po pretendon që 2014-ta të jetë një vit më i mirë se ky që e lamë pas?

Dr. Mic: Gjithsesi. Mendoj që 2014-ta do të jetë vit i veçantë, pasi që projektet tona të reja do të jenë më ndryshe. Shpresoj se do të mirëprehen nga publiku dhe nuk do të mungojë suksesi.

UBT News: Diçka për fund?

Dr. Mic: Ju uroj të gjithë njerëzve një Vit të Ri të mbarë me suksese dhe ju uroj t'ju plotësohen të gjitha dëshirat që ata kanë.

Intervistoi: Alba MEROVCI



HITET E 2013-tës

Iku 2013-ta e po vjen një vit i ri. Vit ky që e lamë pas me plot suksese të gjithanshme. Mund të themi se ishte një vit goxha fitimprurës për artistët tanë. Realizuan shumë hite, ku sidomos neve të rinjve na përcjellin kudo që shkojmë. Shumë suksese për këta artistë, e shpresojmë që edhe vitin e ardhshëm të na argëtojnë me këngët e projektet e tyre të radhës.

GHETTOGEASY– Getoar Selimi, njëri ndër Hip-Hop artistët e parë shqiptar bëri “boom” këtë vit. Përplot këngë, videoklipe e koncerte. Pothuajse të gjitha këngët iu bënë hit, por vlen të veçohet kënga “N’Prishtinë” dhe së fundi kënga “Enxonme”. Këngë këto të realizuara me videoklipe nën përkujdesjen e produksionit “Imagine”. Këto videoklipe arri-

tën të marrin miliona klikime në youtube.

Poashtu, grupi Tingulli 3nt ku pjesë e tij është Getoari së bashku me Agonin realizuan hitin veror “Po t’shohpërmas”. Kësaj kënge iu bashkëngjit edhe videoklipi.

TUNA FT. COZMAN – Çifti më i bukur i estradës tonë Tuna&Cozman këtë verë arritën kulminacionin e hiteve të 2013-tës. Ata realizuan këngën e tyre “Fenix” së bashku me videoklip mjaft tërheqës. Gjatë kësaj vere kudo që shkoje, ishte e pamundur të mos dëgjoje këngën e tyre. Kjo këngë ka prekur shifra rekorde në youtube, ku për 3 muaj arriti t’i marrë 10 milion klikime. Ky është sukses edhe për labelin BabaStars ku çifti është pjesë e tij. I urojmë suk-

sese të mëtutjeshme Tunës dhe Cozman-it.

DAFINA ZEQRIRI– Në fillim të vitit 2013, superstar-i jonë Dafina ka lansuar këngën “Veç Ti”. Këngë kjo e zhanrit reggae, ku vendi jonë është pak i njohur me këtë stil të muzikës. Megjithatë kjo këngë u pëlqye mjaft shumë nga publiku. Së fundi Duffy-e realizoi edhe këngën “Hajde ma knej” poashtu me videoklip. Videoklipi u realizua nga produksioni “Imagine” ku Dafina merr një pamje krejt tjetër dhe duket mjaft “hot”.

NORA ISTREFTI FT. GENA– “Le Mama” hiti tjetër veror në bashkëpunimin në mes të Norës dhe Genës. Një bashkëpunim mjaft interesant dhe i pëlqyeshëm. Këngës ia realizuan edhe videoklipin

ku pati mjaft sukses. Produksioni “Entermedia” realizoi videoklipin e kësaj kënge ku arriti të vë në pah pjesën e bukur dhe joshëse të Norës.

Skivi– Një tjetër pjesëtar i labelit BabaStars, Visar Shala lansoi këngën së bashku me videoklip “E di që mu m’don”. Me këtë projekt, këngëtari u nda shumë i kënaqur pasi që kënga u pëlqye shumë nga adhuruesit. Kënga është punuar nga Freakyboyz, me miksim të Kicon’Torch, kurse për videoklipin u përkujdes “ThinkCreative”.

LyricalSonft. McKresha– Anëtarët e labelit “PINT” realizuan bashkëpunimin e tyre “Me ta pyl”. Videoklipi i të cilit u incizua në Dubai, me skena mjaft provokative dhe valltare shumë të bukura ndërkombëtare.

Dr. Mic ft. Alban Skenderaj– Një bashkëpunim interesant në mes reperit Dr. Mic dhe këngëtarit nga Shqipëria Alban Skenderaj. “Mrekullia e 8-të” arriti të pëlqehet shumë nga publiku dhe të bëhet hit. U realizua edhe videoklipi shumë i lezetshëm i kësaj kënge i cili u incizua në Tiranë.

Flori ft. Kaos– Si gjithnjë këngët e Florit bëhen hit. E kjo gjë funksionoi edhe me bashkëpunimin e Florit me grupin Kaos. Kënga “Lule, lule” u pëlqye nga publiku, e këtë gjë e bëri edhe më interesant videoklipi kreativ e veror që ata realizuan.

Realizoi: Alba MEROVCI



TRENDET AKTUALE TË GRIMIT VJESHTË/DIMËR

Për të pasur një pamje të shkëlqyer, të bukur, është e natyrshme që duhet t’i kushtojmë vëmendje dhe një kujdes të shtruar. Shfrytëzoni në maksimum të gjitha produktet kozmetike por duhet të bazoheni në disa këshilla në mënyrë që grimi juaj të duket perfekt.



UBT News:

KËSHILLA: Ngjyra e syrit luan një rol të madh në përzgjedhjen e look-ut tuaj... në qoftë se posedoni sytë me ngjyrë kafe duhet t’i gjejmë ato nuance që theksojnë syrin tuaj, bebëzën me ngjyre kafe i përshtaten me tepër këto nuanca: e kafet, violete dhe e gjelbër e erret, ndërsa në qoftë se keni

sytë ngjyre blue atëherë theksoni me tepër me ngjyrë blu të lehtë... por mos harroni grimi i syve nuk duhet të jetë me mastë të tepruare i theksuar ...

UBT News: Në sezonin e dimrit preferohet më tepër pudër me nuancë të bardh, sytë të theksohen me bakër të çelët dhe hijezim me ngjyrë të zezë, duhet t’i kushto-

jme vëmendje edhe qerpikëve të cilët duhet të theksohen shumë, mollëzat mos harroni që t’i theksoni sepse fytyra juaj do të duket shumë më e bukur me theksim e tyre dhe buzët me ngjyrë të mbylltë si psh: Vishnje e errët, kafe etj..

KENI KUJDES:

UBT News: Buzët me ngjyrë të mbylltë janë tendenca për këtë sezon dimëror, kjo pamje i përshtatet më tepër femrave që kanë buzë më të plota, po nuk do të thotë që vetëm të keni buzë të plota arrihet efekshmëria e buzëkuqit që ju dëshironi ta mbani, efekti ibuzëkuqit është te vajzat të cilat posedojnë buzë më të holla, ngjyra e mbylltë i karakterizon femrat në përgjithësi më serioze. Ndaj mos ngurroni vendoseni sepse do të dukeni bukur.

UBT News: Buzët duhet të jenë të lëmuara dhe të mirëmbajtura, gjithashtu mos harroni të grimoheni me kujdes, sepse çdo parregullsi vërehet. Buzëkuqi aplikohet me një brushë mbulohet me pudër dhe sërish jepet edhe një shtresë me pot e njëjtën ngjyrë, aplikohet kjo mënyrë për arsyeja që buzëkuqi të qëndron më tepër.

Fortesa Krasniqi

JETA STUDENTORE

Jeta studentore është një ndër periudhat më të rëndësishme të jetës, si në të ardhmen e të rinjve poashtu edhe në kënaqësitë që përjetojnë në atë kohë.

Ka momente të bukura që përjetojnë me shoqëri dhe në ambientet studentore, po ashtu ka momente të emocionit, stresit dhe adrenalinit të papërkrahshme gjatë kohës se provimeve dhe me ankh pritjet rezultati i punës së bërë.

Studentet kanë shumë përgjegjësi dhe punë për të bërë gjatë rrugëtimit të tyre, që bëjnë për ta ndërtuar të ardhmen. Në ditët e sotme studimet kanë rëndësi shumë për jetën dhe të ardhmen e çdo individi sidomos për të rinjtë që potencojnë të jenë më me vlerë dhe më të ngritur për të arritur qëllimet e tyre jetësore, dhe për ata që synojnë të prekin majat e suksesit në lëmitëku ata e gjejnë veten dhe marrin hapat e parë për t’uprofesionalizuar në atë drejtim që kanë marrë.

Njeriu gjatë jetës së tij nuk duhet të ketë vetëm një profesion por të jetë i gjithanshëm, sepse jeta dramatike e shfaqur me probleme shpeshherë kërkon shumë opsione sepse jo gjithçka fati ndërton për ne. Ne jemi ata që duhet të punojmë shumëçka para tij.

Jeta dinamike na imponon shumë gjëra e ndër to është edhe shkollimi si një ndër pjesët më të rëndësishme.

Në situata kur ne përjetojmë disfatën e bëmë pyetje vetës: kush jam unë dhe nga vij, cilat janë qëllimet dhe vizionet e mia? Dhe nëse nei përgjigjemi në mënyrë të mirëfilltë këtyre pyetjeve arrijmë ta njohim vetendhe nëse një njeri arrin ta njohë veten, ai ka arritur të njohë gjithçka.

Nëse arrijmë ta kuptojmë destinacionin tonë jetësor ne kuptojmë se njeriu nuk duhet të jetë i kënaqur kurrë medijen që posedon, atëherë ai ka arritur të njohë gjithçka.

Çdo krijesë e gjallë ka një armë, arma e njeriut është dija, sepse njeriu është krijuar të mendojë dhe të arrijë dituri, të veprojë dhe jo të flasë dhe të kuptojë që është qenia më e përsosur.

Gentiana Hoxhaj

INTERVISTË EKSKLUZIVE ME MESFUSHORIN "BOMBASTIK" TË KF DRITA

SHABANI NDËR MË TË RËNDËSISHMIT NË DRITË

Fillimet dhe karriera e mesfushorit Xhevdet Shabani si futbollist profesionist në Raiffeisen Superligën e Kosovës



UBT News: Mund të na flisni për fillimet e karrierës suaj si futbollist ?

Shabani: Për herë të parë si një futbollist profesionist kam luajtur në moshën 18 vjeçare, në ekipin e KF Lepenci dhe më pas kam zhvilluar ndeshje me ekipin e juniorëve për të fituar përvojë më të madhe me klubin Kaçanikas. Pas pesë gjirove kam luajtur në ekipin e parë rregullisht dhe më vonë kam qenë startues në 11-shen e klubit në ligen e parë të futbollit kosovar.

Në 2009 jam transferuar në KF Ferizaj ku kam luajtur vetëm dy gjiro për shkak të lëndimit në një të këmbës dhe nga ai lëndim kam pauzuar dy muaj dhe jam kthyer përsëri në KF Lepenci si transfer i lirë.

Pas gjashtë muajve sa kam luajtur në sezonin e dytë në ligen e parë të Kosovës me KF Lepenci, kam kaluar në superligë në KF Drita nga Gjilani në sezonin 2011/12, për shkak të kushteve më të mira në klubin Drita dhe një ligë më e lartë nga ajo që isha me klubin Lepenci. Për tifozët e KF Lepenci "Fikshat" lajmi për largimin tim nga skuadra ka qenë jo i mirëpritur për ta, e sidomos për rivalitetin e klubit Lepenci me ekipin Gjilanas, ngase përkrahja nga Fikshat ka qenë shumë e madhe për mua si lojtar kryesor në ekipin Kaçanikas par atë arsye ka pasur reagime të shumta nga tifozët vendas.

Mikëpritja në Gjilan nga KF Drita e sidomos nga tifozët intelektual ka qenë shumë befasuese për mua, nuk kam pritur se do të has në një natyrë të tillë ngase rivaliteti me klubet që kam luajtur në të kaluarën.

Kam nënshkruar kontratë një vjeçare me klubin Drita kur jam transferuar, të cilën e kam vazhduar edhe një vit tjetër deri në qershor të vitit 2014. Kam disa oferta nga klubet kosovare, mirëpo e vetmja mënyrë për kalimin në një ekip tjetër është marrëveshja ndërmjet klubeve për transferin.

I falënderoj kryesin e klubit për përkrahjen e tyre të vazhdueshme e sidomos mbështetjen nga tifozet intelektual.

UBT News: Çfarë do të thotë për juve të jeni një ndër lojtarët kryesor të KF Drita ?

Shabani: Unë si organizator i lojës në klub kam një rëndësi të madhe në fushë ngase jam mesfushor ofanziv alo i djathtë dhe pasimet deri te sulmuesit kanë qenë të suksesshme dhe në këtë mënyrë kemi arritur deri te shënimi i golave. Ndeshja debutuese nga foracionistartues që nga fillimi deri në përfundim të ndeshjes. Kemi luajtur një ndeshje shumë të miratëdit dhe kemi arritur fitore falë lojës që zhvilluam në atë takim. Më vonë kam pasur përkrahje shumë të madhe nga tifozët e klubit dhe ndeshje pas ndeshje jam përmirësuar më shumë, dhe kemi pas sukses të mirë në raiffesensuperligën e kosovës, gjithashtu mbështetja nga bashkëlojtarët që më kanë ndihmuar që të jap më të mirën në fushë dhe nga kryetrajneri Arbnor Morina që më ka dhënë shtytje shumë të madhe bashkë me ndihmën trajnerin Afrim Shahini.

UBT News: Çfarë synimi ka në këtë stinor KF Drita dhe A mendoni se do të arrihet ai synim ?

Shabani: Në kampionat paraqitja më e mirë e mundshme, dhe të jemi sa më lart në tabelë, ndersaynimi kryesor në këtë sezon i KF Drita është fitimi i trofeut të kupës së Kosovës. Mendoj se do të jemi më të mirë se sezonin e kaluar, për arsye se kemi ambicie më të mëdha si skuadër më kompakte me kryetrajnerin Arbnor Morina, i cili është një nga trajnerët më të mirë në vendin tonë.

UBT News: Mesazhi juaj për futbollin kosovar.

Shabani: Futbollit kosovar ka arritur të rimëkëmbet dalëngadalë që të arrij pranimin në arenën ndërkombëtare, e cila do të ishte një motivim shtesë si për lojtarët ashtu edhe për skuadrat në vend, dhe mendoj se sporti është ambasadori më i mirë i një vendi.

Intervistoi: Egzon Hyseni, Valdrin Maloku dhe Labinot Hoxha.

VITI 2013-TË I SUKSESSHËM PËR SHAQIRIN

Liga e Kampionëve, titulli kampion në Gjermani, Kupa e Gjermanisë, Superkupa e Evropës dhe Kupa e Botës për klube, janë pesë trofet e fituar nga Xherdan Shaqiri në vitin 2013. Ai nuk fitoi vetëm Superkupën e Gjermanisë

Viti 2013 po përmbillet në mënyrën më të mirë për Xherdan Shaqirin. Ylli kosovar i Bayern Munich gjatë këtyre 12 muajve ka fituar hiq më pak se pesë trofe dhe të gjithë me bavarezët. Së fundi e fitoi edhe Kupën e Botës për klube. 22-vjeçari nga Gjilani, këtë vit nuk fitoi vetëm Superkupën e Gjermanisë, ku Bayern u mposhtë nga Borussia Dortmund, në 'Signal Iduna Park'.

Trofeu i parë

Kampion i Gjermanisë. Ky është titulli i parë që fitoi Xherdan Shaqiri këtë vit me Bayern Munich. Ai u stolis me këtë trofe, pasi skuadra e tij nën drejtimin e Jup Heynckes ishte bindshëm më e mira në Bundesligë. Shaqiri në këtë garë kontribuoi me katër gola, në 26 paraqitje të tijat. Në shumicën e takimeve u inkuadrua në pjesën e dytë, por luajti edhe titular.

Trofeu i dytë

Trofeun e dytë Shaqiri e fitoi atë të Ligës së Kampionëve, që vlerësohet si më i çmueshmi në një garë evropiane për klube. Ata mposhtën rivalin vendor, Borussia Dortmund me rezultatin 2:1. Shaqiri nuk luajti në këtë ndeshje, por pas lojës ai festoi me flamurin e Kosovës dhe atë të Zvicrës, duke bërë bujë të madhe në mediat e huaja. Në këtë garë Shaqiri kontribuoi me 1 gol të shënuar ndaj Bate Borisovit. Pati shtatë paraqitje.

Trofeu i tretë

Disa ditë pasi fitoi 'Championsin', Bayern Munich u stolis edhe me Kupën e Gjermanisë. Ata mposhtën në finale Stuttgartin. Edhe në këtë takim mungoi Shaqiri, por në këtë garë ai kishte shënuar tre gola, në pesë takime sa ishte aktivizuar. Njëherë nga golat e kishte shënuar në gjysmëfinale ndaj Ëolfsburgut.

Trofeu i katërt

Trofeu i katërt vjen nga Superkupa e Evropës. Bayern Munich takohej me Chelsea në Pragë të Çekisë. Koha e rregullt u mbyll 1:1. Menjëherë pas vazhdimëve inkuadrohet Shaqiri, i cili ka disa raste të mira për shënim. Në vazhdimë shënohen dy gola, nga një në secilën anë për të shkuar takime në vazhdimë. Xherdani shënoi penalltinë vendimtare për Bayernin, duke qar kështu në gëzim të madh bavarezët dhe trajnerin Pep Guardiola, për të cilin ishte trofeu i parë me skuadrën e re.

Trofeu i pestë

I pesti erdhi nga Maroku. Bayerni fitoi Kupën e Botës për klube, ku në finale mundi Raya Casablanca e Marokut me rezultat 2-0, të dy golat u shënuar në pjesën e parë. Xherdani luajti fillimisht në gjysmëfinale, duke shijuar 20 minuta, kurse në finale ai ishte titullar. Madje, njëherë qëlloi edhe transversalen.



JANUZAJ 18 VJEÇARI MË I PAGUAR NË BOTË

Mesfushori i kampionit anglez të Manchester United, Adnan Januzaj thuhet të jetë bërë 18 vjeçari më i paguar në botë. Vazhdimi i kontratës edhe për 5 vite të tjera me United-in, i ka shumëfishuar pagën talentit nga Istogu i cili tani ka një të ardhme të sigurt.

Sipas disa burimeve thuhet se Januzaj me kontratën e re do të përfitoj hiq më pak se 70 mijë euro në javë ndërsa poashtu do të marr plus edhe 6 milion euro që ka pranuar të nënshkruaj kontratën të cilët do t'i dhurohen në pagë javore nga 25 mijë euro javë për pesë vite.

Januzaj me këto shifra ka kaluar edhe Cristiano Ronaldo dhe Wayne Rooney gjatë kohës sa ishin 18 vjeçar.





*American European
University Education*



Happy New Year 2014!

From: UBT - Business, Technology and Innovation



12 Years
Leadership and Innovation